




Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

2016



Raporti i Performancës së Komunave

PËRDOR TË DHËNAT E
PERFORMANCËS PËR NDIKM MË TË
SHPEJTË NË SHOQËRI



Prishtinë, maj 2017

Hartues i raportit:

Isuf Zeneli

Përpunimi i të dhënave:

Isuf Zeneli

Haxhi Krasniqi

Lazar Mitic

Zijadin Biçkaj

Mbikëqyrja:

Avni Sahiti

Hartimi i këtij raporti nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe kontributin e Koordinatorëve Komunal të Performancës, siç janë: Lulzim Shabani (Ferizaj), Mehmet Bajrami (Mitrovicë), Fari Shkreta (Hani i Elezit), Afrim Prokshi (Drenas), Shemsi Azemi (Lipjan), Adnan Bullatovci (Fushë Kosovë), Aleksandar Nedeljkovic (Ranillug), Aleksandar Jovic (Graçanicë), Zlata Savic (Partesh), Muhidin Emini (Dragash), Agime Vuthi (Pejë), Burim Krasniqi (Kamenicë), Ibrahim Ademi (Gjilan), Lazar Andrejevic (Shtërpce), Rasim Fejza (Podujevë), Rrustem Pepshi (Junik), Islam Latifi (Vushtrri), Zana Hashani (Obiliq), Dragisa Kojic (Kllokot), Driton Raci (Klinë), Arsim Morina (Malishevë), Naim Geci (Skenderaj), Arben Shala (Prizren), Aziz Sylejmani (Shtime), Biondina Ramaj (Rahovec), Ibush Kelmendi (Prishtinë), Faton Bytyqi (Istog), Erlinda Rizvanolli (Gjakovë), Xhevat Lufaj (Deçan), Menduh Krasniqi, (Kaqanik), Mustaf Mehmeti (Viti), Ylber Kastrati (Mamushë), Sinisa Markovic (Novobërdë) dhe Avni Bytyqi (Suharekë).

Copyright 2017:

Të gjitha të drejtat janë të rezervuar. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të autorit - MAPL.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR PERFORMANCË DHE TRANSPARENÇË KOMUNALE
Divizioni për Performancë Komunale



2016

Përmbajtja

1. SHKURTESAT.....	5
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
3. KUSH DUHET TA LEXOJË KËTË RAPORT?.....	9
4. HYRJE.....	10
5. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	11
6. PSE E MATIM PERFORMANCËN E KOMUNAVE.....	13
7. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË PERFORMANCËS.....	15
8. ARRITJET E REZULTATEVE SIPAS FUSHAVE.....	21
9. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME SIPAS KOMUNAVE.....	42
10. PËRFUNDIMET.....	49
11. PROBLEMET.....	53
12. REKOMANDIMET.....	56
13. SHTOJCA 1/PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMUNAVE.....	60
14. SHTOJCA 2/ TË DHËNAT E PERFORMANCËS SIPAS TREGUESVE	131
15. SHTOJCA 3/ DOKUMENTIMI I TË DHËNAVE.....	136

 Shkurtesat

Shkurtesa	Përshkrimi
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
DPTK	Departamenti për Performancë dhe Transparencë të Komunave
DPK	Divizioni për Performancë të Komunave
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditorit
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave
USAID	United States Agency for International Development
RPK	Raporti i performancës së komunave
KKP	Koordinatori komunal për performancë
ZKP	Zyrtari komunal për performancë
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PRRK	Plani Rregullues Komunal
QSHQK	Qendra për Shërbim të Qytetarëve në Komunë
Formulari 1	Formulari për mbledhjen e të dhënave në komunë
Formulari 2	Formulari për llogaritjen e vlerave të treguesve dhe për miratim nga kryetari i komunës
%	Përqindja
Graf.	Grafiku
Kg.	Kilogram
m²	Metër katror
Km²	Kilometër katror
Tab.	Tabela



Përmbledhje ekzekutive

Me matjen e performancës së komunave, MAPL së bashku me komunat, po përpiket që synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të zbatohen me korrektësi në praktikë. Në përputhje me këtë, komunat janë duke u ofruar lloje të ndryshme të shërbimeve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e qytetarëve të saj. Ekziston një listë e pritjeve themelore të përcaktuara edhe me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (LVL) dhe lista e shërbimeve specifike të bazuara në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të komunave përkatëse. Llojet e pritjeve kanë të bëjnë me nevojat e ndryshme të qytetarëve për shërbime, ndërsa performanca e komunave ka të bëjë me matjen e nivelit të ofrimit të këtyre shërbimeve të përcaktuara me Sistemin për Menaxhimin e Performancës së Komunave (SMPK). Pritjet e qytetarëve janë bazë për kompetencat dhe funksionet e komunave për ofrimin e shërbimeve të tyre. Edhe pse komunat ofrojnë tre lloje të shërbimeve: 1). shërbimet nga Kompetencat vetanake; 2) nga kompetencat e deleguara dhe 3) nga kompetencat e zgjeruara, SMPK aktualisht mat performancën e komunave, vetëm për shërbimet e ofruara nga kompetencat vetanake.

SMPK bën matjen e performancës së komunave për 14 fusha të ndryshme themelore, të cilat përfshijnë 18 shërbime nga kompetencat vetanake të komunave. Në matjen e performancës së komunave për vitin 2016, SMPK i ka interesuar shkalla e arritjeve për 24 rezultate të ndryshme nga 14 fushat përkatëse. Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave janë: Shërbimet Publike Administrative; Të drejtat e njeriut, Shërbimet Sociale dhe Familjare; Kulturë, Rini dhe Sport; Menaxhimi i Fatkeqësive; Planifikimi Hapësinor; Hapësirat Publike; Infrastruktura Rrugore; Transporti publik komunal; Parkingjet publike; Furnizimi me ujë të pijshëm; Kanalizimi; Menaxhimi i mbeturinave dhe Mbrojtja e mjedisit.

Matja e performancës së komunave për vitin 2016 bëhet me sistem të rishikuar të performancës (SMPK). Sistemi u rishikuar si rezultat i vlerësimit të nevojave për ndryshime dhe avancim të matjes sa më profesionale të performancës së komunave dhe prodhimit të informatave të dobishme për lehtësimin e qeverisjes lokale në komuna. Në këtë proces MAPL dhe komunat u ndihmuan edhe nga partnerët e saj, si: Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë - nga HELVETAS Sëiss Intercorperation, nëpërmjet projektit DEMOS - “Decentralizim dhe Përkrahje Komunave” dhe USAID, pastaj nga palët e ndryshme të interesit, si: ministritë e linjës, shoqëria civile, biznesi dhe mediat. Periudha kohore nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2016 për komunat e Republikës së Kosovës, paraqet vazhdimësinë e përpjekjeve, sukseseve dhe të arriturve në ofrimin cilësor të shërbimeve për qytetarët, por edhe të vështirësive me të cilat ballafaqohen komunat në aktivitetet e vazhdueshme të tyre.

Procesi i menaxhimit të performancës komunale ka përfshirë edhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për zyrtarët e MAPL, koordinatorët dhe zyrtarët komunal për administrimin me sukses të SMPK në komunat e tyre. Trajnimi ka përfshirë tre module kryesore: 1. Konceptet e përgjithshme për ndërtimin dhe funksionimin e SMPK; 2. Moduli i statistikave dhe 3. Moduli specifik për zyrtarët komunal. Administrimi i SMPK në komunë është bërë sipas metodologjisë standarde, e cila ka përfshirë: mbledhjen e dokumentuar të të dhënave, verifikimin e saktësisë së tyre me dokumentet relevante, miratimin nga kryetari i komunës dhe raportimi i tyre në MAPL nëpërmjet rrugëve elektronike dhe fizike. Procedura e

pastrimit të të dhënave nga gabimet dhe verifikimi i tyre në komuna është bërë nga MAPL, nëpërmjet komisionit përkatës për verifikim të të dhënave. Përpunimi i të dhënave, nxjerrja e rezultateve dhe hartimi i raportit të performancës është bërë nga Divizioni për Performancë të Komunave (DPK), sipas metodologjisë standarde.

Hartimi i raportit të performancës për vitin 2016 është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga 35 komuna, 2 prej të cilave: Gjakova dhe Mamusha kanë raportuar në kohën shtesë, ndërsa 3 komuna nuk kanë raportuar: Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Zubin Potoku.

Analizat e të dhënave të raportuara nga komunat dhe të përpunuara nga MAPL, tregojnë për një shkallë të mesme të arritjeve të komunave prej 58.67%. Krahasuar me vitin 2015, performanca e komunave në vitin 2016 është për 12.7% më e lartë.

Komunat, për vitin 2016, kanë arritur performancë të përgjithshme prej 58.67%. Arritja e përgjithshme e performancës sipas komunave dhe renditja e komunave sipas arritjeve, fillon me komunën e Mamushës (arritja më e ulët 31.10%) dhe përfundon me komunën e Junikut (arritje më e lartë 73.57%). Është interesant se edhe Mamusha, edhe Juniku janë komuna të reja, të formuara pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Rezultati na tregon se themelimi i komunave të reja nuk mund të gjykohet për mos sukses, por nëse komunat e reja nuk janë mirë me performancën, atëherë duhet shikuar menaxhimi dhe udhëheqja e tyre. Prej 35 komunave që janë hulumtuar, shumica prej tyre (27), kanë treguar performancë të nivelit të mesëm dhe shtrihen në të dy anët e mesatares së Kosovës (58.67%). Vlerat e arritjeve kanë marrë një trajtë përafërsisht cilindrike, që tregon për shkallë të lartë të qëndrueshmërisë në matje dhe në arritje të komunave. Kjo tregon për një performancë të njëtrajtshme, pa dallime të mëdha prej njëres në komunën tjetër. Po ashtu analizat tregojnë se numri më i madh i komunave (19) kanë arritur performancë mbi mesataren e vendit. Një arritje uniforme (e njëtrajtshme) e performancës vërehet edhe sipas kategorive përkatëse të sistemit të performancës: treguesve; rezultateve dhe fushave përkatëse.

Komunat sipas arritjeve në bazë të treguesve, i kemi klasifikuar në tre grupe kryesore: komunat me arritje të ulët (1 – 33%); komunat me arritje të mesme (34 – 66%) dhe komunat me arritje të lartë (67 – 100%). Në bazë të këtij klasifikimi, numri më i madh i komunave (28) i takojnë grupit të komunave me arritje të mesme (50.17 – 64.58%), 6 komuna hyjnë në grupin e komunave me arritje të lartë (66.12 – 73.57%) dhe vetëm 1 komunë hynë në grupin e komunave me arritje të ulët, Mamusha me vetëm 33.22%.

Njëra ndër risitë e SMPK të rishikuar është raportimi i dokumentuar i të dhënave. Analizat tregojnë se shtrirja e rezultateve për dokumentimin e të dhënave është shumë e gjerë, prej 0 – 98.44%. Vlen të theksohet se shumica e komunave (14) i takon grupit të komunave me shkallë të lartë të dokumentimit (68.75 – 98.44%), pastaj vjen grupi i komunave (11 komuna) me shkallë të ulët të dokumentimit (0 – 27.50%) dhe numri më i vogël i komunave (10) i takon grupit me shkallë të mesme të dokumentimit të të dhënave (34.38 – 64.06%). Radhitja e komunave me shkallë të lartë të dokumentimit nuk është e njëjtë me radhitjen e komunave sipas performancës. Prej 6 komunave me performancë të lartë, vetëm 3 komuna: Juniku (96.88%), Prishtina (89.06%) dhe Istogu me 68.75%, kanë edhe shkallë të lartë të dokumentimit të të dhënave, ose shprehur në përqindje 43% e komunave me performancë të lartë kanë edhe shkallë të lartë të dokumentimit të të dhënave. Në përgjithësi mund të themi se performanca e lartë e komunave nuk përcillet në masën më të madhe edhe me shkallë të lartë të dokumentimit.

Për arritjen e performancës në vitin 2016 komunat (35), kanë angazhuar gjithsej 41,217 zyrtarë që paguhën nga buxheti i komunës. Në bazë të të dhënave është konstatuar se numrin më të madh të zyrtarëve të angazhuar e ka Prishtina (5247), pasuar nga Prizreni (3074) apo 220 më pak dhe Gjilani

(2670). Prishtina ka angazhuar 1 zyrtar për 37.91 qytetarë, ndërsa Prizreni me numër të përafërt të banorëve ka angazhuar 1 zyrtar për 57.83 qytetarë dhe Gjlani ka angazhuar 1 zyrtar për 33.77 qytetarë.

Në përgjithësi (mesatarisht) komunat e kanë angazhuar 1 zyrtar për 39.14 banorë (qytetarë). Krahësuar me mesataren e vendit, Prishtina me 1 zyrtar u shërben 1.23 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit, ndërsa Prizreni me 1 zyrtar u shërben 18.90 qytetarëve më shumë se mesatarja e vendit dhe Gjilani me 1 zyrtar u shërben 5.16 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit. [Shih tab.1](#). Komunat të cilat me 1 zyrtar u kanë shërbyer më pak qytetarëve janë: Parteshi 26.46 qytetarë më pak se mesatarja e vendit, Ranillugu 23.85 më pak dhe Graçanica e Klllokoti 18.70 qytetarëve më pak. [Shih tab. 1](#). Në përgjithësi komunat kanë angazhuar burime njerëzore më shumë se mesatarja e vendit, apo përkthyer në termat e statistikave nga tabela 1, komunat me 1 zyrtar u shërbejnë mesatarisht 4.43 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit. Mesataren e rrisin komunat me shumicë serbe, që u shërbejnë shumë më pak qytetarëve me 1 zyrtar nga mesatarja e vendit, përndryshe më shumë se gjysma e komunave (23 prej 35) kanë angazhuar më pak zyrtarë se mesatarja e vendit. Komuna që me 1 zyrtar u ka shërbyer më shumë qytetarëve nga mesatarja e vendit është Prizreni me 18.90 qytetarë më shumë.

Është interesant se performanca e komunave nuk është më e lartë te komunat që kanë angazhuar burime njerëzore më shumë për kokë banori.



1. Kush Duhet ta Përdorë këtë Raport?

Pse ju sjellim këto informata?

Raporti i performancës së komunave është një instrument i rëndësishëm për pasqyrimin e punës së komunave dhe promovimin e transparencës në procesin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Me këtë dokument zbatohet parimi në punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), që punët me interes të publikut të bëhen transparente për të gjithë. Informatat e sjella në këtë raport janë të rëndësishme, në radhë të parë, për të gjitha institucionet e pushtetit lokal, në veçanti për sektorët komunal të cilët janë të lidhur me fushat e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, që janë pjesë e këtij raporti. Raporti sjellë informata të rëndësishme për arritjen e rezultateve të synuara, duke specifikuar se në cilat shërbime komunat janë më mirë dhe në cilat janë më dobët. Informatat që na sjellin 64 treguesit e Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Komunave (SMPK), na tregojnë për shkallën e përmbushjes së rezultateve të pritura të vetë komunës përkatëse dhe në krahasim me komunat tjera. Pra, është me rëndësi të madhe, që të gjitha institucionet e pushtetit lokal, ta lexojnë dhe t'i përdorin këto informata shumë të rëndësishme për planifikim më të mirë të punëve dhe për lehtësim të vendimmarrjes në proceset e organizimit të punës dhe menaxhimin e burimeve në secilin institucion të nivelit lokal.

Informatat e raportit të performancës së komunave (RPK) janë shumë të rëndësishme edhe për vetë MAPL, ministritë tjera të linjës dhe agjencitë përkatëse të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi janë të lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve në nivelin lokal. Këto informata u ndihmojnë institucioneve qendrore për priorizimin e politikave dhe të burimeve në përkrahje të komunave dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve përkatëse për qytetarët.

Për bizneset dhe shoqërinë civile, këto informata janë të rëndësishme për faktin se, duke i kuptuar nevojat për ofrimin e shërbimeve, ato e kanë shumë më të lehtë organizimin dhe zhvillimin e projekteve në përkrahje të institucioneve lokale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve përkatëse. Pra bizneset dhe të gjitha palët tjera të interesit nuk kanë nevojë të bëjnë hulumtime dhe vlerësim të nevojave për fushat që mbulohen me këtë raport, por informatat e vlefshme për këtë qëllim mund t'i shfrytëzojnë nga RPK.

Raportin duhet ta lexojnë edhe vetë qytetarët, si përfitues të drejtpërdrejt të këtyre shërbimeve të ofruara nga institucionet lokale. Shpeshherë perceptimi i qytetarëve për shkallën e ofrimit të shërbimeve nuk është i saktë dhe ata kanë nevojë për informata shtesë të bazuara në dokumente zyrtare për të kuptuar se pse një shërbim është i shkallës përkatëse, qoftë i ulët apo i lartë. Raporti sjell informata të rëndësishme edhe për trendin e përmirësimit apo të keqësimit të ofrimit të shërbimeve përkatëse dhe kjo është shumë me rëndësi për qytetarët për të kuptuar se si do të jenë shërbimet në të ardhmen e afërt apo të largët, duke i ndihmuar ata edhe në adresimin më të lehtë të problemeve apo kërkesave të tyre.

 Hyrje

MAPL ka bërë rishikimin e SMPK në vitin 2016 dhe ky është raporti i parë i performancës së komunave me sistemin e ri të rishikuar. RPK pasqyron punën e komunave në ofrimin e shërbimeve për 14 fusha nga kompetencat vetanake të komunave. Me anën e këtij raporti, MAPL thekson rëndësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve dhe në veçanti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet lokale.

Secila palë e interesit që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve nga institucionet lokale, ka nevojë për informata. RPK synon që secilën palë ta mbajë në llupën e interesimit të tij. Jo të gjithë dinë t'i lexojnë radhët e gjata me të dhëna. RPK në masën më të madhe bën përkthimin e këtyre radhave të të dhënave në informata, të cilat mund të kuptohen nga secila palë e interesuar. Po ashtu, jo të gjithë kanë nevojë për lloje të njëjta të informatave, dhe për këtë RPK sjellë llojet më thelbësore të informatave për performancën e komunave, që mund të ju hyjnë në punë shumcës së palëve të interesit.

Raporti synon të sjellë në vëmendjen e juaj informata të cilat e bëjnë më të lehtë të kuptuarit e mundësive dhe të burimeve të ndryshme nga njëra, në tjetrën komunë të Republikës së Kosovës. Nëpërmjet RPK sjellim tek ju rezultatet e hulumtimit nga matja e performancës së komunave për karakteristikat e përgjithshme të performancës në shkallë vendi (të rëndësishme për institucionet qendrore) dhe për karakteristikat specifike të arritjeve të komunave përkatëse individualisht. Krahasimi i performancës ndërmjet komunave të ndryshme, krijohet mundësia e të kuptuarit më të lehtë për shkallën e arritjes së një komune për shërbimin përkatës. Të dhënat dhe informatat e këtij raporti do të shërbejnë si bazë referuese e të dhënave për vitet e ardhshme, me çka mundësohet krahasimi i përparimit apo i ngecjeve në kohë të ndryshme. Në shtojcë të raportit mund ta gjeni bazën e të dhënave sipas komunave dhe sipas treguesve e rezultateve.

Është në autoritetin e institucioneve lokale që të vendosin prioritetet e tyre të punës për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe angazhimin e burimeve përkatëse, në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti. Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme dhe individuale për shkallën e performancës së komunave. Krahas kësaj, ipen edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës në bazë të gjetjeve nga matja e performancës së komunave.

Organizimi i informatave sa i përket gjetjeve thelbësore nga matja e performancës së komunave për vitin 2016, bëhet në gjashtë kapituj kryesor: I. Përmbledhje ekzekutive, Kush duhet ta lexojë raportin, Hyrje, Metodologjia e hulumtimit dhe Pse e matim performancën e komunave II. Karakteristikat e përgjithshme të performancës; III. Arritjet e rezultateve të performancës sipas fushave; IV. Performanca e përgjithshme sipas komunave; V. Përfundimet, Problemet dhe rekomandimet dhe VI. Shtojca: Performanca individuale e komunave, Të dhënat e performancës sipas treguesve dhe komunave dhe dokumentimi i të dhënave. Pasqyrimi i informatave për rezultatet e arritura bëhet në mënyrë grafike në dy pjesë (59 grafike): 1) mbi mesatarën e vendit dhe 2) nën mesatarën e vendit, ndërsa performanca e komunave pasqyrohet në grafike horizontale, të ndara në tre shkallë: 1) komunat me shkallë të lartë; 2) komunat me shkallë të mesme dhe 3) komunat me shkallë të ulët të performancës. Gjetjet nga matja pasqyrohen edhe nëpërmjet tabelave, gjithsej 3 tabela.



2. Metodologjia e Matjes – Hulumtimit

Suksesi i një hulumtimi apo i një matje, varet shumë nga metodologjia relevante e përdorur në përputhje me natyrën e hulumtimit. Duke pas parasysh se matja e performancës është një proces mjaftë i ndërlikuar, me shumë pjesëmarrës dhe i cili zhvillohet në dy shkallë të organizimit të pushtetit, në MAPL dhe në komuna, është përdorë metoda e kombinuar (e bashkërenduar), metoda e dokumentimit dhe e verifikimit.

MAPL, e përkrahur edhe nga projekti DEMOS, ka zhvilluar një pako të dokumenteve përmbajtjesore profesionale dhe udhëzimet e punës për matjen e performancës dhe ka bërë aftësimin e koordinatorëve komunal për performancë (35) dhe të zyrtarëve komunal për performancë (210). Komunitat i kanë raportuar të dhënat parësore për 64 tregues, të mbledhura nga zyrtarët komunal për performancë (ZKP). Mbledhja e të dhënave ka qenë e bazuar ekskluzivisht në dokumente zyrtare dhe janë verifikuar nga koordinatori komunal për performancë (KKP). DPK / MAPL ka bërë kontrollimin e procesit gjatë mbledhjes së të dhënave dhe iu ka ofruar përkrahje profesionale komunave sipas nevojës. Të dhënat e verifikuara nga KKP, i ka miratuar kryetari i komunës me shkresë zyrtare. Puna është ndihmuar edhe nga drejtori i administratës komunale përkatëse. Mbledhja dhe raportimi i të dhënave është bërë me anën e një programi elektronik në excell (Formulari 1 dhe Formulari 2), zhvilluar specifikisht për këtë qëllim nga DPK. Të dhënat e raportuara nga komunitat janë kontrolluar nga DPK dhe janë identifikuar gabimet e ndryshme përmbajtjesore, teknike, numerike dhe logjike.

Për matjen e performancës janë mbledhur 203 të dhëna, po aq burime të të dhënave janë konsultuar dhe së paku 406 dokumente janë mbledhur dhe konsultuar për dokumentimin e të dhënave përkatëse për secilën komunë. Ndërkaq DPK ka përpunuar më shumë se 21,000 të dhëna gjithsej. Me kalkulimin e të dhënave janë fituar vlerat përkatëse për 64 tregues, 24 rezultateve dhe 14 fusha.

Metoda dalluese e SMPK në këtë vit, si mekanizëm për sigurimin e cilësisë së të dhënave, është dokumentimi i të dhënave të raportuara.

Pas pranimit të të dhënave nga komunitat (dt. 15 shkurt 2017), Divizioni për Performancë të Komunave në MAPL, ka bërë kontrollimin e formularëve përkatës dhe ka konstatuar për saktësinë e raportimit për të gjitha të dhënat. Në këtë vit raportimin e të dhënave nga komunitat e ka audituar edhe Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA). Krahas kontrollimit është bërë edhe analiza e të dhënave të raportuara ku janë konstatuar gabimet logjike, aritmetike dhe përmbajtjesore. Të dhënat përkatëse janë verifikuar nëpërmjet komisionit për verifikimin e të dhënave dhe janë përmirësuar. Pas pastrimit të të dhënave është bërë përpunimi i tyre sipas kërkesave për llojin e informatave, të përcaktuara me formatin e këtij raporti. Metoda kryesore për përpunimin e të dhënave ka qenë krahasimi dhe kryqëzimi i të dhënave. Me krahasimin dhe kryqëzimin e të dhënave janë prodhuar lloje të ndryshme të informatave të vlefshme, si:

1. Informata për shkallën e performancës së përgjithshme në vend sipas fushave
2. Informata për shkallën e performancës sipas rezultateve të fushave përkatëse
3. Informata për shkallën e performancës sipas treguesve të rezultateve përkatës
4. Informata për mesatarën e performancës në shkallë vendi.

5. Informatat për performancën e përgjithshme sipas komunave;
6. Informata për shkallën e performancës së grupeve të njëjta të komunave.
7. Informata për performancën individuale të komunave

Arritjet e komunave për secilin nivel të informatave janë klasifikuar në tre shkallë: niveli i lartë i arritjeve (L = 67 – 100); niveli i mesëm i arritjeve (M = 34 – 66) dhe niveli i ulët i arritjeve (U = 1 – 33). Po ashtu për arsye profesionale, komunat janë ndarë në: komuna të vogla - nën 30,000 banorë; komuna të mesme – prej 31,000 deri 59,000 banorë dhe komunat e mëdha – mbi 60,000 banorë.



3. Pse e Matim Performancën e Komunave?

3.1. Arsyet thelbësore

Matja e performancës nuk ka të bëjë thjesht me mbledhjen e të dhënave që lidhen me një qëllim të paracaktuar të performancës. Matja e performancës ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve apo të mendimeve për të kuptuar se si një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të punës ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e punës së pasukseshme, duke ndihmuar komunën në konfirmimin e arritjeve të synuara në ofrimin cilësor të shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve të saj.

Matja e performancës është një instrument i rëndësishëm i të gjitha programeve të menaxhimit të cilësisë. Menaxherët dhe mbikëqyrësit që i drejtojnë përpjekjet e një institucioni, kanë përgjegjësi ta dinë se si, ku, dhe kur duhet t'i marrin masat për ndryshimet e nevojshme në zhvillim të institucionit. Këto ndryshime nuk mund të planifikohen dhe zbatohen pa informata të besueshme dhe relevante mbi të cilat bazohen vendimet për ndryshimet eventuale, por edhe për përparimin e atyre shërbimeve që janë mirë.

SMPK mat kryesisht aspektet sasiore të ofrimit të shërbimeve dhe po ashtu edhe RPK raporton informata për sasinë e ofrimit të shërbimeve. Matjet sasiore janë një mjet për të na ndihmuar që ta kuptojmë se sa mjaftë ofrohen shërbimet dhe që ta menaxhojmë në mënyrë profesionale përmirësimin e punës së komunave. Fatkeqësisht në këtë fazë të zhvillimit të SMPK, cilësia e ofrimit të shërbimeve matet vetëm me një numër të vogël të treguesve. SMPK aktualisht nuk është i ndërtuar që të mat sasinë dhe cilësinë referente (standarde) të shërbimeve (sa mjaftë dhe sa mirë ofrohen ato nga komuna), por matë vetëm trendin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve. Në bazë të kësaj, matja e performancës na tregon se:

- sa mirë po punojnë komunat?
- nëse komunat po i arrijmë qëllimet e tyre apo jo?
- nëse proceset menaxhuese janë në drejtimin e duhur?
- nëse janë, ku janë të nevojshme përmirësimet që duhet bërë? Etj.
- ndërkaq për atë se sa janë të kënaqur qytetarët me shërbimet e ofruara, do të sillen në një raport tjetër të performancës.

Matja e performancës ofron informacione të nevojshme për të marrë vendime të duhura rreth asaj se çfarë duhet të bëjnë komunat.

3.2. Qëllimi i matjes së performancës

Në bazë të hulumtimeve të shumta, në këtë rast po e veçojmë hulumtimin e bërë nga Universiteti i Harvardit, tregon se në përcaktimin e qasjes së matjes së performancës, në masën më të madhe ndikon qëllimi i matjes së performancës¹. Pra secila matje është e lidhur me një qëllim. Qëllimi përcakton të gjitha mjetet, procedurat dhe proceset tjera të matjes së performancës së komunave. Qëllimi i matjes duhet t'i përgjigjet pyetjes – pse bëhet matja e performancës së komunave?

Pra matja e performancës bëhet me qëllim të monitorimit të ofrimit të shërbimeve nëpërmjet matjeve të vlefshme të performancës së komunave, të ofrojë informata të nevojshme për lehtësimin e vendimmarrjes në komunë, të motivojë organet e pushtetit lokal dhe të promovojë përgjegjësinë dhe llogaridhënien gjatë punës së tyre në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Matjet e performancës duhet të sjellin informata të mjaftueshme për të arritur këtë qëllim. Nëse nga të dhënat e matjes së performancës së komunave nuk prodhojmë informata të nevojshme për këtë qëllim, matja e performancës nuk është e vlefshme. Të dhënat dhe informatat e këtij raporti tregojnë se matja e performancës është në përputhje të plotë me qëllimin e matjes së performancës së komunave.

¹ Robert Behn, Public Administration Review, Harvard University 2003, vol. 3, fq. 3.



4. Karakteristikat e Përgjithshme të Performancës së Komunave

Raporti i performancës së komunave (tani e tutje raporti) sjellë informata të rëndësishme dhe të dobishme për shkallën e arritjeve të komunave në punën e tyre gjatë vitit 2016. Raporti sjellë informata të përgjithshme analitike me qëllim të krijimit të një baze referuese për krahasimin e arritjeve të performancës ndër vite. Për shkak të ndërtimit dhe funksionimit të ndryshëm të SMPK nga sistemi i mëparshëm, raporti nuk ka mundësi të sjellë shumë informata të vlefshme në krahasim me performancën e viteve të mëparshme. Raporti gjithsesi do të sjellë informata që pasqyrojnë trendin e arritjeve të komunave ndër vite për ato rezultate dhe tregues ku mund të krahasohen.

Për matjen e performancës në vitin 2016, janë përfshirë të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Prej 38 komunave, sa janë gjithsej, 35 komuna kanë arritur t'i raportojnë të dhënat për matjen e performancës së tyre me SMPK e rishikuar. Prej tyre, 33 komuna i kanë raportuar të dhënat e miratuara në kohën zyrtare (15 shkurt 2017) dhe 2 komuna i kanë raportuar të dhënat në kohën shtesë, ku njëra prej tyre i ka raportuar të dhënat e pa miratuara nga kryetari i komunës. Të dhënat e raportuara në kohën shtesë, nuk janë verifikuar dhe pastruar nga gabimet e mundshme, sikur edhe të 1 komune (Leposaviqi) e cila ka raportuar në afatin zyrtar dhe si të tilla janë me shkallë të ulët të besueshmërisë. Me rastin e vlerësimit për përfitimin e fondeve eventuale, rekomandohet që të dhënat e këtyre dy komunave të mos merren në konsiderim.

Matja e performancës së komunave me SMPK e rishikuar ka prodhuar informata të rëndësishme për arritjet e përgjithshme dhe specifike të komunave për vitin 2016. Informatat për arritjet e përgjithshme të komunave janë klasifikuar në tre nivele të pasqyrimin të performancës: në nivelin e fushave, në nivelin e rezultateve dhe në nivelin e treguesve. Pasqyrimi i informatave për këto tri nivele janë të dobishme për marrjen e vendimeve strategjike dhe hartimin e politikave prioritare për zhvillimet në vetëqeverisjen lokale (VQL).

4.1. Performanca e përgjithshme sipas fushave


Sistemi për menaxhimin e performancës komunale (SMPK) matë aktualisht performancën e komunave vetëm për 18 kompetenca vetanake, të grupuara në 14 fusha përkatëse. Rezultatet janë pasqyruar për 13 fusha, 1 fushë – Hapësirat publike matet me njësi tjetër dhe është pasqyruar në kuadër të rezultateve. Fushat janë niveli më i lartë i pasqyrimin të informatave për shkallën e performancës së komunave, por nuk janë pika referuese e shkallës së arritjes së komunave.

Analizat e përgjithshme tregojnë se arritja e përgjithshme e performancës së komunave në nivel vendi është 58.67%. Kjo është afër 13% më e lartë se performanca e komunave për vitin 2015, edhe pse krahasimi është jo mjaftë i vlefshëm për faktin se matja e performancës për vitin 2016 është bërë me një metodologji plotësisht tjetër.

Hulumtimet e bëra tregojnë se fushat me arritje më të lartë, në nivel vendi janë: fusha e shërbimeve publike administrative me 91.30%, pasuar nga transparenca komunale me 78.71%. Prej 14 fushave të

analizuara, gjashtë fusha, afër gjysma prej tyre, janë me arritje të lartë dhe shtrihen mbi mesataren e vendit, prej 72.71 – 91.30%; pesë fusha janë me arritje të mesme dhe shtrihen nën mesataren e vendit, prej 56.51 – 45.73% dhe vetëm dy fusha janë me arritje të ulët prej 21.76 – 29.24%. Duhet të sqarohet se një fushë - hapësirat publike, performanca e të cilës pasqyrohet me m^2 / për kokë banori, nuk është futur në grupin e 13 fushave tjera sepse vlerat e arritjes nuk mund të krahasohet me vlerat fushave tjera shprehur në përqindje. Fusha e hapësirave publike ka një performancë prej $4.18 m^2$ për kokë banori.

Është shumë me rëndësi se në grupin e fushave me arritje të lartë, hyjnë pothuajse të gjitha grupet e shërbimeve themelore, si: shërbimet publike administrative, transparenca, menaxhimi i fatkeqësive, menaxhimi i mbeturinave, ujë i pijshëm, kulturë, rini dhe sport. [Shih graf. 1](#). Nga grupi i fushave me arritje të mesme, mund të kuptojmë se një grup i shërbimeve të rëndësishme, si: trajtimi i ujërave të zeza (45.73%), planifikimi hapësinor (46.09%), infrastruktura rrugore (48.54%) dhe mbrojtja e mjedisit (49.57%), kanë nevojë për trajtim me prioritet gjatë planifikimeve në të ardhmen. [Shih graf. 1](#). Fusha me arritje më të ulët është ajo e të drejtave të njeriut dhe e mirëqenies sociale e familjare, me vetëm 21.76%.



Përfundim. Nga matja e performancës së komunave për vitin 2016, për nivelin e fushave, konstatohet se arritjet e komunave janë të nivelit mesatar dhe të lartë. Në dy fusha: të drejtat e njeriut me shërbimet sociale e familjare dhe infrastruktura rrugore, edhe pse janë bërë investime të mëdha, nuk janë shënuar përpertime të dëshirueshme apo në përputhje me investimet e bëra.



4.2. Performanca e përgjithshme sipas rezultateve


Rezultatet janë arritje afatshkurtra apo afatgjata që komunat i synojnë t'i arrijnë në secilën prej 14 fushave të SMPK. I tërë sistemi për matjen e performancës së komunave është i orientuar në rezultate. Kjo do të thotë se performanca e komunave matet me shkallën e arritjes së rezultateve. Për secilën fushë është i caktuar një numër përkatës i rezultateve. SMPK gjithsej ka 24 rezultate apo mesatarisht 1.79 rezultate për secilën fushë. Rezultati tregon se shërbimi është ofruar në sasinë apo cilësinë përkatëse të planifikuar dhe që ndikon drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Rezultatet sjellin informata të dobishme për shkallën e performancës së komunave. Se deri në çfarë shkalle janë arritur rezultatet në fushat përkatëse nga ana e komunave, na informojnë treguesit e secilit rezultat të SMPK.

Rezultatet e pasqyruara u ndihmojnë udhëheqësve të nivelit strategjik për t'i kuptuar shpejtë nevojat për veprime përkatëse me prioritet në përmirësimin e performancës së komunave.

Analizat e përgjithshme tregojnë se arritja e përgjithshme e performancës së komunave është e njëjtë me atë të fushave. Në mungesë të standardeve dhe në pamundësi të krahasimit me performancën e viteve të mëparshme (për shkak të ndryshimeve pas rishikimit të SMPK), shkallën e arritjes së rezultateve për vitin 2016 e kuptojmë nëpërmjet standardeve të brendshme, krahasimit të arritjeve me mesataren e vendit dhe krahasimit ndërmjet rezultateve dhe treguesve të shprehura në përqindje (%), m² dhe kg. për kokë banori. Arritja e performancës për vitin 2016 do të jetë baza referuese (krahasuese) për të kuptuar trendin e përparimit apo të përkeqësimit të performancës në të ardhmen.


Hulumtimet tregojnë se arritja e rezultateve është në përputhje të plotë me arritjet e fushave përkatëse, por me një shtrirje më të gjerë për rezultatet me shkallë të lartë arritjeve. Prej 24 rezultateve, 12 rezultate apo afër 50% prej tyre i takojnë nivelit të lartë të arritjeve. Në përgjithësi shtrirja e arritjes së rezultateve është e rregullt, me pjesëmarrjen e të tri niveleve të arritjes, e shpërndarë në formë trapezi, që tregon për matje të vlefshme. Shtrirja e vlerave të 50% të rezultateve në një interval të ngushtë prej 66.74 – 91.30%, tregon për një matje dhe arritje të qëndrueshme. Rezultatet më të arritura në nivel vendi janë: ofrimi i shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve, me 91.30%, pasuar nga furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm sipas standardeve, me 86.70%. **Shih graf. 2.** Është me rëndësi se të dy këto rezultate matin sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve. Shtrirja e rezultateve me arritje të lartë përfshinë një gamë më të gjerë të ofrimit të shërbimeve themelore dhe thelbësore. **Shih graf. 2.** Në grupin e rezultateve me arritje të mesme dhe të ulët hyjnë shërbimet tjera themelore me një shpërndarje përafërsisht të barabartë në numër: 4 me arritje të mesme dhe 6 rezultate me arritje të ulët.

Graf. 3. Rezultatet e performancës shprehur me m/2 dhe kg. për kokë banori



Shih graf. 2. Edhe këtu arritja më e lartë dhe më e ulët është e shënuar në shërbimet sipas kërkesave të qytetarëve (L) dhe në sigurimin e barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi (U).

Dy rezultate janë të shprehura me njësi të ndryshme matëse: hapësirat publike me mjedis të shëndetshëm (4.18 m^2 / kokë banori) dhe deponimi i mbeturinave ($169.09 \text{ kg./kokë banori}$). Sa më e madhe sipërfaqja në m^2 / kokë banori aq më e lartë është performanca e komunës përkatëse, ndërsa sasia e madhe e deponimit të mbeturinave në kg./kokë banori , potencialisht tregon performancë më të lartë, por jo gjithherë. Sa më shumë deponim të mbeturinave, potencialisht do të duhej të kishim më pak mbeturina në mjediset jetësore, por kjo rëndom nuk ndodhë, për shkak se nuk grumbullohen dhe nuk deponohen të gjitha mbeturinat e prodhuara nga ekonomitë përkatëse. Shih graf.3.




Përfundim. Nga matja e performancës së komunave për vitin 2016, për nivelin e rezultateve, konstatojmë se arritja mesatare e rezultateve është 59.05%, apo 0.27% më e lartë se mesatarja e përgjithshme e performancës në shkallë vendi. Shumica e rezultateve (12) janë me arritje të lartë të performancës, 4 rezultate janë me arritje të mesme dhe me arritje të ulët janë 6 rezultate. Prej 6 rezultateve me arritje të ulët, 4 prej tyre kërkojnë trajtim me prioritet më të lartë, si: sigurimi i qytetarëve në rrugë, planifikimi i


qëndrueshëm komunal, ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare dhe sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi. Shih shtrirjen e secilës kategori të arritjeve të rezultateve në Graf.2.

4.3. Karakteristikat e përgjithshme të performancës sipas rezultateve

Raporti i performancës për vitin 2016 mundëson të bëjmë krahasime të ndryshme të brendshme për të kuptuar se cilat janë arritjet më karakteristike: ato ekstreme, arritjet në rritje dhe arritjet në ulje. Në bazë të analizave të përgjithshme mund të kuptojmë se komunat kanë shënuar arritje jo të njëtrajtshme për të gjitha shërbimet që maten nëpërmjet SMPK. Në graf. 4. mund të vërejmë shtrirjen e rezultateve të tri niveleve për shërbime të rëndësishme për qytetarët. Me ndihmën e kësaj teknike mund t'i lexojmë shumë shpejtë dhe lehtë nevojat se ku duhet të përqendrohemi në përmirësimin e performancës në të ardhmen. Po ashtu kjo na ndihmon në nxjerrjen përfundimeve dhe vendimeve të shpejta për reagime të shpejta apo priorizimin e shpejtë të punës. Shih graf. 4.



Përpos shtrirjes ekstreme të rezultateve, dallojmë edhe shtrirjen në rritje të shkallëzuar të rezultateve. Në graf. 5. vërejmë shtrirjen shkallë, shkallë të rezultateve në rritje, nga rezultatet e larta. Dallimet në rritje nuk janë të theksuara, shtrirja e vlerave të arritjes është në një interval relativisht të ngushtë (76 – 91%), që na tregon për një rritje të ngadalshme dhe të qëndrueshme. Kjo formë e shpërndarjes së rezultateve na ndihmon në marrjen e




vendimeve të peshuara dhe zhvillimin e politikave afatgjata për përmirësimin e performancës për këto rezultate. Tre rezultatet me arritje më të lartë në graf. 5. tregojnë se tani duhet të përqendrohemi më shumë në përmirësimin e cilësisë.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i shtrirjes së rezultateve të performancës së komunave është vlera e arritjeve në ulje graduale. Shtrirja në ulje e rezultateve të këtyre

shërbimeve, gjithashtu nuk është me dallime të mëdha (30.46 – 14.62%) dhe tregon për një grup të rezultateve që kërkojnë prioritet të menjëhershme nga ana e institucioneve lokale dhe qendrore. Shih graf. 6.

Tri rezultate të cilat kërkojnë prioritet në përmirësimin afatgjatë të komunave, janë: sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi (14.62%), planifikimi i qëndrueshëm komunal (27.68%) dhe trajtimi i ujërave të zeza (28.89%). Shih graf. 6.





5. Arritjet e Rezultateve sipas Fushave

Rezultatet përfaqësojnë strukturën referuese të arritjes së performancës së komunave, që tregohet ndërmjet treguesve. Secili rezultat i takon një fushe të caktuar dhe në të njëjtën kohë ai informohet nga një grup i caktuar i treguesve. Grupi i treguesve na tregon për shkallën e arritjes së rezultatit përkatës dhe grupi i rezultateve përkatëse tregon për shkallën e arritjes së fushave përkatëse. Derisa SMPK është i bazuar kryesisht në shkallën e arritjes së rezultateve, atëherë edhe pjesa kryesore e raportit i kushtohet arritjes së rezultateve në kuadër të fushave përkatëse. Në vazhdim i gjeni informatat e nevojshme për shkallën e arritjes së rezultateve sipas fushave dhe treguesve përkatës, si pjesa kryesore e gjetjeve nga ky hulumtim.

5.1. Shërbimet publike administrative

Matja e performancës së komunave për ofrimin e shërbimeve publike administrative bëhet për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me shërbimet publike administrative. Në kuadër të shërbimeve publike administrative hyjnë të gjitha kërkesat të cilat menaxhohen nga QSHQK. Performanca e komunave për këtë fushë matet vetëm me një rezultat: - *Ofrimi i shërbime sipas kërkesave të qytetarëve*.


Rezultati (1.1) pasqyron përqindjen e lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit, të cilat janë regjistruar në QSHQK, me theks të veçantë në respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen lëndëve të parashtruara nga qytetarët që janë kompetencë e komunës. Për arritjet e këtij rezultati, informohemi nga dy tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
1.1.1.	% e lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit	96.05
1.1.2.	% e lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore.	86.54

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur ofrimi i shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve? Analiza e të dhënave tregon se lëndët e parashtruara të qytetarëve janë shqyrtuar në shkallën 96.5%, ndërsa prej tyre brenda afatit ligjor janë shqyrtuar 86.54%. Shprehur me shifra janë parashtruar gjithsej 2,007,166 lëndë dhe janë shqyrtuar gjithsej 1,914,530 lëndë apo 1.09 lëndë për kokë banori. Në bazë të kësaj rezultojnë se rezultati është përmbushur në masën prej 91.30%. Me që fusha ka vetëm këtë rezultat, atëherë shkalla e përmbushjes së fushës është e njëjtë me rezultatin (91.30%). Rezultati tregon edhe për shkallën e lartë të efikasitetit të administratës komunale.

Interpretimi

Shkalla e arritjes së rezultatit, nëpërmjet vlerave të treguesve, është në përputhje të plotë me qëllimin e matjes së performancës në këtë fushë. Qytetarët presin me të drejtë që lëndët e tyre të shqyrtohen dhe t'i zgjidhin problemet me të cilat përballen. Arritja e rezultatit në shkallën 91.30% është me rëndësi të madhe, në radhë të parë për qytetarët, pastaj për komunën, për



MAPL dhe për palët tjera të interesit. Shqyrtimi i lëndëve brenda afatit ligjor deri në shkallën 86.54% është një tregues i rëndësishëm se performanca e komunave në këtë fushë është shumë e lartë dhe trendët tregojnë se kjo do të përmirësohet edhe më shumë në të ardhmen. Fatkeqësisht rezultati tregon më shumë statistikë, sepse rezultati nuk na sjellë informata se sa përgjigjejet kanë qenë në përputhje me ligjin dhe në përputhje me kërkesat e qytetarëve. Megjithatë në të ardhmen, puna e komunave do të lehtësohet edhe nga teknologjia informative për shpejtimin e shqyrtimit brenda afateve dhe në përputhje me ligjin.

5.2. Transparenca komunale

Transparenca komunale i referohet pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në organet komunale dhe krijimin e mekanizmave për informimin e tyre kur ata nuk mund të marrin pjesë. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: - 1). *Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë dhe 2). Sigurimi i qasjes së qytetarëve në dokumente publike.*

Rezultati i parë (2.1.) pasqyron arritjet e komunave që kanë të bëjnë me rritjen e transparencës komunale duke promovuar pjesëmarrjen e publikut në proceset e vendim-marrjes. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
2.1.1.	% e mbledhjeve të kuvendit dhe komisioneve komunale të bëra publike për qytetarët	89.01
2.1.2.	% e akteve të miratuara në kuvendin komunal për të cilat është konsultuar publiku.	46.94
2.1.3	Konsultimi i publikut për miratimin e kornizës afatmesme dhe buxhetit komunal	95.71

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje në komunë? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 2.1. është arritur në shkallën 77.22%, ku arritja më e lartë është shënuar në konsultimin e publikut për kornizën afatmesme dhe buxhetin komunal (95.71%), po ashtu arritje e lartë është shënuar edhe në bërjen publike të mbledhjeve të kuvendit për miratimin e akteve komunale (89.01%). Arritje mesatare, por nën mesataren e vendit, është shënuar në konsultimin e publikut për miratimin e akteve në kuvendin komunal (46.94%).


Rezultati i dytë (2.2) pasqyron arritjet e komunës ose të komunave në sigurimin e qasjes së qytetarëve dhe të palëve të ndryshme të interesit në dokumentet publike sipas përcaktimeve ligjore. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
2.2.1	% e publikimit të akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	90.94
2.2.2.	% e publikimit të akteve me karakter të përgjithshëm të miratuara nga kryetari i komunës në faqen zyrtare të komunës	69.38
2.2.3	% e publikimit të dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	83.00
2.2.4	% e publikimit të dokumenteve të prokurimit publik të komunës	62.86
2.2.5	% e realizimit të kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike	94.14
2.2.6	% e përbushjes së kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	80.86

Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 2.2. është arritur në shkallën 80.20%, ku arritja më e lartë është shënuar në qasjen e dokumentave zyrtare nga qytetarët (94.14%) dhe në publikimin e akteve të miratuara në kuvendet komunale (90.94). Treguesit të cilët kanë shënuar një arritje relativisht të lartë por qëndrojnë më keq nga treguesit tjerë, janë publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm të miratuara nga kryetari i komunës (69.38%) dhe publikimi i dokumenteve të prokurimit publik (62.86%).

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë të lartë prej 78.71%. Vlerat e larta në përqindje tregojnë për shkallë të lartë të performancës. Shkalla e arritjes së rezultateve, nëpërmjet vlerave të treguesve, është në përputhje të plotë me qëllimin e matjes së performancës në këtë fushë. Shtrirja e arritjeve të performancës së komunave prej 62.86 – 94.14%, tregon për një shkallë relativisht të lartë të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe në bërjen publike të punëve të komunës. Ajo çfarë është problem këtu, është përqindja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, që SMPK nuk e mat aktualisht këtë. Rekomandohen komunat që t'i ndërtojnë mekanizmat e nevojshëm për rritjen e transparencës përmbajtësore krahas asaj formale, që të sigurojnë pjesëmarrje kualitative të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në komunë dhe jo vetëm dërgimi formal i ftesave.



5.3. Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare

Matja e performancës së komunave për të drejtat e njeriut, mirëqenien sociale dhe familjare ka për qëllim identifikimin e përparësive dhe dobësive të shënuara në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve shumë të ndjeshme të kësaj fushe. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: 1). *Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi dhe* 2). *Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare.*

Rezultati i parë (3.1) përfaqëson arritjen kryesore të komunës ose të komunave për krijimin e një mjedisi jetësor që i trajton në mënyrë të barabart apo pa diskriminim të gjithë qytetarët, në veçanti grupet e marginalizuara dhe në nevojë të shoqërisë. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
3.1.1	% e të punësuarve me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, sipas përkatësisë gjinore	0.33
3.1.2.	% e të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	35.53
3.1.3	% e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë sipas përkatësisë gjinore	8.00

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 3.1. është arritur në shkallën 14.62%, ku arritja më e lartë është shënuar në përqindjen e të punësuarve të gjinisë femrore 35.53% prej 49.65% sa ka gjithsej femra në shkallë vendi. Punësimi i personave me aftësi të kufizuar (0.33%) dhe punësimi i komuniteteve jo – shumicë (8.10%), tregojnë për arritje të pamjaftueshëm të këtij rezultati. Edhe të punësuarit ferma nga komuniteti jo-shumicë është 32.84%, performancë e përafërt me përqindjen e përgjithshme të punësuar

femra në komuna (35.53%). Ky rezultat ka arritjen më të ulët të performancës së komunave si vlerë për vitin 2016.


Rezultati i dytë synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në ofrimin e kushteve bazike për jetesë të qytetarëve në nevojë, si: banimi, mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje dhe ndihma sociale. Po ashtu synohet të arrihet ngritja e standardit jetësor dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga katër tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
3.2.1	% e familjeve në nevojë të cilave iu është siguruar banimi	31.60
3.2.2.	% e popullatës e cila përfiton nga skema sociale	2.47
3.2.3	% e ankesave të miratuara për skemën e ndihmës sociale	23.05
3.2.4	% e fëmijëve në nevojë me strehim familjar	58.42

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 3.2. është arritur në shkallën 28.89%, që është 14.2% më i lartë se rezultati 3.1 i kësaj fushe. Arritja më e lartë është shënuar në strehimin familjar të fëmijëve (58.42%) dhe në strehimin e familjeve në nevojë (31.60). Arritje e ulët është shënuar në shkallën e përfitimit nga skema sociale (2.47%) dhe në përfitimin nga skema sociale nëpërmjet ankesave të ushtruara nga qytetarët. Edhe pse ky rezultat është me arritje më të lartë se rezultati 2.1, në përgjithësi rezultatet e kësaj fushe nuk kanë shënuar arritje të kënaqshme.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë prej 21.79%. Vlerat e ulëta në përqindje tregojnë për shkallë të ulët të performancës. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 0.33 – 58.42%, tregon për një shpërndarje relativisht të madhe të vlerave të performancës, që na jep të kuptojmë se planifikimi i rezultateve dhe ndërtimi i treguesve nuk janë mjaftueshëm në harmoni me njëri tjetrin, qoftë në dimensionin vertikal, po ashtu edhe në atë horizontal. Megjithatë vlerat e ulëta, në këtë rast, nuk duhet përkthyer gjithëherë në performancë të ulët, sepse treguesit nuk matin aktualisht tërësinë e problemit. P.sh. shkalla e punësimit të personave me aftësi të kufizuara prej 0.33%, si vlerë është e ulët, sepse numri i tyre është llogaritur në raport me numrin e përgjithshëm të të punësuarve në komunë dhe jo në raport me numrin e popullatës së personave me aftësi të kufizuara, që duhet të jetë thelbi i matjes së treguesit. Fatkeqësisht kjo nuk mund të matet tani në mungesë të regjistrimit të numrit të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara në vend. Po ashtu punësimi i komunitetit jo-shumicë prej 8.10% si vlerë është e ulët në raport me numrin e përgjithshëm të të punësuarve në nivelin komunal, por në raport me numrin e popullatës jo-shumicë, punësimi në nivel vendi është 2% më i lartë se numri i tyre i përgjithshëm prej 6.48%². Treguesi duhet të matë përqindjen e të punësuarve nga komunitetit jo-shumicë në raport me popullatën jo-shumicë, por aktualisht edhe kjo nuk është e mundur për shkak të



² ASK, Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë 2013, fq.13

mos pjesëmarrjes së komunitetit serb në regjistrimin zyrtar të popullsisë dhe numri i popullatës së komunitetit jo-shumicë aktualisht nuk është zyrtar.

5.4. Kulturë, rini dhe sport

Matja e performancës në këtë fushë përfshin çfarëdo lloj aktiviteti për të cilin komunat janë direkt (si organizator) ose indirekt (si bashkë-organizator). Fusha synon të matë tri dimensione thelbësore: ndërtimin e kapaciteteve fizike, organizimin e veprimtarive dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këto veprimtari. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: 1). *Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive dhe 2). Rritja e numrit të veprimtarive kulturore, rinore e sportive dhe e pjesëmarrjes së qytetarëve.*

Rezultati i parë (4.1.) përfaqëson arritjet e komunës ose të komunave për krijimin e kushteve të nevojshme për veprimtari sportive, kulturore dhe rinore, me theks të veçantë ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga një tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
4.1.1	% e realizimit të planit komunal për ndërtimin e kapaciteteve për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive	71.00

Rezultati tenton t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në ndërtimin e kapaciteteve infrastrukturore për ushtrimin e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 4.1. është arritur në shkallën 71.00%, po aq sa është shënuar arritja e treguesit të vetëm të këtij rezultati. Treguesi përfaqëson arritjet e përbashkëta të të dhënave të ndara për kulturë, rini dhe sport. Në shkallë vendi mesatarisht janë realizuar 12 projekte infrastrukturore për kulturë dhe 11.21 projekte për sport, ndërsa për rini vetëm 5.30 projekte. Për kulturë janë realizuar 41.51% dhe për sport 40.71% e projekteve të planifikuara. Arritjen e përgjithshme të këtij rezultati e ulë, shkalla e ulët e realizimit të projekteve për rini që është 17.78%.

Rezultati i dytë (4.2.) përfaqëson arritjet e komunës përkatëse ose të komunave për rritjen e numrit dhe llojeve të veprimtarive sportive, kulturore dhe rinore, me theks të veçantë rritjen e numrit të pjesëmarrësve të qytetarëve në veprimtaritë e ndryshme kulturore, rinore e sportive. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi prej dy treguesve:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
4.2.1	% e realizimit të veprimtarive të planifikuara për kulturë, rini dhe sport	85.64
4.2.2.	% e pjesëmarrjes së qytetarëve sipas veprimtarive për kulturë, rini dhe sport	63.22

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në rritjen e numrit të veprimtarive kulturore, rinore e sportive dhe pjesëmarrjes së qytetarëve? Edhe të dhënat e këtyre dy treguesve na informojnë se rezultati 4.2. ka një arritje të lartë prej 74.43%, 15% mbi mesataren e vendit. Këtu vërehet një rritje e konsiderueshme e organizimit të veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive me 85.64%, por edhe pjesëmarrja e qytetarëve në veprimtaritë përkatëse është mjaftë e lartë (63.22), duke pas parasysh se treguesi mat për herë të parë. Treguesi 4.2.2, në disa komuna, ka treguar matje jo reale.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë prej 72.71%. Vlerat e larta në përqindje tregojnë për shkallë të lartë të performancës. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 63.22 – 85.64%, tregon për një matje të qëndrueshme dhe ndërtim të mirë ndërmjet rezultateve dhe treguesve. Këto karakteristika ndihmojnë qëllimin e matjes me saktësi. Gjatë matjes janë paraqitë probleme të vogla në dallimin ndërmjet ndërtimit të infrastrukturës dhe organizimit të veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive. Në përgjithësi treguesi ka matë mirë, por në komunën e Graçanicës dhe Ranillugut, pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë mbi 100%.

5.5. Menaxhimi i fatkeqësive

Matja e performancës në këtë fushë përfshinë mbrojtjen e njerëzve dhe të pasurisë së tyre private dhe publike, si: mbrojtja nga zjarret, tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët e bores, thatësitat, shpërthimi i sëmundjeve infektive, shkatërrimet e digave dhe aksidentet e ndryshme ekologjike. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e një rezultati: 1). *Mbrojtja e qytetarëve dhe e pasurisë së tyre nga fatkeqësitë*.


Rezultati (5.1.) përfaqëson arritjen kryesore që e synon komuna ose komunat në mbrojtjen e qytetarëve dhe të pasurisë së tyre nga fatkeqësitë e ndryshme të shkaktuara nga dukuritë natyrore dhe nga vetë njeriu. Rezultati përfshinë në veti produktet e veprimeve parandaluese të komunës përkatëse për zvogëlimin e shkallës së rrezikut të fatkeqësive të lidhura me ciklet e dukurive natyrore të përsëritura gjatë vitit dhe rezultatet e veprimit të organeve përkatëse komunale gjatë kohës së ndodhjes së fatkeqësisë. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga dy tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
5.1.1	% e realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	61.44
5.1.2	% e intervenimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë	92.21

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa janë mbrojtur qytetarët dhe pasuria e tyre nga fatkeqësitë? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 5.1. është arritur në shkallën 76.83%. Në arritjen e këtij rezultati relativisht të lartë, kanë kontribuar dy treguesit përkatës (5.1.1 dhe 5.1.2). Në ciklin e menaxhimit të fatkeqësive, komunat kanë treguar shkallë të lartë (92.21%) të intervenimit për mbrojtje nga fatkeqësitë, por në realizimin e planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive, kanë treguar një rezultat mesatar prej 61.44%.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë relativisht të lartë prej 76.83%. Vlerat e larta në përqindje tregojnë për shkallë të lartë të performancës së komunave, por kjo nuk do të thotë se puna është mirë. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 61.44 –



92.21%, tregon për një shtrirje të gjerë të vlerave të matjes, e cila na jep të kuptojmë se realizimi jo i mjaftueshëm i planeve për menaxhimin e fatkeqësive ka sjellë një numër të madh të fatkeqësive (8,834) dhe një përgjigje mjaftë efektive të ekipeve për menaxhimin e fatkeqësive prej 92.21% të rasteve. Ajo çfarë duhet të arrihet është përqindja e lartë e realizimit të planeve për mbrojtje nga fatkeqësitë, e cila ndikon në uljen e rasteve të larta të fatkeqësive dhe si rrjedhojë edhe uljen e nevojës për reagim në menaxhimin e fatkeqësive. Komunitat duhet të investojnë më shumë në fazën e parandalimit se sa në fazën e reagimit për mbrojtje nga fatkeqësitë!

5.6. Planifikimi hapësinor

Informatat e prodhuara nga matja e performancës në këtë fushë ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe priorizimin e kapaciteteve planifikuese komunale për rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të planifikuara komunale. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: 1). *Planifikimi i qëndrueshëm komunal dhe 2). Ndërtimi i planifikuar komunal.*

Rezultati (6.1.) përmbledh veprimet e zhvilluara të autoriteteve komunale në zbatimin e planit zhvillimor komunal (PZHK), të Planit Rregullues Komunal (PRRK), edhe të Hartës Zonale të Komunës (ku është zhvilluar) dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme. Performanca e komunës përkatëse është e ndërlidhur me shkallën e respektimit procedurave për dhënien e kushteve për ndërtim dhe lëshimin e lejeve ndërtimore në pajtim me tërësinë e kritereve mbi të cilat janë zhvilluar instrumentet përkatëse urbanistike. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga një tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
6.1.1	% e territorit të komunës për të cilat ekzistojnë planet rregulluese (të hollësishme) – hartat zonale	27.68

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në planifikimin e territorit të komunës? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 6.1. është arritur në shkallën 27.68%. Në arritjen e këtij rezultati me shkallë të ulët, na ka informuar vetëm treguesi 6.1.1. Në bazë të vlerës së treguesit (27.68%), që është edhe shkalla e arritjes së këtij rezultati, mund të kuptojmë se territori i komunave ende është në shkallë të ulët të planifikimit dhe vendbanimet në territoret e komunave nuk janë ose janë në shkallë të ulët të planifikimit.

Rezultati (6.2.) synon të përmbushë nevojat e qytetarëve, bizneseve dhe palëve të tjera të interesit për ndërtim. Drejtpërdrejt apo tërthorazi ndihmon dhe orienton ndërtimin e planifikuar komunal dhe parandalon ndërtimet e paligjshme. Nëpërmjet këtij rezultati mundësohet shfrytëzimi i planifikuar i tokës, respektivisht hapësirës dhe i burimeve tjera mjedisore e infrastrukturore në interes të qytetarëve, institucioneve publike dhe bizneseve. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre treguesve:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
6.2.1	% e kërkesave të miratuara për leje të ndërtimit	75.43
6.2.2	% e ndërtesave të reja të inspektuara	71.91
6.2.3	% e objekteve të reja me leje të ndërtimit	60.87

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në ndërtimin e planifikuar të vendbanimeve? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 6.2. është arritur në shkallën 69.40%. Në arritjen e këtij rezultati me shkallë të lartë, kanë informuar tre tregues (6.2.1; 6.2.2 dhe 6.2.3). Nga vlerat e këtyre treguesëve mund të kuptojmë se kërkesat e qytetarëve për leje të ndërtimit janë miratuar deri në shkallën 75.43%, inspe-

ktimi i ndërtesave të reja është realizuar më pak, deri në shkallën 71.91% dhe nga inspektimi i bërë ka rezultuar se vetëm 60.87% e ndërtesave kanë leje të ndërtimit, që d.m.th. se 39% e ndërtimeve të inspektuara janë pa leje të ndërtimit. Shprehur me numra: prej 5412 ndërtesave të reja në vitin 2016, më shumë se gjysma (2989) nuk janë inspektuar, ndërtesa prej 2423 ndërtesave të inspektuara, vetëm 1666 ndërtesa kanë pas leje të ndërtimit. Kjo tregon se komunat nuk kanë ndërtuar dhe zbatuar mekanizmat e nevojshëm për ndërtimin e planifikuar të vendbanimeve në Kosovë. Këtu bën pjesë edhe Ministrie e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar shkallë të mesme të performancës, 46.63%. Vlerat e ulëta të performancës për rezultatin e parë (23.40%) dhe vlerat e larta për rezultatin e dytë (75.43), tregojnë se komunat nuk e kanë planifikuar territorin e komunave të tyre në përputhje me ligjin dhe planet përkatëse rregullative, ndërsa pjesën e vogël të territorit të rregulluar, kanë arritur ta menaxhojnë relativisht mirë apo 69.40%. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 23.40 – 75.43%, tregon për një shtrirje të gjerë të vlerave të matjes, e cila na jep të kuptojmë se territori i komunave nuk është planifikuar në shkallë të mjaftueshme dhe ka mundësuar që komunat më lehtë ta menaxhojnë një sipërfaqe më të vogël të territorit (27.68%) për zbatimin e planeve të ndërtimit (69.40%). Kjo fushë është përcjellë dhe po përcillet ende me probleme të theksuara, si nga ana e komunave, po ashtu edhe nga ana e qytetarëve. Komunat rekomandohen që t'i rrisin kapacitetet e tyre planifikuese në fushën e planifikimit hapësinor dhe po ashtu t'i ndërtojnë dhe zbatojnë mekanizmat e nevojshëm për rritjen e numrit të lejeve të ndërtimit për qytetarët.



5.7. Hapësirat publike

Hapësira publike nënkupton hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Matja e performancës në këtë fushë është e ndërlidhur me struktura përkatëse organizative të komunës, të cilat përmbushin obligimet ligjore në funksion të krijimit të një mjedisi të mjaftueshëm dhe cilësor për jetë normale të qytetarëve të komunës përkatëse. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e një rezultati: 1). *Hapësirë publike e mjaftueshme për një mjedis të shëndetshëm.*

Rezultati (7.1.) përmbledhë produktet e veprimeve të komunës përkatëse ose të komunave për një mjedis të shëndetshëm, si nga pikëpamja e menaxhimit të mjediseve natyrore ose të atyre të krijuara. Performanca e komunës përkatëse, për arritjen e këtij rezultati, është e lidhur ngushtë me krijimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, të shesheve dhe hapësirave tjera për lëvizje dhe veprimtari të ndryshme të qytetarëve. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	m ² kokë banori
7.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m ² për kokë banori	7.81
7.1.2	Sipërfaqja e shesheve publike në m ² për kokë banori	0.54
7.1.3	% e sipërfaqeve të hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	72.07

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në krijimin e hapësirave publike të mjaftueshme për një mjedis të shëndetshëm për qytetarët? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 7.1. është arritur në shkallën 4.18 m² për kokë banori. Në arritjen e këtij rezultati, kanë kontribuar dy tregues (7.1.1 dhe 7.1.2) që kanë matë me m² për kokë banori dhe një tregues (7.1.3), që ka mat me përqindje. Të dhënat tregojnë se qytetarët e Kosovës jetojnë në një mjedis me 7.81 m² për kokë banori hapësira të gjelbra. Kosova hynë në kuadrin e vendeve me hapësira të gjelbërta në shkallë të ulët. Statistikat botërore tregojnë për një ndryshim të madh prej vendit në vend, por vlerat sillen prej 1.90 (Buenos Aires) – 144.59 m² për kokë banori, në EdinBurgh³. Gjendja është shumë më e keqe me sheshet publike, vetëm 0.54 m² për kokë banori mesatarja e vendit. Shkalla e mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra dhe të shesheve, është arritur deri në shkallën 72.07%. Kjo është një arritje e kënaqshme, por shkalla e dokumentimit për këtë tregues është 45.7%, që na jep të kuptojmë se një pjesë e të dhënave mund të mos jenë plotësisht të sakta.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar dy shkallë të arritjes. Shkalla e parë e matur me m² për kokë banori, me arritje 4.18 m² për kokë banori dhe shkalla e dytë e matur me përqindje dhe me arritje 72.28%. Interpretimi i performancës për këtë fushë, është më i ndërlikuar për faktin se matet me dy lloj njësisht matëse dhe janë të pakrahasueshme ndërmjet veti. Megjithatë performanca e komunave mund të kuptohet në bazë të analizave dhe përshkrimeve në paragrafin më lartë. Duke pas parasysh problemet me të cilat janë hasur, komunat rekomandohen që t'i përcaktojnë qartë hapësirat e gjelbërta dhe sheshet publike në planet e tyre rregulluese komunale. Po ashtu vërehet nevoja e rritjes së kujdesit për këto hapësira më shumë dhe e dokumentimit të plotë me rastin e raportimit të të dhënave për këta tregues të kësaj fushe. MAPL duhet ta shikojë mundësinë e unifikimit të njësive matëse për matjen e performancës për këtë rezultat të kësaj fushe. Duke qenë me njësi matëse të ndryshme dhe me variabël të ndryshme, edhe të kuptuarit e arritjeve dhe paraqitja grafike e rezultatit është e vështirë.

5.8. Infrastruktura rrugore

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve komunale në fushën e infrastrukturës rrugore. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore përmirëson lidhjen e vendbanimeve dhe ndikon në rritjen e mundësive për aktivitet ekonomik, rrjedhimisht mundëson zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në nivel të komunës. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: 1). *Infrastruktura rrugore lokale e zgjeruar, e shtruar dhe e mirëmbajtur* dhe 2). *Infrastruktura rrugore lokale e sigurtë për qytetarët*.

Rezultati (8.1.) Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse ose të komunave në sigurimin e infrastrukturë rrugore komunale të sigurt për lëvizjen e qytetarëve. Infrastruktura rrugore e sigurt nënkupton ndërtimin e hapësirave dhe mjeteve tjera mbrojtëse dhe orientuese përgjatë rrugës, si:

³Grup autorësh, ASSESSING PEDESTRIAN ACCESSIBILITY TO GREEN SPACE USING GIS, Transylvanian Review of Administrative Sciences, 2007 – 2013.

trotuaret, ndriçimi, shenjëzimi dhe bresat fizik anësor përgjatë dhe rreth rrugëve që e ndihmojnë dhe e sigurojnë lëvizjen qytetarëve (këmbësorëve) pran rrugëve me qarkullim të mjeteve motorike. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga dy tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
8.1.1	% e rrugëve lokale të shtruara	61.88
8.1.2	% e rrugëve lokale të mirëmbajtura	61.56

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në shtrimin e rrugëve publike lokale dhe mirëmbajtjen e tyre? Zgjerimi, shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve (Rezultati 8.1) ka shënuar një arritje mesatare prej 61.72%. Në bazë të analizave kuptojmë se nga totali i rrugëve në komuna, janë shtruar vetëm 61.88% e tyre dhe pothuajse e njëjta gjatësi e rrugëve komunale të shtruara mirëmbahen rregullisht apo 61.56% e tyre. Vlerësimet e bëra na tregojnë se mirëmbajtja e rrugëve, më shumë është kuptuar më shumë si pastrim veror dhe dimror i tyre dhe më pak janë përfshirë riparimet e tyre (mirëmbajtja) sipas përkufizimeve në dokumentet zyrtare.


Rezultati (8.2.) paraqet arritjet e komunës përkatëse ose të komunave në sigurimin e infrastrukturë rrugore komunale, që nënkupton ndërtimin e hapësirave dhe mjeteve tjera mbrojtëse dhe orientuese përgjatë rrugës, si: trotuaret, ndriçimi, shenjëzimi dhe bresat fizik anësor përgjatë dhe rreth rrugëve që e ndihmojnë dhe e sigurojnë lëvizjen qytetarëve (këmbësorëve) pran rrugëve me qarkullim të mjeteve motorike. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre treguesve:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
8.2.1	% e gjatësisë së rrugëve lokale me trotuare	22.22
8.2.2	% e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik	28.70
8.2.3	% e gjatësisë së rrugëve lokale të shenjëzuara	40.47

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur që rrugët lokale të jenë të sigurta për qytetarët? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati është arritur në shkallën 30.46%. Në arritjen e këtij rezultati, me shkallë të ulët, kanë kontribuar tre tregues (8.2.1; 8.2.2 dhe 8.2.3). Nga vlerat e këtyre treguesëve mund të kuptojmë se siguria e qytetarëve në rrugë me ndërtimin e trotuareve nga ana e komunave është mjaftë e ulët (22.22%) dhe pak më e mirë është siguria e tyre me ndriçim publik (28.70%). Orientimi në rrugë i qytetarëve është i shkallës së mesme, me 40.47%. Nuk ka pas probleme përmbajtësore gjatë matjes, qëllimi i matjes së treguesve është kuptuar dhe është raportuar drejtë.

Interpretimi


Komunat në këtë fushë kanë treguar shkallë të mesme të performancës, 48.12%. Vlerat e larta të performancës për rezultatin e parë (61.72%) dhe vlerat e ulëta për rezultatin e dytë (30.46), tregojnë se komunat më shumë i kanë kushtuar kujdes shtrimit dhe zgjerimit të rrjetit të rrugëve se sa sigurisë së tyre për qytetarët. Kjo do të thotë se 61.72% e rrugëve lokale janë të shtruara dhe vetëm 30.46% janë të sigurta për qytetarët. Po ashtu mirëmbajtja e rrugëve me vetëm 61%, tregon se rrugët nuk mirëmbahen mjaftueshëm, në veçanti pas kalimit të sezonës së dimrit dhe pas ndër-



hyrjeve të kompanive publike dhe të qytetarëve për kyçje ose riparim të sistemit të ujësjellësit ose të kanalizimit. Analizat e tërthorta tregojnë se sistemi i mirëmbajtjes është në shkallë shumë të dobët për të gjitha shërbimet. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave në intervale të ngushta për të dy rezultatet tregon për shkallë të lartë të qëndrueshmërisë së matjes dhe ndërtimit të SMPK për këtë fushë. Komunitat rekomandohen që t'i rrisin kapacitetet e tyre për ndërtimin e trotuareve, ndriçimit publik dhe shënjimit vertikal dhe horizontal në rrugët publike lokale.

5.9. Transporti publik komunal

Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike përfshinë të gjitha hapësirat publike dhe private të destinuara apo të lejuara dhe të shenjëzuara në mënyrë vertikale dhe horizontale për parkim të mjeteve motorike të quajtura parkingje publike apo private dhe të gjitha vend-parkimet e lejuara dhe të shenjëzuara për parkim individual të mjetit motorik në pjesën e caktuar të rrugës apo të hapësirës publike. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e një rezultati: 1). *Ofrimi i transportit lokal publik për të gjitha vendbanimet e komunës.*



Rezultati (9.1.) paraqet arritjet e komunës përkatëse ose të komunave në ofrimin e transportit lokal publik dhe të sigurtë për të gjitha vendbanimet e territorit të komunës përkatëse. Ofrim i transportit lokal publik nënkupton mundësinë që të gjithë qytetarët e të gjitha vendbanimeve në territorin e komunës përkatëse të transportohen me transport lokal (komunal) në mënyrë të sigurt deri në destinacionin e caktuar brenda territorit të komunës. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga dy tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
9.1.1	% e realizimit të planit komunal për transport lokal publik	52.17
9.1.2	% e vendbanimeve të përfshira në transportin lokal publik	70.54
9.1.3	% e vendndalimeve të shënjëzuara për automjetet e transportit publik	46.83

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është siguruar transporti publik për të gjitha vendbanimet e komunës përkatëse? Sigurimi i transportit publik për vendbanimet e komunave është arritur deri në shkallën 56.51%. Kjo është një arritje mesatare e komunave, afër 3% nën mesatarën e vendit. Shtrirja e vlerave të treguesve na jep të kuptojmë se përfshirja e vendbanimeve në transportin publik në fakt është 70.54%, që tregon për prioritetin e komunave në këtë pikëpamje, por realizimi i planit komunal për transport publik është 52.17%, ndërsa shenjëzimi i vendndalimeve për automjete të transportit publik është vetëm në shkallën 46.83%. Dy treguesit e fundit e kanë zbritur performancën e përgjithshme të këtij rezultati.

Interpretimi

Komunitat në këtë fushë kanë treguar shkallë të mesme të performancës, 56.51%. Vlerat e larta të performancës për treguesin 9.1.2 (70.54%) dhe vlerat e ulëta për treguesin 9.1.3 (46.83%), tregojnë se komunitat më shumë i kanë kushtuar kujdes përfshirjes së vendbanimeve në transportin publik se sa

transportit të tyre në bazë të një plani dhe orari përkatës. Kjo do të thotë, sigurimi i një transporti publik lokal të çrregullt, ku qytetarët nuk mund ta planifikojnë kryerjen e punëve të përditshme të bazuar në transportin lokal publik. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave në interval relativisht të ngushtë, tregon për shkallë të lartë të qëndrueshmërisë së matjes dhe ndërtimit të SMPK për këtë fushë. Komunitet rekomandohen që t'i rrisin kapacitetet e tyre planifikuese dhe menaxhuese për sigurimin e transportit të rregullt të qytetarëve, në bazë të një plani dhe orari të caktuar. Ofrimi i një shërbimi pas kohe ose pa një orar të rregullt, nuk i shërben transportit të rregullt lokal publik.

5.10. Parkingjet publike

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve komunale në fushën e infrastrukturës rrugore dhe të transportit publik lokal. Kjo fushë është e ndërlidhur shumë me arritjet në fushën e infrastrukturës rrugore. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore përmirëson lidhjen e vendbanimeve me transport publik lokal dhe lehtëson qarkullimin e mjeteve motorike për transport të njerëzve dhe të mallrave, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e veprimeve ekonomike, arsimore, kulturore, sportive dhe shëndetësore. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e një rezultati: 1). *Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike.*


Rezultati (10.1.) paraqet arritjet e komunës përkatëse ose të komunave në ofrimin e hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike në mjediset urbane dhe lagjet e urbanizuara. Ofrim i hapësirave të mjaftueshme, qoftë në pronën publike apo private, në funksion të shërbimit të parkimit të mjeteve motorike të qytetarëve të komunës përkatëse dhe jo vetëm. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga katër tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
10.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	Mesi 10.26
10.1.2	% e vendparkimeve për mjete motorike në territorin e komunës	10.21
10.1.3	% e vendparkimeve të destinuara për taksit	38.36
10.1.4	% e parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar	39.16

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është siguruar hapësirë e mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike në territorin e komunave? Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike është arritur deri në shkallën 29.24%. Kjo është një arritje mjaft e ulët e performancës së komunave. Derisa arritjet për vendparkimet e destinuara për taksit (38.36%) dhe e vendparkimeve të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar (39.16%) kanë shënuar një performancë të shkallës së mesme, numri i vendparkimeve për mjetet motorike të regjistruara në komunitet përkatëse, është mjaft e ulët, vetëm 10.21%. Ky tregues ka ndikuar në uljen e performancës së komunave për këtë fushë. Në kuadër të kësaj fushe ekziston edhe një tregues, i cili matë numrin e parkingjeve për secilën komunë. Ky tregues matë me numër si njësi matëse dhe jo me përqindje. Kjo ka penguar llogaritjen e këtij treguesi në mesatarën e performancës së kësaj fushe. Mesatarja e performancës në shkallë vendi për këtë tregues është 10.26 parkingje për komunë.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar shkallë të ulët të performancës, 29.68%. Vlerat e larta të performancës për treguesin 10.1.4 (39.16%) dhe 10.1.3 (38.36%), si dhe vlerat e ulëta për treguesin 10.1.2 (10.21%), tregojnë se komunat i kanë kushtuar një kujdes mesatar rezervimit të vend parkimeve për persona me aftësi të kufizuar dhe rezervimeve për taksit, në ato hapësira të pa mjaftuara për parkim publik të mjeteve motorike (10.21%). Në përgjithësi performanca e komunave për këtë fushë nuk ka arritur shkallën e mjaftuar të rezultatit në ofrimin e shërbimeve për parkim të mjeteve motorike të qytetarëve. Natyra e këtij rezultati, nuk kërkon plotësimin e tij në shkallën 100%. Arritja e rezultatit për këto shërbime deri në shkallën 50%, është arritje e lartë apo e mjaftuar. Kjo për faktin se jo të gjitha veturat e qytetarëve në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë kanë nevojë për parkim të mjeteve të tyre motorike në parkingjet publike. Llogaritet se përafërsisht vetëm 50% të mjeteve motorike janë të parkuara në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë në të gjitha parkingjet publike të territorit të komunës përkatëse.



5.11. Furnizimi me ujë të pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm përfshinë sigurimin e burimeve të nevojshme të ujit, ndërtimin e sistemit të ujësjellësit, përfshirja e të gjitha vendbanimeve dhe ekonomive familjare dhe biznesore në sistem, kontrollimin e vazhdueshëm të sasisë dhe cilësisë së ujit, përcaktimin e tarifës për pagimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe shlyerjen e obligimeve nga qytetarët të cilët janë shfrytëzues të ujit të pijshëm i siguruar nga komuna apo kompania përkatëse e licencuar nga komuna dhe ministria përkatëse e linjës (MMPH). Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e tre rezultateve: 1). *Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm*; 2). *Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm*; 3). *Furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm sipas standardeve*.

Rezultati i parë (11.1) paraqet arritjet e komunës përkatëse ose të komunave në përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujësjellësit apo ujit të pijshëm. Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm do të thotë ndërtimi i ujësjellësit prej burimit të ujit të pijshëm e deri te secili vendbanim dhe secila ekonomi familjare apo biznesore. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
11.1.1	% e realizimit të planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	61.76
11.1.2.	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	62.71
11.1.3	% e ekonomive të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	70.58


Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 11.1. apo përfshirja e qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm është arritur në shkallën 65.02%, ku arritja më e lartë është shënuar në përfshirjen e ekonomive në sistemin e ujit të pijshëm me 70.58%, pastaj përfshirja e vendbanimeve në sistem me 62.71% dhe

61.76% është realizuar plani për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit. Komunitat kanë arritur rezultate deri në kufirin e shkallës së mesme dhe të lartë të përfshirjes së qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm.

Rezultati i dytë (11.2) paraqet arritjet e komunës përkatëse në furnizimin e rregullt të gjithë qytetarëve me ujë të pijshëm. Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm do të thotë siguri i sasisë dhe i cilësisë së mjaftueshme të ujit të pijshëm, pa ndërprerje. Ndërtimi i kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm është i lidhur ngushtë me kapacitetet menaxhuese të kompanive publike përkatëse dhe të komunës në njërin anë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në shlyerjen e obligimeve në anën tjetër. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
11.2.1	% e ditëve në vit me furnizim të pa ndërprerë me ujë të pijshëm	83.70
11.2.2	% e faturimit të ujit të shpenzuar	48.27
11.2.3	% e pagesave të ujit të faturuar	68.66

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë të pijshëm? Analiza e të dhënave tregojnë se qytetarët janë furnizuar rregullisht me ujë të pijshëm deri në shkallën 66.74%. Arritja më e lartë është shënuar në furnizimin e pandërprerë me ujë të pijshëm (83.70%) dhe në pagesat e ujit të faturuar (68.66%). Arritje e mesme është shënuar në pagesën e ujit të faturuar (48.27%). Kosova për një vjet ka shpenzuar 111,223,495.2 milion m³ ujë apo 63.92 m³ për kokë banori, duke mos e llogaritur 30% e popullatës që nuk është e kyçur ende në sistemin e ujësjellësit. Sipas projeksioneve botrore, një vend që ka më pak se 1000 m³ ujë për kokë banori në vjet, nuk mund të ketë zhvillim ekonomik normal⁴. Për këtë sasi të ujit të shpenzuar, është faturuar vetëm 48.27% apo 55,425,953.73 Euro dhe janë paguar 68.66% apo 32,267,811.28 Euro. Kjo është shkallë e ulët e performancës së kompanive përkatëse dhe e institucioneve lokale dhe qendrore që merren mbikëqyrjen e kësaj fushe. Edhe pse vlerat e treguesit për furnizim të pandërprerë (të qëndrueshëm) me ujë të pijshëm janë të larta (83.70%), analizat tregojnë se treguesi nuk ka arritur të mat plotësisht atë që është synuar, në mungesë të dokumentimit të plotë të të dhënave.



Rezultati i tretë (11.3) pasqyron furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm cilësor apo sipas standardeve të përcaktuara nga ISHP dhe është rezultati kryesor i kësaj fushe. Rezultati pasqyron arritjet e komunës përkatëse në sigurinë e furnizimit të ujit të pijshëm me cilësinë e kërkuar dhe jo me sasinë e ujit të pijshëm. Përbushja e rezultateve 11.1 dhe 11.2 ndihmojnë në masë të konsiderueshme në arritjen e këtij rezultati. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga një tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
11.3.1	% e ditëve në vit me furnizim të pa ndërprerë me ujë të pijshëm	86.70

⁴ Eorl Business Council for Sustainable Development, Facts and trends, pg.8.

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm sipas standardeve (cilësor)? Analiza e të dhënave tregon se qytetarët janë furnizuar në shkallën 86.70% me ujë cilësor apo të shëndetshëm. Arritja e rezultatit është prodhim i drejtpërdrejtë i arritjes së treguesit të vetëm, që është e njëjta vlerë 86.70%. Kjo tregon se qytetarët furnizohen me ujë të pijshëm relativisht cilësor, me përjashtime të caktuara të qyteteve të mëdha, si Prishtina.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë prej 72.76%. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 48.27 – 86.70%, tregon për matje të qëndrueshme dhe për ndërtim të qëndrueshëm të SMPK për këtë fushë. Vlerat e larta të arritjeve për këtë fushë tregojnë gjithherë performancë të lartë të komunave. Secili tregues ka arritur të matë qëllimin e asaj që është synuar. Në bazë të analizave të bëra, është konstatuar se mbledhja dhe llogaritja e të dhënave për disa tregues të kësaj fushe është treguar pak e ndërlikuar për kapacitetet e njohurive të zyrtarëve komunal të performancës. MAPL duhet të organizojë trajnime në kohë të mjaftueshme për aftësimin e zyrtarëve për matjen e treguesve të kësaj fushe. Po ashtu treguesi tjetër që na tregon për shkallë të ulët të performancës së kompanive publike në faturimin e ujit të shpenzuar është treguesi 11.2.2. Në bazë të vlerës së këtij treguesi (48.27%), kuptojmë se kompanitë publike dhe strukturat përkatëse menaxhuese të furnizimit me ujë të pijshëm, nuk kanë arritur ta faturonin as gjysmën e ujit të shpenzuar. Rekomandohen komunat që janë aksionarë të kompanive përkatëse publike, që ta rrisin performancën e tyre në përmirësimin e këtij treguesi. Realizimi i dobët i këtij treguesi, ndikon në performancën e dobët edhe të treguesve tjerë. Në bazë të të dhënave del se uji i faturuar është paguar deri në shkallën 68.66% dhe kjo do të thotë se në përgjithësi ujë i shpenzuar është paguar jo më shumë se 35%. Me këtë performancë të ulët, nuk mund të përmirësohet shumë furnizimi me ujë të pijshëm, që ne synojmë ta arrijmë.

5.12. Kanalizimi

Kanalizimi përfshinë tërë rrjetin e kanaleve për mbledhjen e ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferik, të cilat shtrihen nga secila ekonomi familjare, institucionale dhe biznesore, përgjatë sistemit të ujësjellësit dhe kryesisht përgjatë rrugëve të vendbanimeve përkatëse në një thellësi që nuk e pengojnë komunikacionin e deri te vendi i derdhjes. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e dy rezultateve: 1). *Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit dhe 2). Trajtimi i ujërave të zeza.*

Rezultati i parë (12.1) paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit. Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit do të thotë ndërtimi i kanaleve për mbledhjen e ujërave të zeza të secilës ekonomi përkatëse e deri te pika e derdhjes në lumë, gropë septike apo në impiant për trajtim të ujrave të zeza. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
12.1.1	% e realizimit të planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	69.12
12.1.2.	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e kanalizimit	66.62
12.1.3	% e ekonomive të përfshira në sistemin e kanalizimit	70.19

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 12.1. apo përfshirja e qytetarëve në sistemin e kanalizimit është arritur në shkallën 68.64%, ku arritja më e lartë është shënuar në përfshirjen e ekonomive në sistemin e kanalizimit me 70.19% apo 0.19% më pak se përfshirja në ujin e pijshëm, pastaj realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit me 69.12% apo 7.36% më shumë se në sistemin e ujit të pijshëm dhe 66.62% përfshirja e vendbanimeve në sistemin e kanalizimit.


Rezultati i dytë (12.2) paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e vendbanimeve në rrjetin e sistemit të kanalizimit për trajtimin e ujërave të zeza apo në procesin e përpunimit dhe pastrimit në fabrikat përkatëse apo impiante. Trajtimi i ujërave të zeza do të thotë kalimi i ujërave të zeza nëpër një numër të filtrave fizikë, biologjikë dhe kimikë në fabrikën për pastrimin e ujërave të zeza apo impiante dhe prodhimi i ujit të pastër biologjikisht dhe kimikisht para se të derdhet në lumenj apo të shfrytëzohet për qëllime të tjera në ekonominë familjare, institucionale apo biznesore. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga dy tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
12.2.1	% e realizimit të projekteve të planifikuara për trajtimin e ujërave të zeza	10.29
12.2.2	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza	35.34

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur ndërtimi i kapaciteteve për sistemin e pastrimit të ujërave të zeza dhe përfshirja e vendbanimeve në këtë sistem? Analiza e të dhënave tregojnë se komunat kanë arritur t'i ndërtojnë kapacitetet dhe t'i përfshijnë 22.82% të vendbanimeve në këtë sistem. Arritja më e lartë është shënuar në përfshirjen e vendbanimeve në sistem (35.34%) se sa në realizimin e projekteve për ndërtimin e kapaciteteve për trajtimin e ujërave të zeza (10.29%). Për matjen e treguesit 12.2.2, analizat tregojnë se 10 komuna nuk e kanë kuptuar qëllimin e matjes së treguesit dhe kanë raportuar të dhëna të njëjta sikur për treguesin 12.1.2 (% e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e kanalizimit). Kjo ka ndikuar që përqindja e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin për trajtimin e ujërave të zeza të jetë më e lartë se sa që është realisht.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë të shkallës së mesme prej 45.47%, në fakt më e lartë se sa që është pritur. Rezultati i dytë 12.2 nëpërmjet treguesit të dytë (12.2.2) nuk ka arritur ta mat qëllimin i cili është synuar. Analizat tregojnë se 10 komuna nuk e kanë kuptuar qëllimin e matjes së treguesit dhe kanë raportuar të dhëna të njëjta sikur për treguesin 12.1.2 (% e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e kanalizimit). Po ashtu është konstatuar mungesa e përvojës për raportim në këtë tregues dhe nevoja për trajnime shtesë. Kjo ka ndikuar që përqindja e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin për trajtimin e ujërave të zeza të jetë më e lartë se sa që realisht mund të jetë. Ndërsa rezultati i parë, nëpërmjet treguesëve të tij, ka arritur të matë në mënyrë të qëndrueshme performancën e komunave. Shkalla e përfshirjes së vendbanimeve dhe e ekonomive në sistemin e kanalizimit është më e vogël se sa përfshirja e tyre në sistemin e ujit të pijshëm. Derisa përfshirja e ekonomive në sistemin e kanalizimit është më e vogël për 0.19%, përfshirja e vendbanimeve është më e lartë për 7.36%. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se disa komuna për



vendbanimet e tyre kanë shfrytëzuar sistemin e gropave skeptike, të cilat e kanë rritë përqindjen përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e kanalizimit, krahasuar me atë të ujësjellësit.

5.13. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave përfshinë grumbullimin e të gjitha llojeve të mbeturinave (letër, plastikë, qelq, hekur, dru, hi, tekstil, ushqim etj), të prodhuara nga ekonomitë familjare, institucionale, komerciale (biznesore), si dhe deponimi i tyre në vendet e përshtatshme dhe sipas udhëzimeve profesionale për këtë qëllim jashtë vendbanimeve. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e tre rezultateve: 1). *Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave*; 2). *Ofrim i qëndrueshëm i shërbimeve në mbledhjen e mbeturinave*; 3). *Deponimi i mbeturinave*.

Rezultati i parë (13.1) paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e të gjithë qytetarëve apo të të gjitha ekonomive që prodhojnë mbeturina në sistemin e grumbullimit të tyre. Synimi përfundimtarë është mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave nga i tërë territori i komunës përkatëse, por aktualisht ofrohet shërbimi vetëm në pikat përkatëse të grumbullimit pranë ekonomive përkatëse dhe jo mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave jashtë këtyre pikave. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:


Ref.	Treguesi	Vlera / %
13.1.1	% e realizimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	66.28
13.1.2.	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	72.58
13.1.3	% e ekonomive që kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave	61.36

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur përfshirja e të gjithë qytetarëve dhe ekonomive në sistemin e mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave? Analiza e të dhënave tregojnë se rezultati 13.1. apo përfshirja e qytetarëve në sistemin e mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave është arritur në shkallën 66.74%, ku arritja më e lartë është shënuar në përfshirjen e vendbanimeve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, me 72.58%, pastaj realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (66.28%) dhe arritjen më të ulët e ka shënuar përfshirja e ekonomive në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, me 61.36%. Komunitat kanë treguar performancë deri në kufirin e shkallës së mesme dhe të lartë të përfshirjes së qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

Rezultati i dytë (13.2) paraqet arritjet e komunës përkatëse në ofrimin e rregullt të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë qytetarët. Ofrim i qëndrueshëm me shërbim të mbledhjes së mbeturinave do të thotë mbledhja e mbeturinave sipas orarit të caktuar ditor apo javor nga pikat e grumbullimit të ekonomive prodhuese përkatëse në tërë territorin e komunës përkatëse. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:

Ref.	Treguesi	Vlera / %
13.2.1	% e realizimit të orarit për mbledhjen e mbeturinave	93.35
13.2.2.	% e inkasimit të mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	70.88

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur në ofrimin e qëndrueshëm të mbledhjes së mbeturinave për qytetarët? Analiza e të dhënave tregon se ky shërbim është ofruar deri në shkallën 82.12%, që hynë në shkallën e lartë të performancës në ofrimin e shërbimeve. Arritja më e lartë është shënuar në realizimin e orarit për mbledhjen e mbeturinave (93.35%), pastaj arritje e lartë është shënuar edhe në shkallën e inkasimit të mjeteve financiare për mbledhjen e mbeturinave (70.88%) apo afër 3% më shumë se pagesat e ujit. Edhe pse vlerat e treguesve për mbledhjen e mbeturinave tregojnë shkallë të lartë të performancës, prap mjedisi nuk është i pastrur në përputhje me shkallën e performancës. SMPK fatkeqësisht nuk matë shkallën e prodhimit të mbeturinave nga burimi, por vetëm pjesën e mbledhjes së mbeturinave të grumbulluara dhe një pjesë e mbeturinave të prodhuara mbesin pa u mbledhur dhe pa u deponuar. Kjo e bën këtë rezultat me shkallë të kufizuar të matjes së plotë të këtij shërbimi.



Rezultati i tretë (13.3) paraqet arritjet e komunës përkatëse në administrimin e hallkës përfundimtare të ciklit për menaxhimin e mbeturinave. Deponimi i mbeturinave do të thotë vendosja e mbeturinave të mbledhura në vende të veçanta larg vendbanimeve të komunës përkatëse të ndërtuara sipas kriterëve përkatëse gjeografike, teknike dhe biologjike, për ta mbrojtur mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut nga ndotja me mbeturina. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga një tregues:

Ref.	Treguesi	Kg/kokë banori
13.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	169.09

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është deponuar mbeturina për një vit nga ana e komunave? Analiza e të dhënave tregojnë se kompanitë përkatëse për menaxhimin e mbeturinave kanë deponuar gjithsej 324,228,901 milion kg mbeturina apo 169.09 kg. për kokë banori. Matja e sasisë së deponimit të mbeturinave nuk është shumë e vështirë, por problemi është, matja e sasisë së prodhimit të mbeturinave. Sasia më e vogël e deponimit të mbeturinave është shënuar në komunën e Vitisë me vetëm 9.19 kg. për kokë banori dhe sasia më e madhe e deponimit të mbeturinave është shënuar në komunën e Fushë Kosovës me 351.48 kg. për kokë banori. Ky tregues mat i vetëm në kuadër të kësaj fushe e po ashtu edhe rezultati, sepse njësitë matëse janë të ndryshme dhe nuk mund të nxirret mesatarja e fushës për këtë rezultat.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë të lartë prej 74.54%. Vlera 74.54% pasqyron vetëm performancën e komunave për dy rezultate: 13.1 dhe 13.2, ndërsa rezultati 13.3 nuk matet me përqindje por me kg/kokë banori dhe është 169.09 kg. për kokë banori. Rezultatet nëpërmjet vlerave të treguesve kanë arritur qëllimin e matjes së kësaj fushe. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 61.36 – 93.35%, tregon për matje të qëndrueshme dhe për ndërtim të qëndrueshëm të SMPK për këtë fushë. Vlerat e larta të arritjeve tregojnë gjithëherë performancë të lartë të komunave. Secili tregues ka arritur të mat qëllimin e asaj që është synuar. Që rezultatet të matin në mënyrë sa më të plotë menaxhimin e mbeturinave, duhet të zgjerohet shtrirja e fushës së matjes apo shtimi i një treguesi i cili do

të na tregojë për sasinë e prodhimit të mbeturinave. Kjo si është kështu, nuk mat plotësisht fushën dhe informatat nuk na informojnë plotësisht për problematikën dhe performancën e komunave. Pa e ditur sasinë e mbeturinave të prodhuara, informatat për sasinë e deponimit të mbeturinave nuk pasqyrojnë tablonë e plotë dhe nuk kuptojmë shumë se sa është kryer puna. Numri i madh i deponive të egra dhe shpërndarja gjithandej e mbeturinave, tregon se nuk deponohet e gjithë sasia e prodhuar e mbeturinave. Potencialisht, sa më e madhe që është sasia e deponimit të mbeturinave, aq më e madhe është gjasa për pastrimin e tyre nga vendbanimet, por realisht kjo nuk është e vërtetë. Sipas të dhënave ndërkombëtare, sot në botë mesatarisht prodhohen 1.2 kg për kokë banori në ditë⁵ apo 438 kg për kokë banori në vit. Kjo na tregon se potencialisht 271.42 kg për kokë banori mbeturina apo më shumë se gjysma e tyre mbesin pa u deponuar në vendin tonë. MAPL duhet të shikojë mundësinë e matjes së sasisë së mbeturinave të prodhuara nga ekonomitë e ndryshme në vend.

5.14. Mbrojtja e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Mbrojtja e mjedisit përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të planifikuara me Planin e veprimit lokal në mjedis dhe programet mjedisore, të cilat duhet të jenë në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim Mjedisor, që ka të bëjë me mbrojtjen e të gjitha llojeve mjedisore nga të gjitha veprimet dhe materiet të cilat e rrezikojnë mjedisin në komunën përkatëse. Performanca e komunave për këtë fushë matet me anën e një rezultati: 1). *Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm.*

Rezultati i parë (14.1) paraqet arritjet e komunës përkatëse në krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët. Ky është synimi përfundimtarë i veprimit të organeve të pushtetit lokal, atij qendror dhe i publikut të gjerë. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm do të thotë, marrja e masave të nevojshme nëpërmjet Planit të veprimit komunal në mjedis për mbrojtjen e mjedisit nga çfarëdo dëmtimi, shkatërrimi apo ndotje, marrja e masave të nevojshme për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit që nuk është i dëmtuar dhe marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e mjedisit në gjendje të natyrshme, i pastër dhe i shëndetshëm për qytetarët. Për shkallën e arritjes së këtij rezultati, informohemi nga tre tregues:


Ref.	Treguesi	Vlera / %
14.1.1	% e realizimit të planit të veprimit lokal në mjedis	66.48
14.1.2	% e lejeve të lëshuara mjedisore komunale	30.00
14.1.3	% e ndërtesave të reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	51.27
14.1.4	% e sipërfaqeve të rregulluara mjedisore	50.53

Rezultati synon t'i përgjigjet pyetjes: sa është arritur që komunat të krijojnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm? Analiza e të dhënave tregon se ky rezultat (14.1) është arritur në shkallën 49.57% (nieveli i mesëm i performancës), ku arritja më e lartë është shënuar në realizimin e planit të veprimit lokal në mjedis, me 66.48%, pastaj zbatimi i lejeve mjedisore lokale (51.27%), për të vazhduar me sipërfaqet e rregulluara mjedisore (50.53%) dhe arritjen më të ulët e ka shënuar lëshimi i lejeve mjedisore komunale, me vetëm 30.00%.

⁵ World Economic forum, Environment 2017, which countries produce the most waste? pg. 1.

Interpretimi

Komunat në këtë fushë kanë treguar një performancë të lartë prej 49.57%. Vlera 49.57% në të njëjtën kohë pasqyron edhe arritjet e të vetmit rezultat të kësaj fushe. Po ashtu rezultati pasqyron vlerat e performancës së komunave për katër treguesit e këtij rezultati. Shtrirja e vlerave të arritjeve të performancës së komunave prej 30.00 – 66.48%, tregon për matje të qëndrueshme dhe për ndërtim të qëndrueshëm të SMPK për këtë fushë. Vlerat e larta të arritjeve tregojnë gjithherë performancë të lartë të komunave. Secili tregues ka arritur të mat qëllimin e asaj që është synuar. Përderisa tre tregues (14.1.1; 14.1.3; 14.1.4), që kanë të bëjnë me realizimin e planeve për veprim në mjedis, lëshimin e lejeve mjedisore dhe zbatimimi i tyre, na informojnë për arritje të nivelit të mesëm të performancës, treguesi 14.1.2, që ka të bëjë me rregullimin e sipërfaqeve mjedisore, na informon se komunat e kanë përmbushur ofrimin e këtij shërbimi vetëm në shkallën 30%.



Performanca e përgjithshme sipas komunave


Treguesit përfaqësojnë bazën kryesore llogaritëse dhe informuese për shkallën e arrijës së rezultateve. Treguesit ofrojnë informata të mjaftueshme për t'iu mundësuar komunave dhe palëve të tjera të interesit që të masin ose të vlerësojnë performancën e tyre në ofrimin e shërbimeve në fushat përkatëse. SMPK ka gjithsej 65 tregues, prej të cilëve janë matë 64 dhe janë pjesë e këtij raporti. Treguesi 1.13. nuk është matë për shkak të mungesës së programit përkatës elektronik. Vlerat e secilit tregues i kemi elaboruar në kuadër të secilit rezultat dhe fushë, në kapitullin 5. Derisa në nënkapitullin më lartë i kemi përshkruar detajisht arritjet e përgjithshme të rezultateve sipas fushave përkatëse nëpërmjet treguesëve, ndërsa në këtë nënkapitull do t'i trajtojmë arritjet e përgjithshme të performancës sipas komunave. [Shih graf. 18.](#)

5.15. Arritjet e përgjithshme të performancës sipas komunave

Komunat, për vitin 2016, kanë arritur performancë të përgjithshme prej 58.67%. Arritja e e përgjithshme e performancës sipas komunave dhe renditja e komunave sipas arritjeve, fillon me komunën e Mamushës (arritja më e ulët 31.10%) dhe përfundon me komunën e Junikut (arritje më e lartë 73.57%). Është interesant se edhe Mamusha, edhe Juniku janë komuna të reja, të formuara pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Rezultati na tregon se themelimi i komunave të reja nuk mund të gjykohej për mos sukses, por nëse komunat e reja nuk janë mirë me performancën, atëherë duhet shikuar menaxhimi dhe udhëheqja e tyre. Prej 35 komunave që janë hulumtuar, shumica prej tyre (28), kanë treguar performancë të nivelit të mesëm dhe shtrihen në të dy anët e mesatares së Kosovës (58.67%). Vlerat e arritjeve kanë marrë një trajtë përafërsisht cilindrike, që tregon për shkallë të lartë të qëndrueshmërisë në matje dhe në arritje të komunave. Kjo tregon për një performancë të njëtrajtshme, pa dallime të mëdha prej njëres në komunën tjetër. Po ashtu analizat tregojnë se numri më i madh i komunave (18) kanë arritur performancë mbi mesataren e vendit. Një arritje uniforme (e njëtrajtshme) e performancës vërehet edhe sipas kategorive përkatëse të sistemit të performancës: treguesve; rezultateve dhe fushave përkatëse.

Komunat sipas arritjeve në bazë të treguesve, i kemi klasifikuar në tre grupe kryesore: komunat me arritje të ulët (1 – 33%); komunat me arritje të mesme (34 – 66%) dhe komunat me arritje të lartë (67 – 100%). Në bazë të këtij klasifikimi, numri më i madh i komunave (27) i takojnë grupit të komunave me arritje të mesme (50.17 – 63.54%), 7 komuna hyjnë në grupin e komunave me arritje të lartë (64.58 – 73.57%) dhe vetëm 1 komunë hynë në grupin e komunave me arritje të ulët, Mamusha me vetëm 33.22%.

Në bazë të klasifikimit të përgjithshëm, është 1 komunë e re (e vogël) me performancë më të lartë - Juniku me 73.57%. Janë edhe 5 komuna: 3 të mëdha (Prizreni, Glogoci dhe Prishtina) dhe 2 komuna të mesme (Shtime dhe Istog) që kanë arritje të lartë të performancës. Prishtinë është e gjashta apo e fundit në këtë grup të komunave. [Shih graf. 18.](#) Edhe ky dimension tregon për një përfaqësim apo shpërndarje të rezultateve në nivelin e lartë nga tre grupet e komunave.



Në grupin e komunave me arritje të mesme hyjnë 28 komuna, me një arritje përafërsisht të njëjtë. Këtij grupi i prinë Shtërpca me 64.58% dhe e fundit në këtë grup është Klokoti me 50.17%. Shtrirja e vlerave të performancës për 28 komuna në një interval të ngushtë vetëm prej 50.17 – 64.58% apo në një hapësirë prej 14%, tregon për një qëndrueshmëri të lartë të performancës së komunave, të procesit të matjes dhe të ndërtimit të SMPK. Forma e grafikut është pothuajse cilindrike, që e vërteton këtë më së miri. E vetmja komunë që dallohet në këtë vit është Mamusha. Performanca e saj është më e ulët nga komuna e parafundit (Klokoti) për 17%, shkalla më e madhe e rënies së performancës prej komunës në komunë.

Për shkallën e dokumentimit të të dhënave, komunat kanë treguar një shkallëzim më të theksuar se sa ai i performancës, por pa rezultate ekstreme. Analizat tregojnë se shtrirja e rezultateve për dokumentimin e të dhënave është shumë e gjerë, prej 0 – 98.44%. Vlen të theksohet se shumica e komunave (14) i takon grupit të komunave me shkallë të lartë të dokumentimit (68.75 – 98.44%), pastaj vjen grupi i komunave (11 komuna) me shkallë të ulët të dokumentimit (0 – 27.50%) dhe numri më i vogël i komunave (10) i takon grupit me shkallë të mesme të dokumentimit të të dhënave (34.38 – 64.06%). Radhitja e komunave me shkallë të lartë të dokumentimit nuk është e njëjtë me radhitjen e komunave sipas performancës. Prej 6 komunave me performancë të lartë, vetëm 3 komuna: Juniku (96.88%), Prishtina (89.06%) dhe Istogu me 68.75%, kanë edhe shkallë të lartë të dokumentimit të të dhënave, ose shprehur në përqindje 50% e komunave me performancë të lartë kanë edhe shkallë të lartë të dokumentimit të të dhënave. Shkallën më të lartë të dokumentimit të të dhënave e kanë shënuar këto komuna: Podujeva (98.44%), Novobërda (98.44%), Juniku (96.88%), Shtime (95.31%) dhe Parteshi (92.19%). Për shkallën e dokumentimit, shih [shfaqja. 3](#). Në përgjithësi mund të themi se performanca e lartë e komunave nuk përcillet në masën më të madhe edhe me shkallë të lartë të dokumentimit. Edhe pse shumica e komunave (14) kanë treguar shkallë të lartë të dokumentimit, kjo nuk është e kënaqshme dhe duhet të përmirësohet në vitet e ardhshme.

5.16. Angazhimi i burimeve njerëzore dhe performanca

Për arritjen e performancës përkatëse, komunat kanë angazhuar burime njerëzore përkatëse. Në bazë të analizave ka rezultuar se komunat kanë përdorë kritere të ndryshme në angazhimin e burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Llogaritja e angazhimit të burimeve njerëzore është bërë në raport me numrin e banorëve apo sa zyrtarë janë angazhuar në raport me numrin e banorëve për komunën përkatëse? Njësia e llogaritjes është numri i banorëve që shërbehen nga një (1) zyrtar. [Shih tab.1](#).

Për vitin 2016 komunat (35) kanë angazhuar gjithsej 41,217 zyrtarë që paguhën nga buxheti i komunës. Në bazë të të dhënave është konstatuar se numrin më të madh të zyrtarëve të angazhuar e ka Prishtina (5247), pasuar nga Prizreni (3074) apo 220 më pak dhe Gjlani (2670). Prishtina ka angazhuar 1 zyrtar për 37.91 qytetarë, ndërsa Prizreni me numër të përafërt të banorëve ka angazhuar 1 zyrtar për 57.83 qytetarë dhe Gjlani ka angazhuar 1 zyrtar për 33.77 qytetarë.

Në përgjithësi (mesatarisht) komunat e kanë angazhuar 1 zyrtar për 39.14 banorë (qytetarë). Krahasuar me mesataren e vendit, Prishtina me 1 zyrtar u shërben 1.23 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit, ndërsa Prizreni me 1 zyrtar u shërben 18.90 qytetarëve më shumë se mesatarja e vendit dhe Gjlani me 1 zyrtar u shërben 5.16 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit. [Shih tab.1](#). Komunat të cilat me 1 zyrtar u kanë shërbyer më pak qytetarëve janë: Parteshi 26.46 qytetarë më pak se mesatarja e vendit, Ranillugu 23.85 më pak dhe Graçanica e Klokoti 18.70 qytetarëve më pak. [Shih tab. 1](#). Në përgjithësi komunat kanë angazhuar burime njerëzore më shumë se mesatarja e vendit, apo përkthyer në termat e statistikave nga

tabela 1, komunat me 1 zyrtar u shërbejnë mesatarisht 4.43 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit. Mesataren e rrisin komunat me shumicë serbe, që u shërbejnë shumë më pak qytetarëve me 1 zyrtar nga mesatarja e vendit, përndryshe më shumë se gjysma e komunave (23 prej 35) kanë angazhuar më pak zyrtarë se mesatarja e vendit. Komunat që me 1 zyrtar u kanë shërbyer më shumë qytetarëve nga mesatarja e vendit janë: Mitrovica me 21.39 qytetarë më shumë për 1 zyrtarë dhe Prizreni me 18.90 qytetarë më shumë.

Është interesant se performanca e komunave nuk është më e lartë te komunat që kanë angazhuar burime njerëzore më shumë për kokë banori. Edhe pse 1 zyrtarë në komunën e Prishtinës u shërben 19.90 qytetarëve më pak se 1 zyrtar i komunës së Prizrenit, performanca e komunës së Prishtinës është vetëm 7.59% më e lartë se mesatarja e vendit, ndërsa performanca e komunës së Prizrenit është 9.37% më e madhe se mesatarja e vendit apo 1.78% më e lartë se komuna e Prishtinës. Po ashtu Kamenica dhe Klina me numër përafërsisht të njëjtë të banorëve kanë angazhuar numër përafërsisht të njëjtë të zyrtarëve, dhe performanca është po ashtu e njëjtë. Shih tab. 1.

Tab. 1. Efikasiteti i angazhimit të burimeve njerëzore për performancën e komunave

Raporti i Performancës së Komunave 2016


Nr	Komuna	Km/2	Nr. Banorëve	Nr. i punëtorëve	Femra	%	Raporti 1 zyrtarë për banorë	Dallimi me mesataren e vendit	Performanca	Dallimi me mesataren e vendit
1	Deçan	297	40019	792	30	3.79	50.53	11.39	53.81	-5.37
2	Dragash	430	33997	704	75	10.65	48.29	9.16	61.93	3.40
3	Ferizaj	345	108610	2409	88.00	3.65	45.09	5.95	63.54	5.01
4	Fushe Kosovë	83	34827	696	394	56.61	50.04	10.90	61.46	2.93
5	Gjakovë	587	94556	2139	1205	56.33	44.21	5.07	61.54	3.01
6	Gjilan	392	90178	2670	1270	47.57	33.77	-5.36	61.55	3.02
7	Glllogoc	276	58531	1256	518	41.24	46.60	7.47	66.65	8.12
8	Graçanicë	131	10675	526	250	47.53	20.29	-18.84	60.84	2.31
9	Hani Elezit	83	9403	215	74	34.42	43.73	4.60	54.48	-4.05
10	Istog	454	39289	916	60	6.55	42.89	3.76	66.99	8.46
11	Junik	74	6084	156	55	35.26	39.00	-0.14	73.57	15.04
12	Kaçanik	211	33409	1093	372	34.03	30.57	-8.57	50.83	-7.70
13	Kamenicë	424	36085	861	277	32.17	41.91	2.78	51.29	-7.24
14	Klinë	309	38496	934	329	35.22	41.22	2.08	51.62	-6.91
15	Klllokot	23	2556	127	43	33.86	20.13	-19.01	50.17	-8.36
16	Leposaviq	593	13515	ska të dhë.	ka të dhë.	ska të dhë.	ska të dhë.	ska të dhë.	57.20	-1.33
17	Lipjan	338	57605	1491	759	50.91	38.64	-0.50	57.82	-0.71
18	Malishevë	306	54613	1421	411	28.92	38.43	-0.70	54.89	-3.64
19	Mamushë	32	5587	136	ka të dhë.	0.00	41.08	1.95	33.22	-25.31
20	Mitrovicë	331	71909	1188	145	12.21	60.53	21.39	56.50	-2.03
21	Novobërdë	204	6729	375	136	36.27	17.94	-21.19	52.28	-6.25
22	Obiliq	105	21549	665	344	51.73	32.40	-6.73	60.28	1.75
23	Partesh	29	1787	141	48	34.04	12.67	-26.46	53.74	-4.79
24	Peje	603	96450	2134	1230	57.64	45.20	6.06	62.57	4.04
25	Podujevë	633	88499	2029	858	42.29	43.62	4.48	61.72	3.19
26	Prishtinë	514	198897	5247	3080	58.70	37.91	-1.23	66.12	7.59
27	Prizren	603	177781	3074	1362	44.31	57.83	18.70	67.90	9.37
28	Rahovec	278	56208	1180	390	33.05	47.63	8.50	53.47	-5.06
29	Ranillug	69	3866	253	129	50.99	15.28	-23.85	62.04	3.51
30	Shtime	134	27324	632	258	40.82	43.23	4.10	70.14	11.46
31	Shtërpçë	248	13600	377	116	30.77	36.07	-3.06	64.58	6.05
32	Skenderaj	374	50858	1273	410	32.21	39.95	0.82	54.82	-3.71
33	Suharekë	361	59722	1359	567	41.72	43.95	4.81	57.11	-1.42
34	Viti	270	46987	1151	463	40.23	40.82	1.69	57.80	-0.73
35	Vushtrri	345	69870	1597	677	42.39	39.14	0.00	59.18	0.51
Gjithsej /Mesatarja		10489	1760071	41217	16423	35.53	39.14	-4.43	58.68	0.12

Ndërkaq, edhe pse 1 zyrtar i komunës së Klllokotit u shërben për afërsisht 20 qytetarëve më pak se 1 zyrtar i komunës së Klinës dhe të Kamenicës, performanca e saj është 8.36% më e vogël se mesatarja e vendit apo është e njëjtë me performancën e Klinës. Në përgjithësi nuk vërehet ndonjë ndikim në rritjen e performancës së komunave, kur komunat kanë angazhim më të madh të zyrtarëve, përkundrazi në disa raste numri më i vogël i zyrtarëve të angazhuar, është reflektuar me performancë më të lartë, si në komunën e Prizrenit.

5.17. Krahasset me vitin 2015

Edhe pse matja e performancës së komunave për vitin 2016 është bërë sipas një metodologjie standarde, kur bëhet krahasimi i performancës së komunave me vitin 2015, përpos dallimeve të theksuara, vërehet edhe një ngjashmëri e shtrirjes së vlerave të treguesve përkatës. Derisa në raportin e performancës për vitin 2015 kemi një shtrirje të vlerave të treguesve prej 12.84 – 78.05%, në raportin e vitit 2016, shtrirja e tyre fillon me një bazë më të lartë (33.22%) dhe përfundon me një vlerë pak më të ulët (73.57%). Kjo tregon se komunat me performancë të ulët kanë shënuar rritje, ndërsa ato me performancë të lartë kanë shënuar një ulje të lehtë. Prej komunave me performancë të ulët që kanë shënuar rritje dhe kanë kaluar në grupin e komunave me arritje të mesme, janë: Lipjani, Parteshi, Hani i Elezit, Kamenica, Viti dhe Novobërda. Ndërsa komunat që kanë pas arritje të lartë në vitin 2015 dhe kanë rënë në nivelin e mesëm të performancës në vitin 2016, janë: Fushë Kosova, Mitrovica dhe Gjakova, ndërkaq komunat që kanë pas arritje të mesme dhe kanë treguar rezultate të larta në vitin 2016, janë: Prishtina, Prizreni, Glogoci dhe Istogu. Është me rëndësi gjithashtu se 2 komuna: Juniku dhe Shtërpca kanë pas rezultat të lartë në 2015 dhe të njëjtat prapë e kanë ruajtur të njëjtën në vitin 2016, me një ndryshim në renditje, ku Juniku në vitin 2016 ka arritur performancë më të lartë për 2.8%, ndërsa Shtërpca ka shënuar një ulje prej 13.46%. Ndërkaq, performanca e përgjithshme e komunave për vitin 2015 ka qenë 45.71%, në vitin 2016 performanca e komunave është ngritur në 58.53% apo 12.82%. Këto krahasime janë bërë vetëm për ta parë përafërsisht trendin e performancës dhe nuk janë rezultate zyrtare, që të merren si të mirëqena.


MAPL



Nga këto krahasime, [Graf. 19](#), mund të vërehet se shumica e komunave (27 sosh) kanë treguar rritje të performancës prej 2.59 – 39.12%. Ngritjen më të madhe e ka shënuar 38.96%. Zbritje kanë shënuar 8 komuna, 5 prej të cilave: Shtërpca, Gjakova, Fushë Kosova, Mitrovica dhe Graçanica, të cilat në vitin 2015 kanë qenë të radhitura në grupin e 6 komunave me performancë më të lartë.

5.18. Krahasimet me grupet e përafërta të komunave


Siç dihet krahasimet janë të vlefshme nëse krahasohen dy madhësi me natyrë të ngjashme. Me të drejtë shumë herë komunat me numër të madh të banorëve janë ankuar për metodologjinë e matjes së performancës. Është krahasuar shkalla e performancës së një komune të madhe me shkallën e performancës së një komune të vogël, pakrahasimisht me numër të ndryshëm të banorëve dhe të faktorëve tjerë të ndërlikueshmërisë. Duke pas parasysh këta faktorë dhe për arsye profesionale, në këtë vit komunat janë ndarë në tri grupe të ndryshme, në bazë të numrit të banorëve. Komunat e vogla - nën 30,000 banorë; komunat e mesme – prej 31,000 deri 59,000 banorë dhe komunat e mëdha – mbi 60,000 banorë



Grupi i komunave të vogla. Në grupin e komunave të vogla hyjnë 8 komuna, me numër të popullsisë prej 1,787 – 10,675 banorë. Ky grup përbëhet vetëm prej komunave të reja dhe që kanë numër të vogël të popullsisë. Derisa numri më i madh i këtyre komunave, në renditjen e përgjithshme të performancës, janë të renditura në tri shkallët e performancës dhe me numër rendor prej 1 deri në 35, me këtë grupim, shtrirja e tyre është shumë e ngushtë, pa dallime të mëdha dhe mundësohet më lehtë krahasimi i performancës së tyre dhe kuptohet më lehtë nevoja e tyre për përkrahje. Kështu, Graçanica në klasifikimin e përgjithshëm është e katërmbdhjeta, me këtë lloj krahasimi, është e dyta. Kështu ndodhë edhe me Hanin e Elezit, në klasifikimin e përgjithshëm është e renditur në vendin e 26, tani është e katërta. Gjashtë komunat e këtij grupi, pothuaj kanë performancë të përafërt, ndërsa komuna e parë dhe e fundit e këtij grupi kanë rezultate ekstreme, si për këtë grup, po ashtu edhe për performancën e përgjithshme të komunave për vitin 2016.


Grupi i komunave të mesme. Në grupin e komunave të mesme bëjnë pjesë 13 komuna me 31,000 – 59,000 banorë. Rezultati i performancës së këtij grupi është mjaftë i njëtrajtshme. Rezultatet marrin

formën e një trapezi të shkallëzuar shumë lehtë. Shtrirja e vlerave të treguesve, jo shumë të shpërndara, prej 50.83 – 70.14%, tregon për një qëndrueshmëri në matje dhe në ndërtimin e SMPK. Në këtë grup bëjnë pjesë komunat me numër të përafërt të popullsisë dhe me kushte dhe faktorë tjerë të përafërt, që nuk favorizon asnjë komunë në performancën e tyre. Të gjitha komunat kanë parakushte përafërsisht të barabarta për një performancë të barabartë. Dallimet e performancës në këtë grup i atribuohen menaxhimit efektiv të burimeve nga komunat përkatëse. Prej 13 komunave të këtij grupi, 11 komuna i takojnë arritjeve me shkallë të mesme të performancës, ndërsa 2 komuna (Shtime dhe Istog) janë të renditura në grupin e komunave me shkallë të lartë të performancës. Leposaviqi nuk hynë në renditjen zyrtare në mungesë të të dhënave zyrtare. Shih graf. 21.



Këtij grupi i prinë Shtërpca me 70.14% dhe e fundit në këtë grup është Kamenica me 50.83%. Ndërkaq në renditjen e përgjithshme, Fushë Kosova gjendet në vendin e 10, këtu është e katërta, ndërsa Skenderaj në renditjen e përgjithshme është në vendin e 21, këtu është në vendin e tetë. Në këtë mënyrë mundësohet krahasimi ndërmjet të barabartëve dhe matja është më e saktë dhe më objektive.

Grupi i komunave të mëdha. Në grupin e komunave të mëdha bëjnë pjesë 14 komuna me mbi 60,000 banorë. Rezultati i performancës së këtij grupi është më homogjen se sa dy grupet e para.



Shtrirja e vlerave të treguesve prej 53.47 – 67.90%, tregon për një shkallëzim të natyrshëm të rezultateve dhe kalim të lehtë prej një shkalle në tjetrën, edhe pse dallimet ndërmjet komunave të këtij grupi është mbi 100.000 banorë. Dallimin e madh në numrin e banorëve e krijojnë dy komuna: Prishtina dhe Prizreni. Numri i madh i banorëve rëndom e bën më të ndërlikuar arritjen e një shkalle të lartë të performancës, por në të njëjtën kohë krijon edhe përparësi nëse burimet menaxhohen në mënyrë efikase. Në këtë rast shihet se numri i banorëve ka krijuar përparësi për komunën e Prizrenit dhe të Prishtinës, të cilat i prijnë këtij grupi me 67.90 respektivisht 66.65%. Në renditjen e përgjithshme Prizreni renditet e treta, ndërsa Prishtina e gjashta, që automatikisht ua zvogëlon gjasën për përfitime të fondeve të ndryshme për tre, respektivisht për gjashtë herë. Prej 7 komunave të para të këtij grupi, katër prej tyre, në renditjen e përgjithshme, kanë këto pozita: Ferizaji është në vendin e tetë, Podujeva të dymbëdhjetin, Gjilani të trembëdhjetin dhe Gjakova të katërbëdhjetin. Tre komunat e fundit janë: Mitrovica, Malisheva dhe e fundit në grup është Rahoveci.

Raporti për herë të parë sjellë edhe performancën individuale të komunave. Janë 35 raporte të shkurtëra performancës për secilën komunë, të cilat i gjeni të bashkëngjitura këtij raporti në Shtojcën 1.

Raporti nuk ka bazë referente për ta kuptuar trendin e performancës së komunave në kohë të ndryshme. Raporti sjellë informata të dobishme, në bazë të standardeve të brendshme, për ta kuptuar shkallën e arritjes së rezultateve në fushat përkatëse vetëm për vitin 2016. Këto informata do të mundësojnë krijimin e bazës referente të të dhënave për të krahasuar arritjet e performancë në vitet e ardhshme. Në bazë të informatave paralele dhe të kryqëzuara, raporti aktualisht prodhon informata të vlefshme për shkallën e performancës së komunave pa dimensionin kohor.

Divizioni për Performancë të Komunave (DPK) ka pranuar 7,105 të dhëna parësore nga 35 komuna të Republikës së Kosovës, sipas një metodologjie standarde. Secila e dhënë ka qenë e dokumentuar mesatarisht me një burim dhe me dy dokumente prej nga është raportuar e dhëna, që gjithsej janë përpunuar 21,315 të dhëna. DPK gjatë përpunimit i ka verifikuar dhe pastruar gabimet e të dhëna dhe në bazë të analizave të bëra ka nxjerrë këto përfundime nga hulumtimi dymujor i saj.

1. Sistemi për menaxhimin e performancës së komunave (SMPK) është i ndërtuar dhe funksionon në përputhje të plotë me parimet dhe standardet e sistemeve të ngjashme ndërkombëtare për matjen e performancës. Sistemi është plotësisht i dokumentuar dhe i pajisur me të gjitha udhëzimet e nevojshme profesionale dhe administrative. Derisa sistemi ka ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për matjen e performancës, kapacitetet e ulëta profesionale të burimeve njerëzore janë ende të ulëta dhe në proces të konsolidimit. Të dhënat tregojnë se në këtë segment sistemi ende nuk i plotëson sa duhet kërkesat e tij. Sistemi është plotësisht dhe lehtësisht i zbatueshëm edhe pse është zbatuar në verzionin alternativ, pa sistem përkatës elektronik. Sistemi, qysh në hapin e parë, ka arritur ta nxisë punën e komunave në pasqyrimin e dokumentuar të performancës së tyre.
2. Sistemi është zbatuar përgjithshisht, dhe në veçanti është administruar nga komunat, me sukses të plotë dhe pa ndonjë problem të theksuar. Përgjithësisht komunat kanë angazhuar numër të nëpunësve në përputhje me kriteret e caktuara. Megjithatë komunat në përgjithësi nuk i kanë zbatuar kriteret rekomanduese për profilin e zyrtarëve të cilët duhet të punojnë në administrimin e SMPK në komunë. Po ashtu as në MAPL nuk janë respektuar kriteret profesionale për angazhimin e zyrtarëve në administrimin e SMPK. Analizat (monitorimi i drejtpërdrejt dhe dokumentimi) kanë treguar se gjysma e komunave nuk kanë kapacitete të mjaftueshme profesionale për ofrimin cilësor të shërbimeve për qytetarët. Përkundër kësaj komunat kanë treguar vullnet dhe përkushtim të lartë në administrimin e SMPK dhe si rezultat i përkushtimit të tyre, MAPL ka pranuar nga komunat përafërsisht 7,105 të dhëna të ndryshme të dokumentuara deri në shkallën 54.10%.
3. Sistemi ka arritë të mat, me pak vështirësi, qëllimin e asaj që është synuar. Sistemi ka arritur të prodhojë të dhëna relativisht të besueshme dhe informata të dobishme e të vlefshme për të gjitha palët e interesit. Treguesit e SMPK kanë qenë të zbatueshëm deri në shkallën 98%. Një numër i vogël i treguesve ka hasë në disa vështirësi të vogla. Treguesit 7.1.1 dhe 7.1.2 janë mat me vështirësi në mungesë të dokumentacionit relevant, 2 tregues tjerë (4.2.2 dhe 12.2.2) nuk kanë arritë të masin qëllimin në një numër të vogël të komunave dhe 1 tregues (1.1.3) nuk është mat për shkak të mungesës së programit elektronik dhe për këtë arsye rapoti sjellë informata vetëm për 64 tregues.
4. Shumica e të dhënave apo 54.10% prej tyre, janë të dokumentuara në përputhje me kriteret për dokumentim të shkallës së lartë. Numri më i madh i komunave i ka plotësuar këto kriteret prej

54.69 – 98.44%, 10 komuna i kanë plotësuar mesatarisht kriteret e dokumentimit, ndërsa 8 komuna kanë raportuar të dhëna me shkallë të ulët të dokumentimit. Dokumentimi si kriter përdoret për herë të parë dhe janë vërejtur vështirësi të caktuara në dokumentim, ku 3 komuna kanë raportuar të dhëna të pa dokumentuara fare dhe dy komuna i kanë raportuar të dhënat pas afatit zyrtar dhe në pamundësi të verifikimit. Të gjitha të dhënat janë përpunuar dhe janë pasqyruar në raportin e performancës për vitin 2016, por të dhënat e raportuara pas afatit zyrtar, të padokumentuara dhe të pa verifikuara nuk konsiderohen të dhëna zyrtare.

5. Zyra e Kombëtare e Auditorit ka qenë pjesë e zbatimit të SMPK dhe për herë të parë e ka bërë auditimin e të dhënave të raportuara, menjëherë pas raportimit të të dhënave nga komunat në MAPL. Pjesëmarrja në proces e ZKA, e ka ndihmuar shumë procesin dhe i ka dhënë rëndësinë e merituar matjes së performancës së komunave. ZKA ka nxjerrë gjetjet dhe rekomandimet e veta nga procesi i auditimit të komunave.
6. Komunat, për vitin 2016, kanë arritur performancë të përgjithshme prej 58.67%. Komunat kanë shënuar arritje më të lartë në fushën e shërbimeve publike administrative, në fushën e transparencës dhe në fushën e menaxhimit të fatkeqësive. Në përgjithësi komunat kanë treguar performancë më të mirë në fushat që kanë të bëjnë me shërbimet themelore, thelbësore dhe emergjente. Fushat e shërbimeve që kanë ngel mbrapa, janë ato të rregullimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe ato të drejtave të njeriut. Fushat nuk janë pika referuese për shkallën e arritjes së performancës së komunave, por vetëm orientime horizontale të ofrimit të shërbimeve.
7. Matja e performancës së komunave bazohet në shkallën e arritjes së rezultateve. Aktualisht performanca e komunave matet me anën e 24 rezultateve të fushave përkatëse. Shkalla e arritjes së rezultateve realisht tregon shkallën e performancës së komunave. Janë saktë gjysma apo 50% e rezultateve të cilat kanë shënuar arritje të lartë të performancës, që shtrihen prej 66.74 – 91.30%. Prej rezultateve me arritje të lartë dallohen ato që kanë të bëjnë me: shërbimet publike administrative, furnizimi me ujë të pijshëm sipas standardeve, mbledhja e qendrueshme e mbeturinave dhe qasja e qytetarëve në dokumente publike. Prej 12 rezultateve tjera, 5 janë me arritje të mesme, 5 me arritje të ulët dhe 2 rezultate nuk janë të përcaktuara në shkallën e arritjeve, sepse maten me njësi të ndryshme të matjes. Prej rezultateve me arritje të mesme dhe të ulët dallohen ato që kanë të bëjnë me: krijimin e mjedisit të shëndetshëm, sigurimin e qytetarëve në rrugë, planifikimin e qendrueshëm komunal, trajtimin e ujërave të zeza dhe ato që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe të drejtat e njeriut.
8. Hulumtimi apo matja e performancës sjellë edhe informata të rëndësishme për shkallën e arritjes së performancës së përgjithshme sipas komunave dhe sipas secilës komunë në mënyrë individuale (shih shtojcën 1).
9. Prej 35 komunave që janë hulumtuar, shumica prej tyre (28), kanë treguar performancë të nivelit të mesëm dhe shtrihen në të dy anët e mesatares së Kosovës (58.67%). Vlerat e arritjeve kanë marrë një trajtë përafërsisht cilindrike, që tregon për shkallë të lartë të qendrueshmërisë në matje dhe në arritje të komunave. Kjo tregon për një performancë të njëtrajtshme, pa dallime të mëdha prej njëres në komunën tjetër. Po ashtu analizat tregojnë se numri më i madh i komunave (18) kanë arritur performancë mbi mesataren e vendit.

10. Arritjet më karakteristike, më të larta dhe më të ulëta, i hasim në komunën e Junikut (arritja më e lartë 73.57%) dhe ajo e Mamushës (arritja më e ulët 33.22%). Mamusha dhe Juniku janë dy komuna të reja, të formuara pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe rezultati na tregon se themelimi i komunave të reja nuk mund të paragjykohej. Komunitet në RPK i kemi klasifikuar edhe sipas tri shkallëve themelore të arritjes: komunitet me arritje të ulët (1 – 33%); komunitet me arritje të mesme (34 – 66%) dhe komunitet me arritje të lartë (67 – 100%). Në bazë të këtij klasifikimi, numri më i madh i komunave (28) i takojnë grupit të komunave me arritje të mesme (50.17 – 64.58%), 6 komuna hyjnë në grupin e komunave me arritje të lartë (66.12 – 73.57%) dhe vetëm 1 komunitet hynë në grupin e komunave me arritje të ulët, Mamusha me vetëm 33.22%.
11. Po ashtu performanca e komunave është analizuar edhe në bazë të krahasimit të komunave me numër përafërsisht të njëjtë të banorëve. Në bazë të kësaj komunitet janë klasifikuar në tre grupe themelore: komunitet e vogla deri 11,000 banorë, komunitet e mesme prej 12,000 – 51,000 banorë dhe komunitet e mëdha, mbi 51,000 banorë. Ky klasifikim i komunave është bërë vetëm për qëllime të matjes. Derisa numri më i madh i këtyre komunave, në renditjen e përgjithshme të performancës, janë të renditura në tri shkallët e performancës dhe me numër rendor prej 1 deri në 35, me këtë grupim, shtrirja e tyre është shumë e ngushtë, pa dallime të mëdha dhe mundësohet më lehtë krahasimi i performancës së tyre dhe kuptohet më lehtë nevoja e tyre për përkrahje.
12. Performanca e vitit 2016 është krahasuar edhe me performancën e komunave të vitit 2015. Edhe pse matja e performancës së komunave për vitin 2016 është bërë sipas një metodologjie standarde, megjithatë me krahasimet e performancës së komunave në vitin 2015, përpos dallimeve të theksuara, vërehet edhe një ngjashmëri e shtrirjes së vlerave të treguesve përkates. Derisa në raportin e performancës për vitin 2015 kemi një shtrirje më të gjerë të vlerave të treguesve prej 12.84 – 78.05%, në raportin e vitit 2016, shtrirja e tyre fillon me një bazë më të lartë (33.22%) dhe përfundon me një vlerë pak më të ulët (73.57%). Kjo tregon se komunitet me performancë të ulët kanë shënuar rritje, ndërsa ato me performancë të lartë kanë shënuar një ulje të lehtë.
13. Për arritjen e shkallëve të ndryshme të performancës, komunitet kanë angazhuar burime njerëzore me numër të ndryshëm. Në bazë të analizave ka rezultuar se komunitet kanë përdorë kritere të ndryshme në angazhimin e burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për vitin 2016 komunitet (35) kanë angazhuar gjithsej 41,217 zyrtarë që paguhen nga buxheti i komunës. Është konstatuar se numrin më të madh të zyrtarëve e ka angazhuar Prishtina (5247), pasuar nga Prizreni (3074) apo 220 më pak dhe Gjiçani (2670). Prishtina ka angazhuar 1 zyrtar për 37.91 qytetarë, ndërsa Prizreni me numër të përafërt të banorëve ka angazhuar 1 zyrtar për 57.83 qytetarë dhe Gjiçani ka angazhuar 1 zyrtar për 33.77 qytetarë. Mesatarja e vendit është 1 zyrtar për 39.14 banorë (qytetarë).
14. Në përgjithësi komunitet nuk ndryshojnë shumë për nga angazhimi i burimeve njerëzore, me përjashtime të vogla të komunave mbi mesataren e vendit. Përjashtime apo shmangie të mëdha nga mesatarja e vendit kanë bërë: Parteshi 26.46 qytetarë më pak se mesatarja e vendit, Ranillugu 23.85 më pak dhe Graçanica e Klokoti 18.70 qytetarëve më pak. **Shih tab. 1.** Në përgjithësi komunitet kanë angazhuar burime njerëzore më shumë se mesatarja e vendit, apo

përkthyer në termat e statistikave nga tabela 1, komunat me 1 zyrtar u shërbejnë mesatarisht 4.43 qytetarëve më pak se mesatarja e vendit. Mesataren e rrisin komunat me shumicë serbe, që u shërbejnë shumë më pak qytetarëve me 1 zyrtar nga mesatarja e vendit, përndryshe më shumë se gjysma e komunave (23 prej 35) kanë angazhuar më pak zyrtarë se mesatarja e vendit. Komunat që me 1 zyrtar u kanë shërbyer më shumë qytetarëve nga mesatarja e vendit janë: Shtimja me 33.55 qytetarë më shumë për 1 zyrtarë dhe Prizreni me 18.90 qytetarë më shumë. Po ashtu edhe punësimi i femrave në nivelin lokal është mjaftë i lartë 35.53%, përafërsisht 10% më e ulët se pjesëmarrja e përgjithshme natyrore e tyre në popullatën e Kosovës.

15. Hulumtimet kanë treguar se performanca e komunave nuk është më e lartë te komunat që kanë angazhuar burime njerëzore më shumë për kokë banori. Edhe pse 1 zyrtarë në komunën e Prishtinës u shërben 19.90 qytetarëve më pak se 1 zyrtar i komunës së Prizrenit, performanca e komunës së Prishtinës është 1.78% më e ulët se e komunës së Prizrenit. Në përgjithësi nuk vërehet ndonjë ndikim në rritjen e performancës së komunave, kur komunat kanë angazhuar numër më të madh të zyrtarëve, përkundrazi në disa raste numri më i vogël i zyrtarëve të angazhuar, është reflektuar me performancë më të lartë, si në komunën e Shtimes dhe të Prizrenit.
16. SMPK dhe gjetjet nga hulumtimi apo matja e performancës së komunave, të prezantuara nëpërmjet këtij raporti, mund të shërbejë si mundësi e mirë për hulumtime dhe studime më të gjera dhe më të thella për problematikën e ofrimit të shërbimeve nga komunat dhe nxjerrjen e rekomandimeve apo propozimeve profesionale për zgjidhjen e shumë problemeve që ballafaqohen institucionet e pushtetit lokal në raport me përmbushjen e kërkesave të qytetarëve. Për të përmbushur misionin e plotë të SMPK, nevojiten burime njerëzore profesionale, kushte më të mira të punës dhe shmangien e plotë të hulumtimeve të ngjashme paralele në fushën e performancës së komunave nga palët tjera të interesit. Zhvillimet dhe praktikat më të mira në botë janë duke shkuar drejt integritetit të sistemeve dhe eliminimin e funksionimit të gjitha formave individuale dhe paralele të sistemeve të ngjashme.

7.1

Problemet

Janë grumbulluar dhe janë analizuar shumë të dhëna. Gjatë këtij procesi janë identifikuar anët e forta dhe anët e dobëta që do t'i gjeni të përmbledhura me një numër të vështirësive me të cilat është ballafaquar zbatimi i SMPK. Të gjitha vështirësitë e identifikuar janë përmbledhë në disa shtylla kryesore, si: politike, sistimore, administrative, organizative (menaxheriale), profesionale dhe financiare.

1. *Politike.* Sa do që procesi i ndërtimit dhe i rishikimit të SMPK është zhvilluar në konsultim të ngushtë me të gjitha hallkat vendimmarrëse, vërehet një tendencë e vazhdueshme e po këtyre hallkave vendimmarrëse në MAPL dhe në komuna për kërkesa të reja, jasht standardeve të funksionimit të SMPK. Kërkesat jashtë qëllimit dhe metodologjisë standarde të matjes, shkaktojnë probleme në matjen e qëndrueshme dhe profesionale të performancës së komunave. Ndikimet jashtë kriterëve të SMPK, e bëjnë sistemin jo funksional dhe SMPK nuk prodhon rezultate të cilat priten nga ai.
2. *Sistimore.* Format i ndërtimit të SMPK nuk e mbulon të gjithë problematikën e matjes së performancës së komunave. Është sistem i hapur ndaj standardeve të ofrimit të shërbimeve, i hapur ndaj përgjegjësisë dhe llogaridhënies, ndërsa është i mbyllur për sistemet tjera që merren me përpunimin e informatave në sektorin publik. Kjo e vështirëson procesin e integritetit të SMPK me sistemet tjera dhe arritjen e qëllimit të tij, që nëpërmjet ngritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies së udhëheqësve komunal të nxisë zhvillimet pozitive në nivelin lokal. Po ashtu gjatë zbatimit, janë vërejtur disa vështirësi në funksionimin e segmenteve të caktuara të SMPK, si vështirësia e matjes së performancës me 2 – 3 tregues përkatës.
3. *Administrative.* Autonomia e komunave në përcaktimin e koordinatoreve dhe të zyrtarëve komunal për performancë, ka ndikuar në mos respektimin e kriterëve profesionale rekomandues të MAPL për profilin e koordinatoreve dhe të zyrtarëve komunal, të cilët duhet të angazhohen për zbatimin apo administrimin e SMPK në komunën përkatëse. Shkalla shumë e ulët e dokumentimit të punëve në komuna, ka sjellë vështirësi të theksuara në mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave të sakta. Kjo ka sjellë vështirësi zingjirore në procesin e krijimit të dokumenteve, shpeshherë në kundërshtim me procedurat administrative dhe profesionale. Burimi i të dhënave për tatimin në pronë, nuk është treguar shumë i qëndrueshëm për inspektimin e ndërtesave të reja. (shih Formularin për monitorimin e zbatimit të SMPK, Fushë Kosovë, 19.01.2017). Probleme më të mëdha janë hasur me mungesën e planeve rregullative urbane dhe të hollësishme. Pavarsisht se SMPK i ka nxitur, i ka ndihmuar dhe i ka motivuar komunat për dokumentimin e punëve, megjithatë, janë vërejtur edhe improvizime të caktuara në këtë proces. Sistemi i hapur i SMPK dhe i administratës komunale, nuk prodhon obligime për komunat se kur një shërbim është i mjaftueshëm në kuptimin sasior dhe kur është mjaftueshëm cilësor.

4. *Organizative (menaxheriale)*. Edhe pse njësia lokale e SMPK udhëhiqet formalisht nga kryetari i komunës, barra kryesor e administrimit të SMPK në komunë mbetet tek koordinatori, i cili zbatimin e SMPK e ka punë dytësore ose tretësore. Koordinatorët e shumicës së komunave janë ankuar për statusin e tyre dhe angazhimin e tyre në këtë punë me përgjegjësi të madhe pa kompenzim shtesë ose organizim të punëve që iu krijon hapësirë të mjaftueshme për përmbushjen me sukses të kësaj detyre. Po ashtu në procesin e administrimit të SMPK në komunë, rol të rëndësishëm ka drejtori i administratës, i cili në shumicën e komunave nuk funksionon mirë. Mungesa e procedurave administrative për statusin e dokumenteve zyrtare në pasqyrimin e punëve në komunë dhe mungesa e memories institucionale, ka shkaktuar probleme të theksuara në përdorimin dhe referimin e dokumenteve përkatëse për të dhënat përkatëse. Problemi më i theksuar ka qenë, mungesa e datave dhe e numrit të protokoleve në dokumenta. Punët jashtë planit (shumë punë janë kryer pa plan) ka qenë vështirësi e theksuar për një numri të treguesve që matin realizimin e planeve obligative të punës. Problem i veçantë është organizimi i mbledhjes dhe i dokumentimit të të dhënave me kompanitë e ndryshme publike, të cilat në të shumtën e rasteve raportohet se nuk bashkëpunojnë sa duhet me komunat përkatëse. Në vazhden e kësaj, problem është paraqitur edhe matja e një numëri të bizneseve jo aktive.
5. *Profesionale*. Burimet njerëzore të angazhuara për zbatim të SMPK në komuna dhe në MAPL nuk janë në përputhje me kriteret profesionale të rekomanduara. Një numër i mirë i zyrtarëve është angazhuar për herë të parë në këtë punë dhe nuk kanë arritur t'i përvetësojnë të gjitha informatat e nevojshme. Problemi më i madh ka qenë se as zyrtarët e as koordinatorët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm dokumentet e bollshme udhëzuese për zbatimin e SMPK. Matja e një numër të vogël të treguesve ka treguar të jetë pak e vështirë për kapacitetin profesional të zyrtarëve komunal. MAPL në bashkëpunim me DEMOS ka marrë masa për aftësimin e tyre, por ka rezultuar se nuk ka qenë e mjaftueshme dhe për zyrtarët komunal të performancës, trajnimi nuk është organizuar në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe në kohë të mjaftueshme. Edhe pse DPK, është përpjekur ta kompenzojë trajnimin e pamjaftueshëm të zyrtarëve me konsultime të drejt-përdrejta në vendin e tyre të punës, dhe e cila ka rezultuar mjaftë e suksesshme, megjithatë kjo nuk është arritur të organizohet për secilën komunë, për çka janë vërejtur probleme të caktuara.
6. *Financiare*. Edhe pse DEMOS dhe MAPL kanë ndarë disa fonde për stimulimin e komunave që kanë treguar performancë të mirë për vitin 2016, megjithatë është vlerësuar si problem krijimi i një fondi të qëndrueshëm për stimulimin e atyre komunave që tregojnë performancë pozitive në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Kur puna e komunave vlerësohet nga MAPL dhe donatorët, përkushtimi dhe gara e tyre për përfitime të mundshme do të sillte zhvillime më të shpejta në ekonominë e komunave. Probleme janë paraqitur në përdorimin e kriterëve të ndryshme ndërmjet MAPL dhe donatorëve për ndarjen e fondeve stimuluese.
7. *E arritjeve (performanca)*. Arritja mesatare e performancës në shkallë vendi është 58.67%, por kjo është vetëm në kufirin e kalueshmërisë, ndërsa një numër i madh i komunave është nën këtë mesatare. Problemet në performancën e komunave janë të theksuara në fushat që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor, hapësirat publike, kanalizim, rrugë, mbrojtje të mjedisit dhe mirëqenie

sociale. Sa do që përgjegjësit e komunave problemet e zhvillimit i ndërlidhin me buxhetin, analizat teegojnë se problemi kryesor janë kapacitetet e ulëta menaxhuese dhe teknike. Njëri prej problemeve thelbësore të komunave është shkalla e ulët e ndikimit të numrit të nëpëunësve (zyrtarëve) komunal në performancë, që do të thotë se komunat me numër më të vogël të zyrtarëve mund të kenë performancë më të lartë dhe komunat që kanë numër më të madh të zyrtarëve kanë performancë më të ulët. Kjo tregon për shkallën e ulët të prodhimtarisë së burimeve njerëzore në administratën publike lokale.

Procesi i zbatimit të SMPK të rishikuar ka qenë i përqendruar kryesisht në matjen e performancës së komunave, nëpërmjet të cilit proces është bërë edhe verifikimi i funksionimit të SMPK. SMPK është zbatuar me sukses të plotë, por në bazë të problemeve të identifikuara, procesin e matjes së performancës në mënyrë profesionale me SMPK e ri, e presin ende sfida dhe vështirësi të caktuara. Në bazë të gjetjeve dhe problemeve të identifikuara nga analizat e bëra, MAPL, komunat dhe të gjitha palët e interesit që kanë të bëjnë me performancën e komunave duhet të ndërmarrin këta hapa për ta ndihmuar përparimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të SMPK në Kosovë.

1. Të shmangen kërkesat qëllimshkurtëra për ndryshime në metodologjinë e funksionimit të SMPK. Përmirësimet eventuale të SMPK duhet të bëhen vetëm pas analizave gjithëpërfshirëse dhe specifike të funksionimit të tij për një kohë të caktuar. Çdo ndërhyrje në ndërtimin dhe funksionimin e SMPK duhet të bëhet në përputhje me procedurat e përcaktuara për ndryshime dhe zhvillim të SMPK – dokument i veçantë. Për asnjë qëllim nuk duhet të shmanget metodologjia standarde e matjes së performancës, deri në ndryshimin e saj sipas procedurave të përcaktuara. Nuk duhet lejuar që asnjë institucion apo strukturë organizative qëndrore apo lokale të ndërhyrjë në procesin e matjes ose gjatë matjes, sepse kjo mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në rezultatin e matjes, dhe kjo është e ndaluar me ligj.
2. Rekomandohet që DPK / MAPL të bëjë kontrollin e funksionimit të SMPK në matjen e performancës së komunave, të analizojë të gjitha dimensionet e funksionimit të SMPK, të nxjerrë përfundimet për anët e forta dhe të dobëta dhe të bëjë rekomandimet e nevojshme profesionale për përmirësimet eventuale sipas procedurave të përcaktuara me dokumentet përkatëse. Pas konsolidimit të SMPK dhe ndërtimit të kapaciteteve administruese dhe menaxhuese të tij, brenda një periudhe 5 – 10 vjeçare, MAPL duhet t'i fillojë procedurat për rishikimin e SMPK dhe kalimin në opcionin 3 (tre) të zhvillimit të SMPK. Kjo i mundëson SMPK të integrohet me sistemet tjera dhe të kërkojë përgjegjësi dhe llogaridhënie për shërbimet e pa ofruara për qytetarët.
3. Orientimi i sistemit në rritjen e performancës së komunave kërkon rritje të kapaciteteve institucionale, organizim profesional të administratës lokale, ndërtim të kapaciteteve të nevojshme profesionale nëpërmjet rikualifikimit dhe trajnimit sistematik të BNj dhe vlerësimit profesional të bazuar në performancën individuale dhe institucionale. Administrata duhet të udhëhiqet nga profesionistë të fushave përkatëse, të krijohen mekanizmat e nevojshëm administrativ për monitorimin e zbatimit të punëve, të krijohen mekanizmat administrativ për dokumentimin e punëve në komunë dhe të përcaktohet statusi i dokumentit zyrtar në procesin e dokumentimit. MAPL të ndihmojë sipas nevojë.

4. Kryetari i komunës duhet t'i respektojë kriteret rekomanduese të MAPL me rastin e angazhimit të koordinatorëve dhe të zyrtarëve komunal për performancë në këtë detyrë me shumë përgjegjësi. Është në autonominë e komunave për shkallën e angazhimit dhe të kompenzimit të koordinatorëve dhe zyrtarëve komunal të performancës për punët e administrimit të SMPK në komunë. MAPL nuk është kundër mundësive për krijimin e kushteve më të mira dhe të nevojshme në punë për koordinatorët, si bartësit kryesor praktik të punëve dhe përgjegjësive për performancën e secilës komunë. Kryetari i komunës është përgjegjësi kryesor për zbatimin e SMPK në komunën përkatëse dhe në këtë proces duhet të angazhohen më shumë drejtorët e administratës në lehtësimin e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të strukturave organizative brenda komunës dhe jashtë saj, gjatë procesit të zbatimit të SMPK nga koordinatori dhe zyrtarët komunal të performancës. Komunitat duhet ta ndërtojë bazën fizike dhe elektronike të të dhënave apo memorien institucionale për ta dokumentuar punën e tyre përpara institucioneve përgjegjëse dhe zgjedhësve të tyre. Komunitat duhet të kenë kujdes më të madh në planifikimin sa më real të punëve dhe të punojnë sipas planeve përkatëse të punës. Të zbatohen planet dhe të mos lejohet puna jashtë planeve të punës, përpos në rastet dhe në shkallën e lejuar me ligj.
5. Të qartësohen vijat e mbikëqyrjes dhe të raportimit të brendshëm në komunë dhe të forcohet edhe më shumë auditi i brendshëm. Të krijohen mekanizmat e plotë ligjor dhe administrativ për mbikëqyrje efektive në mbrojtjen e ligjshmërisë gjatë punës së komunave. Në marrëdhëniet juridike administrative komuna duhet të gjej mekanizma për bashkëpunim dhe bashkërendim më të mirë të punëve me kompanitë publike për raportim të punëve në organet përkatëse të komunës që e mbulojnë veprimtarinë e tyre.
6. Puna profesionale e burimeve njerëzore reflektohet edhe në shkallën e performancës së komunave. Burimet njerëzore në përgjithësi duhet t'i ndërtojë dhe t'i zhvillojë kapacitetet e nevojshme profesionale për punë të dokumentuar në institucionet lokale, dhe në veçanti ndërtimi i kapaciteteve profesionale duhet të zhvillohet për burimet njerëzore të cilat janë të angazhuara në zbatimin e SMPK. Shumë zyrtarë komunal nuk punojnë sipas planeve dhe kanë pas vështirësi në mbledhjen e të dhënave në mungesë të dokumenteve përkatëse. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të jetë i dyanshëm: në njërin anë komunitat duhet t'i sistemojnë në detyrat e punës përkatëse punonjësit me përgatitje akademike dhe përvojë përkatëse dhe në anën tjetër të bëhet trajnimi i tyre i mjaftueshëm për zbatimin me sukses të punëve dhe të SMPK. Vlerësimi i zyrtarëve duhet të bëhet në bazë të performancës individuale apo arritjeve të tyre në punë dhe të rritet llogaridhënia në punë.
7. MAPL duhet të sigurojë fonde të qëndrueshme stimuluese për përparimin e performancës komunale. MAPL mund të ndikojë në ministritë e linjës në ndarjen e fondeve për projektet zhvillimore të komunave në bazë të performancës së tyre. Po ashtu MAPL mund t'i ndërlidhë projektet e saj në fusha të ndryshme me performancën e komunave. Krejt kjo do ta rriste frymën garuese të komunave për zhvillim më të shpejtë dhe përmabjtësor të tyre.

8. Performanca e komunave duhet të rritet, jo vetëm në mesatare por në përgjithësi, nga 58.67% deri në 70%. Është mirë që të caktohen së paku standardet e arritjeve minimale për performancën e komunave. Kjo do të ndihmonte që rezultatet e matjes të na informonin në mënyrë kuptimplote për shkallën e arritjeve në krahasim me atë se sa dhe çfarë duhet të arrihet. Udhëheqësit e institucioneve lokale duhet t'i menaxhojnë më mirë burimet për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre në punë.
9. Të gjitha palët e interesit, në veçanti komunat dhe MAPL, t'i përdorin gjetjet e përgjithshme dhe të veçanta për performancën e komunave dhe këto rekomandime për procesin e organizimit të punëve në komunë dhe në veçanti për procesin e monitorimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes më të lehtë për përmirësimin dhe përparimin e përgjithshëm të institucioneve në nivelin lokal dhe qendror që ka të bëjë me pushtetin lokal.
10. *E gjithë kjo duhet ta rrisë performancën e komunave dhe ta bëjë udhëheqjen e tyre, si dhe bartësit tjerë, llogaridhënës përballë përfaqësimit të qytetarëve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.*

Shtojca 1

9. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMUNAVE

Pasqyrimi i rezultateve të përgjithshme të performancës janë shumë të rëndësishme për institucionet e nivelit qendror, në veçanti për MAPL, por jo shumë edhe për komunat. Udhëheqësit e komunave dhe zyrtarët përkatës të shërbimeve që maten, kanë nevojë ta kenë të pasqyruar performancën e secilës komunë veç e veç, për ta kuptuar më mirë se cilat janë gjetjet apo rezultatet e matjes së performancës për komunën përkatëse.

Në vazhdim të këtij kapitulli mund t'i gjeni për herë të parë rezultatet individuale të komunave nga ky hulumtim. Pasqyrimi i rezultateve do të përfshijë karakteristikat e përgjithshme të komunës përkatëse, arritjet karakteristike më të larta dhe më të ulëta të performancës së komunës përkatëse, përparësitë dhe dobësitë ose problemet me të cilat ballafaqohet komuna përkatëse, një përfundim i shkurtër dhe rekomandimet përkatëse.

Karakteristikat e përgjithshme të komunës përfshijnë: madhësinë e territorit në km², numrin e banorëve, numrin e zyrtarëve të angazhuar dhe performanca e përgjithshme e komunës përkatëse.

Arritjet më të larta dhe më të ulëta të performancës për komunën përkatëse përfshijnë: fushat me arritje më të lartë të performancës, duke spikatur ndonjë tregues të rëndësishëm dhe fushat me arritje më të ulët, duke vë në pah treguesit që kanë nevojë prioritare për përmirësim.

Për secilën komunë pasqyrohen përparësitë karakteristike që janë shënuar gjatë hulumtimit, pastaj dobësitë më karakteristike dhe problemet më të theksuara që janë hasur gjatë këtij hulumtimi.

Në fund të pasqyritit të performancës individuale të komunës përkatëse, shkruhet një përfundim për performancën e komunës përkatëse dhe rekomandimet themelore për përmirësimin e performancës në vitet e ardhshme.

9.1. Deçan

Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën perendimore të territorit të Republikës së Kosovës, në Jugperëndim të komunës së Pejës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 297 km², me një qendër administrative urbane dhe 37 vendbanime rurale. Hynë në grupin e komunave me zhvillim të bujqësisë dhe degëve të saj: blegtorisë, pylltarisë dhe bletarisë. Është shënuar përparim i vogël edhe në zhvillimin e turizmit dhe ekoturizmit.

9.1.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Deçan	297	40019	792	50.53	53.81

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komunën e Deçanit ka arritur performancë të shkallës mesatare (53.81 %), 4.87% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.1.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e shërbimeve publike administrative (99.40%), në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (84.92%), furnizimin me ujë të pijshëm (79.55%) dhe me transparencën (76.86%). Shih graf. 24. Arritje e rëndësishme është përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm (89.19%), faturimi i ujit të shpenzuar (100%), bërjen transparente të dokumenteve të prokurimit publik, që në shumë komuna ka pas probleme. Siç shihet në grafikun 24, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje mjaftë të ndryshme, me një tendencë të vogël të shtrirjes së grafikut në qendër.

9.1.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (15.17%), në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (20.98%), zgjedhjen e problemeve të kanalizimit (27.37) dhe në planifikimin hapësinor (35.42%). Prej arritjeve të dobëta veçohet punësimi i femrave me vetëm 3.79% apo 33% më e ulët se

mesatarja e vendit, strehimi i familjeve vetëm 2%, përfitimi nga skema sociale 0.95% dhe vetëm 0.33% e territorit e mbuluar me plane rregulluese të holësishme. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.45 m²/kokë banori, ndërkaj komuna ka deponuar 42.42 kg./ kokë banori mbeturina.

9.1.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Zyrtarët përgjegjës për zbatimin e SMPK, kanë vlerësim shumë pozitiv për dokumentet profesionale të siguruar nga MAPL. Megjithatë procesin e kanë përcjellë disa vështirësi dhe dobësi të theksuara. Koordinatorin dhe hallkat tjera përgjegjësi nuk e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave dhe të dhënat janë të dokumentuara në shkallë të ulët. Gjatë mbledhjes dhe raportimit janë hasë gabime të të dhënave për 9 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka përmirësuar gabimet përkatëse, por nuk përjashtohet mundësia e përvdihjes së ndonjë gabimi. Dokumentet origjinale për dokumentimin e të dhënave, nuk kanë qenë mirë të organizuara në njësitë përkatëse në komunë. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.1.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit në 19 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në shumicën e treguesve (45) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 8 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës.. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim modest në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesin e kanë përcjellë dobësi thelbësore në procesin e dokumentimit të mjaftueshëm dhe të shkallës së ulët të verifikimit të të dhënave.

9.1.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Deçanit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e pjesëmarrjes së femrave në punët e komunës;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- T'i jepet prioritet ndërtimit të kanalizimeve dhe përfshirjes së vendbanimeve të pa përfshira;
- Të jepet prioritet planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të planifikuar të vendbanimeve;
- Të gjithë zyrtarët komunal të përcaktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mjaft mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.2. Dragash

Komuna e Dragashit shtrihet në pjesën jugore të territorit të Republikës së Kosovës, në Jug të komunës së Prizrenit. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 430 km², me një qendër administrative urbane dhe 36 vendbanime rurale. Hynë në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të saj: blegtorisë, pylltarisë dhe bletarisë. Është shënuar përparim i vogël edhe në zhvillimin e turizmit dhe ekoturizmit.

9.2.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Dragash	430	33997	704	48.29	61.93

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komunën e Dragashit ka arritur performancë të shkallës mesatare (61.93%), 3.25% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.2.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (86.61%), furnizimin me ujë të pijshëm (89.00%), transport publik (80.32%), mbrojtje e mjedisit (80.95%), Kulturë, rini dhe sport (74.97%) dhe Infrastruktura rrugore (71.77%). Shih graf. 25. Arritje e rëndësishme është përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe mbrojtja e mjedisit, që mesatarja e vendit nuk është lartë (49.11%). Siç shihet në grafikun 27, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje mjaftë të ndryshme.

9.2.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (9.32%), në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (12.61%), në planifikimin hapësinor (41.15%) dhe shërbimet publike administrative (47.37%). Prej arritjeve të dobëta veçohet strehimi i familjeve (0.0%), përfitimi nga skema sociale (5.39%), hapësira e pamjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike (5.21%) dhe vetëm 0.07% e territorit e

mbuluar me plane rregulluese të holësishme. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.88 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 219 kg./ kokë banori mbeturina .

9.2.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Megjithatë procesin e kanë përcjellë disa vështirësi dhe dobësi të theksuara. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse nuk e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave dhe të dhënat janë të dokumentuara në shkallë të mesme. Gjatë mbledhjes dhe raportimit janë hasë gabime të të dhënave për 4 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve përkatëse, por nuk përjashtohet mundësia e përvidhjes së ndonjë gabimi. Dokumentet origjinale për dokumentimin e të dhënave, nuk kanë qenë mirë të organizuara në njësitë përkatëse në komunë. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.2.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit në 34 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël të tyre (30) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 8 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim modest në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesin e kanë përcjellë dobësi thelbësore në procesin e dokumentimit të mjaftueshëm dhe të shkallës së ulët të verifikimit të të dhënave.

9.2.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Dragashit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- Të jepet prioritet planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të planifikuar të vendbanimeve;
- Të gjithë zyrtarët komunal të përcaktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mjaftë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.3. Ferizaj

Komuna e Ferizajit shtrihet në pjesën juglindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 345 km², me një qendër administrative urbane dhe 45 vendbanime rurale. Hynë në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të ndryshme të industrisë për prodhimin e ushqimit, përpunimin e metalit dhe të drurit.

9.3.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Ferizaj	345	108610	2409	45.09	63.54

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komunën e Ferizajit ka arritur performancë të shkallës mesatare (63.54%), 4.86% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.3.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.08%), në menaxhimin e fatkeqësive (88.58%), transport publik (84.11%), furnizimin me ujë të pijshëm (81.98%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (77.25%). Shih graf. 26. Arritje e rëndësishme është përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, sigurimi i transportit publik dhe menaxhimi i mbeturinave edhe pse ende është më e ulët se mesatarja e vendit për 5.7% dhe strehimi i familjeve në nevojë (70.97%) apo 39.37% më e lartë se mesatarja e vendit. Siç shihet në grafikun 27, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje mjaftë të ndryshme, me një tendencë të vogël të shtrirjes së grafikut në qendër.

9.3.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (25.38%), në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (26.84%), në infrastrukturën rrugore (43.16%) dhe në planifikimin hapësiror (44.48%). Prej arritjeve të dobëta veçohet numri i vogël i femrave të punësuar (3.65%), përfitimi nga skema sociale

(0.96%), hapësira e pamjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike (3.72%) dhe vetëm 1.95% e territorit e mbuluar me plane rregulluese të holësishme. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 2.30 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 174.16 kg./ kokë banori mbeturina.

9.3.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 85.09%. Megjithatë procesin e kanë përcjellë disa vështirësi dhe dobësi të theksuara. Dokumentimi formal i përmbledhur apo i sajuar, nuk është mbështetur mjaftueshëm me dokumente origjinale. Gjatë mbledhjes dhe raportimit janë hasë gabime të të dhënave për 7 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve përkatëse, por nuk përjashtohet mundësia e përvidhjes së ndonjë gabimi të mundshëm. Dokumentet origjinale për dokumentimin e të dhënave, nuk kanë qenë mirë të organizuara në njësitë përkatëse në komunë. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.3.5. Përfundim

Komuna u prinë komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 25 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh të tyre (39) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 8 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe shkallë më e lartë e dokumentimit të të dhënave.

9.3.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Ferizajt duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut, përmirësimin e shkallës së punësimit të femrave;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- Të jepet prioritet planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të planifikuar të vendbanimeve;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike;
- Të gjithë zyrtarët komunal të përcaktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mjaft mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.4. Fushë Kosovë

Komuna e Fushë Kosovës shtrihet në kufirin lindor të qendrës së territorit të Republikës së Kosovës, rrespektivisht në Perëndim të Kryeqytetit - Prishtinës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 83 km², me 2 zona urbane, një qendër administrative dhe 16 vendbanime rurale. Hynë në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të ndryshme të industrisë për prodhimin e ushqimit. Përfaqëson nyjen më të rëndësishme të komunikacionit, rrugor, hekurudhor dhe ajror në vend. Prodhohet edhe xeheja apo thëngjilli për Termocentralet A dhe B.

9.4.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Fushë Kosovë	83	34827	696	50.04	61.46

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komunën e Fushë Kosovës ka arritur performancë të shkallës mesatare (61.46%), 2.78% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.4.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (91.42%), në transparencën komunale (80.88%), në fushën e kulturës, rinë dhe sportit (80.51%), furnizimin me ujë të pijshëm (80.83%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (97.13%). Shih graf. 27. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, menaxhimi i mbeturinave njëra prej më të lartave në shkallë vendi, pastaj në kulturë, rini dhe sport, mbi mesataren e vendit për 8% dhe në transparencë komunale, gjithashtu mbi mesataren e vendit për 2%. Siç shihet në grafikun 27, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje mjaftë të ndryshme, me një tendencë të vogël të shtrirjes së grafikut në qendër.

9.4.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (14.16%), në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (18.51%), në kanalizim (46.16%) dhe në planifikimin hapësinor (47.94%). Prej arritjeve

të dobëta veçohet shakalla e ulët e trajtimit të ankesave për strehim të familjeve (3.92%), përfitimi nga skema sociale (5.11%), strehimi i familjeve në nevojë (10.34%), hapësira e pamjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike (1.95%), realizimi i planit për menaxhimin e fatkeqësive (0.0%) dhe vetëm 0.01% e territorit e mbuluar me plane rregulluese të holësishme. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 3.45 m²/kokë banori, ndërkaq komuna ka deponuar 351.48 kg./ kokë banori mbeturina.

9.4.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 64%, që nuk është i mjaftueshëm. Procesin e kanë përcjellë disa vështirësi dhe dobësi të theksuara. Dokumentimi i të dhënave nuk është i plotë dhe procesi i verifikimit nuk ka funksionuar plotësisht në komunë dhe janë lëshuar gabime të caktuara. Gjatë mbledhjes dhe raportimit janë hasë gabime të të dhënave për 4 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve përkatëse, por nuk përjashtohet mundësia e përvdijes së ndonjë gabimi të mundshëm. Dokumentet origjinale për dokumentimin e të dhënave, nuk kanë qenë mirë të organizuara në njësitë përkatëse në komunë. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.4.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 22 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh të tyre (42) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 10 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe shkallë më të lartë të dokumentimit të të dhënave.

9.5.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Fushë Kosovës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut, punësimi i personave me aftësi të kufizuara;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- Të jepet prioritet planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të planifikuar të vendbanimeve;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike;
- Të gjithë zyrtarët komunal të përcaktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mjaft mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.5. Gjakovë

Komuna e Gjakovës shtrihet në jug – perëndim të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 587 km², me 1 zona urbane dhe 88 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të ndryshme të industrisë për prodhimin e ushqimit, të tekstilit, të përpunimit të metaleve, të përpunimit të drurit, materialit ndërtimor. I ka të zhvilluara shumë mirë artizanatet, ndërmarrsinë private dhe turizmin kultur.

9.5.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Gjakovë	587	94556	2139	44.21	61.54

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komunën e Gjakovës ka arritur performancë të shkallës mesatare (61.54%), 2.86% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.5.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (96.47%), në transparencën komunale (97.85%), në furnizimin me ujë të pijshëm (86.06%), në menaxhimin e fatkeqësisve (76.31%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (71.26%). Shih graf. 28. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet publike administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave. Komuna kryesisht ka treguar një arritje të mesme të performancë, me vetëm 5 fusha mbi mesataren e vendit. Siç shihet në grafikun 28, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje mjaftë të ndryshme, me një tendencë më të madhe të shtrirjes së grafikut në qendër.

9.5.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët të thellë vetëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (29.30%), 8% më e lartë se mesatarja e vendit, në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (33.13%), në infrastrukturën rrugore (34.52%) dhe në transportin publik (38.02%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit pakicë (1.31%), përfitimi nga skema sociale (0.25%), inspektimit të

ndërtesave të reja (8.64%), shenjëzimi i rrugëve (13.53%), realizmi i planit për transport lokal (0.0%), hapësira e pamjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike (3.57%) dhe e lëshimit të lejeve mjedisore komunale (5.31%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.63 m²/kokë banori, ndërkaq komuna ka deponuar 171.44 kg./ kokë banori.

9.5.4. Përparësitë dhe dobësitë

Zyrtarët e komunës kanë marrë pjesë rregullisht në procesin e zhvillimit të SMPK. Kanë qenë shumë bashkëpunues dhe me angazhimin e tyre kanë demonstruar se e kanë kuptuar mirë funksionimin e SMPK. Megjithatë zyrtarët përgjegjës për performancë nuk e kanë organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Si pasojë e kësaj komuna ka dështuar në mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në kohën zyrtare. MAPL i ka lejuar një kohë shtesë për raportimin e të dhënave. Komuna i ka raportuar të dhënat për performancën e saj në kohën shtesë, por të dhënat nuk janë verifikuar dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen të sakta dhe të besueshme. Të dhënat janë futur në përpunim dhe janë pjesë e këtij raporti, por nuk llogariten si të dhëna zyrtare.

9.6.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 27 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh të tyre (37) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 11 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim të pamjaftueshëm në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde pas afatit zyrtar. Zbatimi i SMPK kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe shkallë më të lartë e dokumentimit të të dhënave. Komuna nuk i ka zbatuar plotësisht kriteret rekomanduese për caktimin e koordinatorit dhe zyrtarëve komunal për performancë.

9.6.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Gjakovës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- Të jepet prioritet më shumë inspektimit dhe të sigurojë ndërtimit të planifikuar të vendbanimeve;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe të zbatojë planin për transport publik;
- Të vlerësohet puna e koordinatorit dhe e zyrtarëve për performancë dhe të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e tyre me punë në zbatimin e SMPK.
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.6. Gjilan

Komuna e Gjilanit shtrihet në kufirin lindor të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 392 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 42 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të ndryshme të industrisë për prodhimin e ushqimit. Veçohet me industrinë e përpunimit të duhanit, prodhimit të radiatorëve dhe të baterive. Është vend tipik agro – industrial.

9.6.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Gjilan	392	90178	2670	33.77	61.55

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Gjilanit ka arritur performancë të shkallës mesatare (61.55%), 2.87% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.6.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e transparencës komunale (91.33%) dhe në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (87.14%), ndërsa fushat: kulturë, rini dhe sport (73.03%), transporti publik (73.06%) dhe furnizimi me ujë të pijshëm (77.56%), kanë një arritje përafërsisht të njëjtë. Shih graf. 28. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport, në veçanti dallohen arritjet në transparencën komunale. Siç shihet në grafikun 28, performanca e komunës në fusha të ndryshme është me arritje në formë të sharrëzuar, mjaftë të ndryshme, me një tendencë të vogël të shtrirjes së grafikut në qendër.

9.6.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (28.52%), në ofrimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (26.91%) dhe në kanalizim (31.00%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (0.14%), punësimi i personave me aftësi të kufizuar (0.30%) dhe trajtimi i ujrave të zeza (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 1.22 m²/kokë banori, ndërkohë komuna ka deponuar 22.68 kg./ kokë banori mbeturina.

9.6.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave vetëm në shkallën 25%, që nuk është i mjaftueshëm. Procesin e kanë përcjellë disa vështirësi dhe dobësi. Dokumentimi i të dhënave nuk është i plotë për shkak se procesi i verifikimit nuk ka funksionuar plotësisht në komunë. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve përkatëse. Dokumentet origjinale për dokumentimin e të dhënave, nuk kanë qenë mirë të organizuara në njësitë përkatëse në komunë. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.6.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 35 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël prej tyre (29) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 6 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe shkallë më e lartë e dokumentimit të të dhënave.

9.6.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Gjilanit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- Të jepet prioritet më shumë trajtimit të ujërave të zeza;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe të zbatohet planin për transport publik;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe i verifikimit rigoroz të tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.7. Gllgoc

Komuna e Gllgocit shtrihet në pjesën qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 276 km², me 1 zonë administrative urbane, 4 zona urbane dhe 42 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe industrisë për prodhimin e xehes së kromit. Është vend agro – industrial.

9.7.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Gllgoc	276	58531	1256	46.60	66.65

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Gllgocit ka arritur performancë të shkallës së lartë (66.65%), 7.97% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.7.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e transparencës komunale (98.99%), në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (95.87%) dhe në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (96.25%), ndërsa fushat: furnizimi me ujë të pijshëm (77.70%) dhe menaxhimi i mbeturinave (80.31%) kanë një arritje më afër performancës mesatare. Shih graf. 30. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport, menaxhimi i mbeturinave, në veçanti dallohen arritjet në transparencën komunale. Siç shihet në grafikun 30, performanca e komunës në fushat e para është me arritje ekstreme në formë të sharrëzuar, me një tendencë të shtrirjes së grafikut në qendër dhe në përfundimin e tij. Kjo tregon se komuna ka filluar të arrijë suksese të ballancuara në shumicën e fushave.

9.7.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të larta, komuna ka shënuar performancë të ulët vetëm në 2 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (26.47%) dhe në planifikimin hapësinor (25.88%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (2.25%), përgjigja pozitive në ankesat për skemën sociale (4.17%), shenjëzimi i vendndalimeve për transportin publik

(5.78%) dhe numri i vendparkimeve për mjete motorike (5.55%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 7.53 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 83.64 kg./ kokë banori mbeturina.

9.7.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinatorin dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 56%, që nuk është ende i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Dokumentimi i të dhënave nuk është i plotë për shkak se procesi i verifikimit nuk ka funksionuar plotësisht në komunë. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.7.5. Përfundim

Komuna hynë në grupin e vogël të komunave me arritje të lartë të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 35 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël prej tyre (29) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 6 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe shkallë më të lartë të dokumentimit të të dhënave. Komuna ka angazhuar në mënyrë racionale burimet njerëzore për administrimin e SMPK (vetëm 4 zyrtarë dhe koordinatorin)

9.7.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Glllogofcit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe të përmirësoj kushtet për transport publik;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Të përmirësohet procesi i dokumentimit të të dhënave dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.8. Graçanicë

Komuna e Graçanicës shtrihet në kufirin lindor të pjesës qendrore të territorit të Republikës së Kosovës, në Jug – Lindje të Prishtinës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 131 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 16 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe të biznesit. Është vend agro – biznesor dhe udhëkryq i transportit rrugor në vend.

9.8.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Graçanicë	131	10675	526	20.29	60.84

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Graçanicës ka arritur performancë të shkallës së mesme (60.84%), 2.16% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.8.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (100%), në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (108%), që treguesi 4.2.2 nuk ka mat mirë dhe përqindja është mbi 100%, në fushën e transparencës komunale (82.80%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (100%) dhe furnizimi me ujë të pijshëm (91.53%). Shih graf. 31. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport dhe në menaxhimi i mbeturinave. Arritjet mbi 100% në fushën e kulturës tregojnë për dobësitë e matjes së treguesit 4.2.2. Siç shihet në grafikun 31, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave.

9.8.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka performancë të ulët vetëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (11.87%), në planifikimin hapësinor (32.16%), në fushën e parkingjeve publike (14.39) dhe në mbrojtjen e mjedisit (14.29%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (4.43%) dhe punësimi i komunitetit pakicë në komunë.

(3.23%). Është karakteristikë se komuna nuk ka fare transport publik. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 18.80 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 325.06 kg./ kokë banori mbeturina.

9.8.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinator dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 81.3%, që i plotëson kriteret e parapara. Dokumentimi i të dhënave është përafërsisht i plotë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë janë bërë gabime në raportimin e të dhënave për 2 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.8.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 32 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin e njëjtë prej tyre (29) ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 6 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.8.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Graçanicës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe të përmirësoj kushtet për transport publik;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigorozi i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.9. Hani i Elezit



Komuna e Hanit të Elezit shtrihet në kufirin jug – lindor të territorit të Republikës së Kosovës, në kufi me Maqedoninë. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 83 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 11 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pylltarisë, pemtarisë dhe të ekoturizmit. E ka të zhvilluar edhe industrinë e përpunimit të mineraleve, në veçanti të cimentos dhe gëlqeres. Është porta kryesore hyrse dhe dalje e vendit për në Maqedoni.

9.9.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Hani i Elezit	83	9403	215	43.73	54.48

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Hanit të Elezit ka arritur performancë të shkallës së mesme (54.48%), 4.2% më e ultë se mesatarja e vendit.



9.9.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (100%), në fushën e transparencës komunale (87.92%), në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (82.97%), gjithashtu vërehet një sukses mesatar në trajtimin e ujrave të zeza (70.70%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (68.96%). Shih graf. 32. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport dhe në menaxhimin e mbeturinave. Bërja transparente e punëve të komunës, është një arritje tjetër. Siç shihet në grafikun 32, performanca e komunës karakterizohet me arritje ekstreme të fushave të para dhe pjesa e mesme dhe përfundimtare tregon për një tendencë të balancuar të arritjeve të performancës.

9.9.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka treguar performancë të ulët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (6.13%), në planifikimin hapësinor (21.94%) dhe në fushën e parkingjeve publike (32.90%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema

sociale (1.95%), transporti publik (2727%) dhe planifikimi hapësinor (0.55%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 3.31 m²/kokë banori, ndërkaq komuna ka deponuar 106.18 kg./ kokë banori mbeturina.

9.9.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar relativisht mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 21.9%, që është shumë larg kriterëve të parapara. Pra dokumentimi i të dhënave është i pamjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë janë shënuar disa dobësi në raportimin e saktësisë së të dhënave për 3 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.9.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 28 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (36), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 4 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.9.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Hanit të Elezit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe të përmirësoj kushtet për transport publik;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.10. Istog

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veri - perendimore të territorit të Republikës së Kosovës, në Veri – Lindje të Pejës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 454 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 50 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit.

9.10.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Istog	454	39289	916	42.89	66.99

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Istogut ka arritur performancë të shkallës së lartë (66.59%), 8.31% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.10.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (97.68%), në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (75.87%), në fushën e transparencës komunale (97.23%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (100%), furnizimi me ujë të pijshëm (87.20%), transport publik lokal (80.93%), menaxhim të mbeturinave (80.19%) dhe mbrojtje e mjedisit (77.38). Shih graf. 33. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport, transport publik dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 33, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, arritjet janë në formë të sharrëzuar.

9.10.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të larta, komuna ka performancë të ulët në 2 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (30.21%) dhe në hapësirat për parkim të mjeteve motorike (26.20%), ndërsa arritje të mesme janë shënuar në 3 fusha: në planifikimin hapësinor (43.68%), në infrastrukturën rrugore (40.59%) dhe në trajtimin e ujrave të zeza (39.22%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shkalla e ulët e punësimit të femrave (6.55%), shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (1.32%), përkundër strehimit të familjeve në nevojë (61.76%) dhe planifikimi hapësinor 0.97%). Hapësirat

e gjelbra dhe të shesheve janë 6.87 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 15.45 kg./ kokë banori mbeturina.

9.10.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinatorin dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 68.75%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesin e administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë janë shënuar disa dobësi në raportimin e saktë të të dhënave për 4 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.10.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e 7 komunave me arritje më të lartë të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 36 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël prej tyre (28), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 8 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.10.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Istogut duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirjen e femrave në punësim;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe ta përmirësojë infrastrukturën rrugore;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.11. Junik

Komuna e Junikut shtrihet në pjesën jug - perendimore të territorit të Republikës së Kosovës, në Jug – Perëndim të Pejës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 74 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 3 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit.

9.11.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Juniku	74	6084	156	39.00	73.57

Në bazë të analizave individuale të të dhënave komuna e Junikut ka arritur performancën më të lartë në vend për vitin 2016, me (73.57%) apo 14.89% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.11.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në 10 fusha të rëndësishme: në ofrimin e shërbimeve publike administrative (99.15%), në fushën e transparencës komunale (95.53%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (95.45%), furnizimi me ujë të pijshëm (97.67%), transport publik lokal (100%), menaxhim të mbeturinave (92.93%) dhe menaxhimin e mbeturinave (85.45). Ndërkaq 3 fusha kanë arritje të mesme: Planifikim hapësinor (39.83%), infrastrukturë rrugore (39.62%) dhe mbrojtje e mjedisit (54.76%). Shih graf. 34. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport, transport publik, menaxhimin e fatkeqsive, transparencë dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 34, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, arritjet janë në formë të sharrëzuar.

9.11.3. Arritjet më të ulta

Komuna ka shënuar performancë të ulët vetëm në fushën e të drejtave të njeriut, shërbimet sociale dhe familjare me 23.43%. Në këtë fushë të gjitha komunat, pa përjashtim, kanë shënuar performancë të ulët.

Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 116.80 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 26.86 kg./kokë banori mbeturina.

9.11.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 96.88%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është përafërsisht i plotë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Janë konstatuar 3 tregues me gabime teknike dhe komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.11.5. Përfundim

Komuna ka treguar performancën më të lartë në Republikën e Kosovës për vitin 2016. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 38 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël prej tyre (26), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 2 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.11.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Junikut duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirjen e femrave në punësim;
- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të rriten hapësirat për parkim të mjeteve motorike dhe ta përmirësojë infrastrukturën rrugore;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës. Edhe pse kjo është realizuar mjaftë mirë nga komuna, por gjithherë ka nevojë për përmirësime të vazhdueshme.


9.12. Kamenicë

Komuna e Kamenicës shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Kosovës dhe në Lindje të Prishtinës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 424 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 58 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit. Është e pasur edhe me minerale.

9.12.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Kamenicë	424	36085	861	41.91	50.83

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Kamenicës ka arritur performancë të shkallës mesatare (50.83%), 7.85% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.12.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë vetëm në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.54%) dhe në fushën e transparencës komunale (83.12%). Është komuna e parë që ka një shtrirje të gjerë të performancës së fushave (10) pranë mesatarës së vendit. Mbi mesatarën e vendit qëndrojnë këto fusha: kultura, rinia dhe sporti (62.38%), furnizimi me ujë të pijshëm (64.17%) dhe transport publik lokal (60.12%). Shih graf. 35. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, transparencë komunale, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm, zhvillimet në kulturë, rini dhe sport, transport publik dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 35, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, ku dallimet nuk janë shumë të theksuara.

9.12.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të larta, komuna ka performancë të ulët në 4 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (19.06%), në planifikimin hapësinor (30.11%), në trajtimin e ujrave të zeza (30.59%) dhe në mbrojtje të mjedisit (28.98%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shkalla e ulët e trajtimit të rasteve sociale (1.84%), e përfshirjes së vendbanimeve në ujin e pijshëm (6.90%) dhe

planifikimi hapësinor (0.43%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 3.33 m²/kokë banori, ndërkohë komuna ka deponuar 94.13 kg./ kokë banori mbeturina.

9.12.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë dhe kanë dhënë kontribut edhe gjatë zhvillimit të SMPK. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 64.06%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar, me përjashtim të llogaritjes së të dhënave për përfshirjen e vendbanimeve në ujë të pijshëm. Janë shprehur dobësi edhe në raportimin e saktë të të dhënave për 2 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.12.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e 27 komunave me arritje të shkallës së mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 24 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (40), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 7 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.12.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e kamenicës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Të punohet më shumë në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të ndërtohen kapacitetet e nevojshme për përfshirjen e vendbanimeve në ujin e pijshëm, si arritja më e ulët në nivel të vendit;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigorozi i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.13. Kaçanik

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jug - lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 211 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 31 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit. Është e pasur edhe me minerale.

9.13.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Kaçanik	211	33409	1093	30.57	51.29

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Kaçanikut ka arritur performancë të shkallës së mesme (51.29%), 7.39% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.13.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.47%), në fushën e transparencës komunale (84.04%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (68.77%), furnizimi me ujë të pijshëm (73.90%) dhe menaxhim të mbeturinave (62.87%). Shih graf. 36. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 36, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, pothuaj plotësisht identike me mesataren e vendit.

9.13.3. Arritjet më të ulta

Përpos dy arritjeve të shënuara, komuna ka performancë të ulët në 5 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (19.68%), në infrastrukturën rrugore (32.92%), në trajtimin e ujërave të zeza (22.79%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (10.30%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (2.39%), strehimi i familjeve në nevojë (11.67%), planifikimi hapësinor (0.38%), trajtimi i ujërave të zeza (0.0%) dhe rregullimi i mjedisit. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 1.41 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 77.31 kg./ kokë banori mbeturina.

9.13.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e SMPK e ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 60.94%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 3 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.13.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të memse të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 24 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (40), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 8 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.13.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Kaçanikut duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë planifikimit të territorit;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.14. Klinë

Komuna e Klinës shtrihet në kufirin perëndimor të pjesës qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 309 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 54 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit. Është e zhvilluar industria e përpunimit të gurit ndërtimor.

9.14.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Klina	309	38496	934	41.22	51.62

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Klinës ka arritur performancë të shkallës së mesme (51.62%), 7.06% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.14.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (95.64%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (79.00%), në planifikimin hapësinor (74.25%), furnizimi me ujë të pijshëm (71.16%) dhe menaxhim të mbeturinave (80.05%). Shih graf. 37. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, menaxhimi i fatkeqsive, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 37, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, ku lakorja e përshkon lakoren e performancës së vendit nga ana e poshtme, që do të thotë se ka performancë më të ulët se mesatarja e vendit.

9.14.3. Arritjet më të ulta

Përpos dy arritjeve të shënuara, komuna ka performancë të ulët në 3 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (20.59%), në infrastrukturën rrugore (24.69%) dhe në trajtimin e ujrave të zeza (34.05%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (2.11%), strehimi i familjeve në nevojë (14.08%), në transparencë dhe në infrastrukturë rrugore: rregullimi i trotuareve (7.47%) dhe i ndriçimit publik (0.87%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 11.01 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 192.23 kg./kokë banori mbeturina.

9.14.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 62.50%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 3 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.14.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të memse të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 22 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (42), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 7 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.14.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Klinës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përmirësimi i transparencës komunale;
- T'i ofrohet ndihmë sociale dhe strehimin e njerëzve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigorozi i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.15. Kllokot

Komuna e Kllokotit shtrihet në pjesën jug - lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 23 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 4 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe është e pasur me burime natyrore – ujë mineral dhe sherues.

9.15.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Kllokoti	23	2556	127	20.13	50.17

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Kllokotit ka arritur performancë të shkallës së mesme (50.17%), 8.51% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.15.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (92.57%), në fushën e transparencës komunale (74.31%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (83.33%), planifikimi hapësinor (76.94%) dhe menaxhim të mbeturinave (84.33%). Shih graf. 38. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet publike administrative, menaxhimi i mbeturinave dhe planifikim hapësinor. Siç shihet në grafikun 38, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, ku vërehet një rregullësi e rritjes dhe e uljes së performancës për grupe të caktuara të fushave.

9.15.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 5 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (21.12%), në kulturë, rini dhe sport (2.34%), në hapësirat për parkim të mjeteve motorike (5.21%) dhe në furnizimin me ujë të pijshëm (19.77%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e furnizimit me ujë të pijshëm dhe e zhvillimeve në kulturë, rini dhe sport. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 7.82 m²/kokë banori, ndërkaj komuna ka deponuar 44.01 kg./ kokë banori mbeturina.

9.15.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemin të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse nuk e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në përputhje me standardet e kërkuara. Si rrjedhojë dokumentimi është i shkallës së ulët dhe të dhënat nuk janë shumë të besueshme. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 3 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.15.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 27 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (37), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 4 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.15.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Novobërdës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet shumë furnizimit me ujë të pijshëm;
- Të punojë më shumë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.16. Leposaviq

Komuna e Leposaviqit shtrihet në pjesën më veriore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 539 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 72 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe të bizneseve të vogla. Është e pasur edhe me minerale.

9.16.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Leposaviq	539	13515	?	?	57.20

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Leposaviqit ka arritur performancë të shkallës së lartë (57.20%), 1.33% më e ulët se mesatarja e vendit. Megjithatë kjo komunë nuk i ka raportuar të gjitha të dhënat dhe janë të pa miratuara dhe të paverifikuara.



9.16.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e transparencës komunale (83.33%), në fushën e infrastrukturës rrugore (98.33%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (75.15%). Shih graf. 39. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: infrastruktura rrugore dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 39, performanca e komunës karakterizohet me arritje në 3 fusha kryesore.

9.16.3. Arritjet më të ulta

Përpos tre arritjeve të shënuara, komuna ka performancë të ulët në 3 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (0.0%), në planifikimin hapësinor (0.99%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (33.33%). Komuna nuk ka raportuar për 7 fusha.

9.16.4. Përparësitë dhe dobësitë

Komuna nuk ka qenë bashkëpunuese për zbatimin e SMPK. Komuna nuk ka koordinator e as zyrtar përgjegjës për performancë. Të dhënat i kanë raportuar zyrtarët komunal të udhëzuar dhe koordinuar nga Branko Utviq dhe Sonja Bozhiviq, punëtorë të MAPL, të angazhuar për performancë të komunave me shumicë serbe: Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

9.16.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e 3 komunave serbe të cilat nuk kanë bashkëpunim të mirë me MAPL për zbatimin e SMPK. Kjo komunë dhe dy komunat tjera, nuk i kanë të emëruar ende koordinatorët dhe zyrtarët komunal për performancë. Si pasojë e kësaj SMPK nuk është zbatuar sipas standardeve të përcaktuara për këtë vit edhe pse komuna e Leposaviqit ka shpreh një lloji gatishmërie për bashkëpunim.

9.16.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Leposaviqit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Të caktojë koordinatorin dhe zyrtarët komunal për performancë;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të rris bashkëpunimin me MAPL për zbatimin e SMPK;
- T'i dërgon zyrtarët dhe koordinatorin në trajnim për ndërtim të kapaciteteve për zbatimin e SMPK sipas metodologjisë standarde;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;

9.17. Lipjan



Komuna e Lipjanit shtrihet në kufirin lindor të pjesës qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 338 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 62 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, të pemtarisë dhe industrisë për prodhimin e ushqimit. Është e pasur edhe me minerale të ndryshme.

9.17.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Lipjan	338	57605	1491	38.64	57.82

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Lipjanit ka arritur performancë të shkallës së mesme (57.82%), 0.86% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.17.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e transparencës komunale (77.80%), në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (92.86%), në fushën e planifikimit hapësinor (84.95%), në transportin publik (70.56%), furnizimi me ujë të pijshëm (79.33%) dhe menaxhim të mbeturinave (72.60%). Shih graf. 40. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: menaxhimi i fatkeqësive, planifikimi hapësinor, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 40, performanca e komunës karakterizohet me arritje ekstreme për fushat e para dhe me arritje mjaft të sharrzuar në pjesën e fundit të grafikut.

9.17.3. Arritjet më të ulta

Përpos dy arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 3 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (14.29%), në infrastrukturën rrugore (20.71%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (25.00%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (7.99%), strehimi i familjeve në nevojë (2.78%), e rregullimit të infrastrukturës rrugore: trotualet (14.62%), ndriçimi (11.54%) dhe shenjzimi (7.69%). Probleme janë shënuar edhe me zbatimin e planit lokal për veprim në mjedis (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.53 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 125.70 kg./ kokë banori mbeturina.

9.17.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 51.56%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 1 tregues. Komisioni verifikues i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.17.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të memse të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 30 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të vogël prej tyre (24), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 9 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.17.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Lipjanit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike administrative;
- Në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Të priorizohet zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës

9.18. Malishevë

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 306 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 44 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, të pemtarisë dhe të ekoturizmit. Është e pasur edhe me ujëra termik.

9.18.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Malishevë	306	54613	1421	38.43	54.89

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Kaçanikut ka arritur performancë të shkallës së mesme (54.89%), 3.79% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.18.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (93.87%), në fushën e transparencës komunale (85.90%), në fushën e transportit publik (84.24%), planifikimi hapësinor (77.65%), furnizimi me ujë të pijshëm (73.01%) dhe menaxhim të mbeturinave (70.70%). Shih graf. 41. Arritje të rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, transport publik, përfshirja e vendbanimeve në ujë të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave. Siç shihet në grafikun 41, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, të cilat popothuaj e mbështjellin performancën në shkallë vendi, disa më lartë e disa më ulët.

9.18.3. Arritjet më të ulta

Përpos dy arritjeve të shënuara, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 4 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (11.93%), në hapësirat për parkim të mjeteve motorike (23.33%), në trajtimin e ujrave të zeza (28.23%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (23.33%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shkakllat e ulët e përfitimit nga skema sociale (1.44%), strehimi i familjeve në nevojë (0.0%), infrastruktura rrugore: trotualet (11.64%), ndriçimi publik (7.32%), shenjzimi i rrugëve (4.68%), trajtimi i ujrave të zeza (0.0%) dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis. Hapësirat e gjelbra

dhe të shesheve janë 1.46 m²/kokë banori, ndërkaq komuna ka deponuar 146.03 kg./ kokë banori mbeturina.

9.18.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Drejtorin e administratës dhe Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 73.4%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 7 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.18.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të memse të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 25 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (39), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 10 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.18.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Istogut duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujrave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.19. Mamushë

Komuna e Mamushës shtrihet në pjesën jugore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 32 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 1 vendbanim. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë apo thënë drejtë është i zhvilluar shumë agro – biznesi, ku dallohet eksporti i ushqimeve të përpunuara.

9.19.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Mamushë	32	5587	136	41.08	33.22

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, komuna e Mamushës ka arritur performancën më të në vend për vitin 2016, me vetëm 33.22% apo 25.46% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.19.2. Arritjet më të larta

Komuna ka treguar performancë më të lartë se mesatarja e vendit vetëm në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.98%) dhe në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (100%), kurse në menaxhimin e mbeturinave është pranë meatares së vendit (68.46%). Shih graf. 42. Siç shihet në grafikonin 42, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave.

9.19.3. Arritjet më të ulta

Në shumicën e fushave komuna ka shënuar performancë të ulët, si: në fushën e transparencës (27.08%), në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (3.64%), në kulturë, rini dhe sport (0.0%), në planifikimin hapësor (0.0%), në hapësirat për parkim të mjeteve motorike (0.0%) dhe në furnizim me ujë të pijshëm (22.22%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (0.36%), strehimi i familjeve në nevojë (0.0%), trajtimi i ujrave të zeza (0.0%) dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 1.97 m²/kokë banori, ndërkaj komuna ka deponuar 146.05 kg./ kokë banori mbeturina.

9.19.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar jo mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë jo i mjaftueshëm. Koordinatorin dhe hallkat tjera përgjegjëse e nuk e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në përputhje me kërkesat zyrtare, që tregon se dokumentimi i të dhënave është i një shkalle shumë të ulët (6.25%). Procesi i administrimit të SMPK nuk është bërë në përputhje me metodologjinë standarde. Si pasojë e kësaj, të dhënat e performancës janë raportuar në MAPL, të pa miratuara nga askush. Të dhënat janë përpunuar dhe janë pjesë e këtij raporti, por nuk janë të dhëna zyrtare.

9.19.5. Përfundim

Mamusha është e vetmja komunë me performancë të ulët për vitin 2016. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 26 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (38), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 9 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.19.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Mamushës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në hapësirat për parkim të automjeteve;
- T'i jep prioritet zhvillimit të kulturës, rinisë dhe sportit;
- Të prioritetizohet furnizimi me ujë të pijshëm, trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.20. Mitrovicë Jugore

Komuna e Mitrovicës Jugore shtrihet në pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 331 km², me 3 zonë urbane, prej tyre 1 administrative dhe 46 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me rezerva të mëdha të pasurive nëntokësore: plumb, zing, bakër, ari etj. Po ashtu ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë dhe të turizmit industrial, kulturor ekoturizmit.

9.20.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Mitrovicë	331	71909	1188	39.07	56.50

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Mitrovicës Jugore ka arritur saktësisht performancë të mesatares së vendit (56.50%), 2.18% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.20.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (96.95%), në fushën e transportit publik (87.32%), furnizimi me ujë të pijshëm (74.38%) dhe mbrojtja e mjedisit (85.00%). Shih graf. 43. Arritje e rëndësishme është shënuar në ofrimin e shërbimeve themelore, si: shërbimet administrative, transport publik dhe mbrojtja e mjedisit. Siç shihet në grafikun 43, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, rezultatet e të cilave popothuaj e mbështjellin lakoren e performancës në shkallë vendi.

9.20.3. Arritjet më të ulta

Komuna nuk ka arritje shumë të larta e as arritje shumë të ulëta. Arritjet më të ulëta janë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (22.70%), mbi mesataren e vendit, dhe menaxhimi i mbeturinave (34.28%). Fushat tjera kanë arritje të shkallës mesatare. Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e punësimit të femrave (12.21%), përfitimit nga skema sociale (2.80%), planifikimi hapësinor (10.00%), vendparkimet për metet motorike (8.47%), përfshirja e ekonomive shfrytëzuese në ujësjellës (14.79%), e realizimit të orarit për mbledhjen e mbeturinave (0.0%) dhe e inkasimit të mjeteve për mbledhjen e mbeturinave (0.0%). Zyrtarët përgjegjës në komunë nuk kanë qenë

bashkëpunues për verifikimin e 2 të dhënave të fundit. Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.83 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 334.27 kg./ kokë banori mbeturina.

9.20.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar relativisht mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë. Koordinator dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 25%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar, përveç bashkëpunimit të brendshëm. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 5 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve në shkallë të pamjaftuar për shkak të papërgjegjësisë së zyrtarëve përkatës. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës dhe komuna ka qenë e përfshirë në pilotim.

9.20.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të memse të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 29 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (35), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 9 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.20.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Mitrovicës së Jugut duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e hapësirave për parkim publik;
- Të prioritetizohet menaxhimi më i mirë i mbeturinave;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.21. Novobërdë

Komuna e Novobërdës shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 204 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 23 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, xehtarisë dhe të ekoturizmit. Është e pasur edhe me monumente të trashëgimisë kulturore.

9.21.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Novobërdë	204	6729	375	17.94	52.28

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Novobërdës ka arritur performancë të shkallës së mesme (52.28%), 6.40% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.21.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (98.04%), në fushën e transparencës komunale (75.88%), në fushën e planifikimit hapësinor (100%), furnizimi me ujë të pijshëm (71.93%) dhe menaxhim të mbeturinave (88.11%). Shih graf. 44. Arritje e rëndësishme është shënuar në planifikimin hapësinor, më e larta në vend dhe në menaxhimin e mbeturinave. Siç shihet në grafikun 44, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, të cilat e kapërcejnë performancën në shkallë vendi në shumë segmente.

9.21.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 4 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (22.96%), në transportin publik (33.33%), në hapësirat për parkim publik (0.14%) në trajtimin e ujrave të zeza (22.10%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (25.00%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (6.72%), strehimi i familjeve në nevojë (0.0%), transporti publik (0.0%), faturimi dhe pagesat e ujit të shpenzuar (0.0%), parkingjet publike (0.0%), trajtimi i ujrave të zeza (0.0%) dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.89 m²/kokë banori, ndërkaj komuna ka deponuar 228.11 kg./kokë banori mbeturina.

9.21.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 98.44%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është pothuajse i plotë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 1 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve të vogla gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.21.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 25 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (39), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 12 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.21.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Novobërdës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e transportit publik;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.22. Obiliq

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 105 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 18 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë. Është e pasur me rezerva të mëdha të thëngjillit dhe e ka të zhvilluar industrinë për prodhimin e energjisë termike. Është vend tipik agro – industrial.

9.22.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Obiliq	105	21549	665	32.40	60.28

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Obiliqit ka arritur performancë të shkallës së mesme (60.28%), 1.60% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.22.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (98.15%), në fushën e transparencës komunale (74.12%), në kulturë, rini dhe sport (70.23%), në fushën e menaxhimit të fatkeqsive (92.50), në transportin publik (100%), në furnizimin me ujë të pijshëm (89.94%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (78.75%). Shih graf. 45. Arritje e rëndësishme është shënuar në transportin publik, më e larta në vend dhe në menaxhimin e mbeturinave, në menaxhimin e fatkeqsive dhe furnizimi me ujë të pijshëm. Siç shihet në grafikun 45, performanca e komunës karakterizohet me arritje jo të balancuar ndërmjet fushave, lakorja e të cilave e kapërcen lakoren e performancës në shkallë vendi në mënyrë të theksuar në shumë segmente.

9.22.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 3 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (12.57%), në infrastrukturën rrugore (16.96%) dhe në hapësirat për parkim publik (10.66%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (3.93%), strehimi i familjeve në nevojë (15.45%), planifikimi hapësinor – planet rregulluese

(0.0%) dhe trajtimi i ujrave të zeza (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 1.30 m²/kokë banori, ndërkah komuna ka deponuar 191.86 kg./ kokë banori mbeturina.

9.22.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 43.75%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm, e po ashtu edhe shkalla e besimit nuk është e lartë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë procesit janë lëshuar gabime në saktësinë e të dhënave për 14 tregues. Komisioni verifikues e ka vizituar komunën dhe i ka bërë përmirësimet e gabimeve gjatë raportimit. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.22.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 32 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (32), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 7 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.22.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Obiliqit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve, rregullimit të trotuareve, ndriçimit publik, hapësirave të gjelbra dhe të atyre për parkim publik;
- Të prioritetizohet gjithashtu trajtimi i ujërave të zeza;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.23. Partesh

Komuna e Parteshit shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 29 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 2 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Janë të zhvilluara biznese të vogla për tregtimin e prodhimit të ushqimit.

9.23.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Partesh	21	1787	141	12.67	53.74

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Parteshit ka arritur performancë të shkallës së mesme (53.74%), 4.94% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.23.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (100%), në fushën e transparencës komunale (76.22%), në kulturë, rini dhe sport (125.35%), që do të thotë se e gjithë popullata e komunës ka marrë pjesë në veprimtaritë përkatëse, ku 25.35% e tyre kanë marrë pjesë edhe më shumë se njëherë. Në fakt treguesi nuk ka matë saktësisht atë që është synuar. Arritje të lartë ka shënuar edhe në menaxhimin e mbeturinave (76.38%). Shih graf. 46. Arritje e rëndësishme është shënuar në pjesëmarrjen e qytetarëve në veprimtaritë kulturore, rinore dhe sportive dhe në menaxhimin e mbeturinave. Siç shihet në grafikun 46, performanca e komunës karakterizohet me arritje të qëndrueshme ndërmjet fushave, qoftë në rënie, qoftë në rritje të performancës, që e kapërcen lakoren e performancës në shkallë vendi në formë drejtëvizore dhe jo të sharrëzuar sikur në komunat tjera.

9.23.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 4 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (5.94%), në transportin publik (14.29%), në hapësirat për parkim publik (0.0%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (15.91%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (2.13%), strehimi i familjeve në nevojë (0.0%), infrastruktura

rrugore: trotualet (5.45%), ndriçimi publik (0.0%), shenjëzimi i rrugëve (0.0%), transporti publik (0.0%) dhe plani lokal për veprim në mjedis (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 1.18 m²/kokë banori, ndërkohë komuna ka deponuar 326.50 kg./ kokë banori mbeturina.

9.23.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 92.19%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është përafërsisht i plotë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.23.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 25 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (39), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 11 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregojnë për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.23.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Parteshit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve, rregullimit të trotuareve, ndriçimit publik, hapësirave të gjelbra dhe të transportit publik;
- Të prioritetizohet gjithashtu mbrojtja e mjedisit dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigorozi i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.24. Pejë

Komuna e Pejës shtrihet në pjesën perëndimore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 603 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 79 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe blegtorisë. Ka pasuri të mëdha natyrore mbitokësore, me vargmale të Bjeshkëve të Nemura, që i mundësojnë zhvillimin e turizmit veror dhe atë dimror, e në veçanti e ka të zhvilluar agro – biznesin.

9.24.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Pejë	603	96450	2134	45.20	62.57

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Pejës ka arritur performancë të shkallës së mesme (62.57%), 3.89% më e lartët se mesatarja e vendit.



9.24.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.47%), në fushën e transparencës komunale (89.05%), në kulturë, rini dhe sport (88.85%), në menaxhimin e fatkeqësive (100%), në planifikimin hapësinor (95.92%), në furnizimin me ujë të pijshëm (83.66%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (74.55%). Shih graf. 47. Arritje e rëndësishme është shënuar në kulturorë, rini dhe sport, në planifikimin hapësinor dhe në furnizimin me ujë të pijshëm. Siç shihet në grafikun 47, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, me një tendencë të vendosjes mbi mesataren e vendit.

9.24.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar edhe performancë të ulët në 4 fusha: në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (17.70%), në transportin publik (31.65%), në hapësirat për parkim publik (27.38%) dhe në trajtimin e ujrave të zeza (28.95%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (1.10%), strehimi i familjeve në nevojë (3.53%), realizimin e planit për transporti publik (0.0%), e hapësirave për parkim të mjeteve motorike (2.78%), e

trajtimin të ujrave të zeza (0.0%) dhe e lëshimit të lejeve mjedisore (6.40%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 4.98 m²/kokë banori, ndërkohë komuna ka deponuar 328.75 kg./ kokë banori mbeturina.

9.24.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë i mirë. Koordinatorin dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 54.69%, që tregon se dokumentimi i të dhënave nuk është i mjaftueshëm. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi të theksuar. Megjithatë gjatë mbledhjes dhe raportimit të të dhënave janë hasë disa pasaktësi të të dhënave në 3 tregues. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.24.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 29 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (35), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 9 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.24.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Parteshit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve, rregullimit të trotuareve, ndriçimit publik, hapësirave të gjelbra, hapësirave për parkim të mjeteve motorike dhe të transportit publik;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigorozi i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.25. Podujevë

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën veri - lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 633 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 78 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe blegtorisë. E ka të zhvilluar agro – biznesin dhe industrinë e vogël për përpunimin e drurit.

9.25.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Podujeva	633	88499	2029	43.62	61.72

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Podujevës ka arritur performancë të shkallës së mesme (61.72%), 3.04% më e lartët se mesatarja e vendit.



9.25.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.18%), në fushën e transparencës komunale (79.60%), në kulturë, rini dhe sport (83.07%), në menaxhimin e fatkeqësive (97.88%), në furnizimin me ujë të pijshëm (74.52%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (77.20%). Shih graf. 47. Arritjet janë të shkallës së performancës së vendit, me një arritje më të lartë në menaxhimin e fatkeqësive dhe në ofrimin e shërbimeve administrative. Siç shihet në grafikun 48, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, me një tendencë të vogël të vendosjes mbi mesataren e vendit.

9.25.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar performancë të ulët vetëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (23.68%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (0.14%), strehimi i familjeve në nevojë (6.67%), rregullimi i teritorit me plane rregulluese (11.68%), dhe trajtimi i ujrave të zeza (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 3.28 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 120.23 kg./kokë banori mbeturina.

9.25.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 98.44%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është përafërsisht i plotë dhe si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është e madhe. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi. Megjithatë gjatë mbledhjes dhe raportimit të të dhënave janë hasë disa pasaktësi të të dhënave për 2 tregues. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.25.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 32 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (32), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 5 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.25.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Podujevës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe shesheve;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.26. Prishtinë

Komuna e Prishtinës shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 514 km², me 4 zonë urbane, prej tyre 1 administrative dhe 43 vendbanime rurale. Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Komuna ka veprimtari të veçant si kryeqytet duke përfaqësuar bazën kryesore administrative, arsimore, ekonomike dhe kulturore në vend.

9.26.1 Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Prizren	633	198897	5247	37.91	66.12

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Prishtinës ka arritur performancë të shkallës së lartë (66.12%), 7.44% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.26.2 Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (91.29%), në fushën e transparencës komunale (90.36%), në kulturë, rini dhe sport (83.63%), në menaxhimin e fatkeqësive (97.63%), në transportin publik (74.42%), në menaxhimin e mbeturinave (81.67%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (70.13%). Shih graf. 49. Prej arritjeve vlen të theksohet shkalla e punësimit të femrave (58.70%). Arritjet janë më të larta se mesatarja e performancës së vendit, me një arritje më të lartë në menaxhimin e fatkeqësive dhe në ofrimin e shërbimeve administrative. Siç shihet në grafikun 49, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, me një tendencë të shtrirjes së lakorës dhe të vendosjes mbi mesataren e vendit.

9.26.3 Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar performancë të ulët vetëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (36.60%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (0.84%), strehimi i familjeve në nevojë (34.24%), rregullimi i teritorit me plane rregulluese (5.94%), trotualet (24.92), shenjëzimi i rrugëve (35.79%), plotësimi i standardeve të ujit të pijshëm (1.18%), që është shumë shqetësuese, dhe trajtimi i ujrave të zeza (2.33%). Hapësirat e

gjelbra dhe të shesheve janë 5.63 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 337.26 kg./ kokë banori mbeturina.

9.26.4 Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me drejtorin e administratës dhe Kryetarin e komunës e ka organizuar shumë mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Koordinatori dhe zyrtarët përkatës kanë marrë pjesë aktive në zhvillimin e SMPK. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 89.06%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është përafërsisht i plotë dhe si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është e lartë. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi. Zyrtarët e komunës kanë deklaruar se SMPK iu ka ndihmuar për identifikimin e shumë punëve të kryera, për të cilat nuk është udhëhequr dokumentacion. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.26.5 Përfundim

Komuna hyn në grupin e komunave me arritje të lartë të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 36 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (28), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 7 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.26.6 Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Podujevës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë strehimit të familjeve në nevojë;
- Të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe shesheve;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe zbatimi i planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.27. Prizren

Komuna e Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 603 km², me 2 zonë urbane, prej tyre 1 administrative dhe 74 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. E ka të zhvilluar mirë agro – biznesin dhe turizimin kulturor.

9.27.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Prizren	603	177781	3074	57.83	67.90

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Prizrenit ka arritur performancë të shkallës së lartë (67.90%), 9.22% më e lartë se mesatarja e vendit.



9.27.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.67%), në fushën e transparencës komunale (80.65%), në kulturë, rini dhe sport (67.42%), në menaxhimin e fatkeqësive (85.71%), në furnizimin me ujë të pijshëm (89.74%), në menaxhimin e mbeturinave (97.52%) dhe në mbrojtjen e mjedisit (76.32). Shih graf. 50. Arritjet janë më të larta se mesatarja e performancës së vendit, me një arritje më të lartë në menaxhimin e mbeturinave, ofrimin me ujë të pijshëm, strehimin e familjeve në nevojë dhe në ofrimin e shërbimeve administrative. Siç shihet në grafikun 50, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, me një tendencë të shtrirjes së lakorës në qendër të grafikut dhe të vendosjes mbi mesataren e vendit.

9.27.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar performancë të ulët në 2 fusha: në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (40.97%) dhe në planifikimin hapësinor (30.58%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (0.61%), rregullimi i teritorit me plane rregulluese (10.35%), hapësirat për parkim publik (1.13%), lëshimi i lejeve mjedisore

(5.28%) dhe trajtimi i ujërave të zeza (2.70%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 4.44 m²/kokë banori, ndërsa komuna ka deponuar 236.47 kg./ kokë banori mbeturina.

9.27.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 42.19%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është i pamjaftueshëm dhe si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është e vogël. Shkalla e ulët e dokumentimit të të dhënave e dëmton shkallën e lartë të performancës së komunës. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi. Megjithatë gjatë mbledhjes dhe raportimit të të dhënave janë hasë disa pasaktësi të të dhënave për 7 tregues. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.27.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 36 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (28), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 7 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.27.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Prizrenit duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- Të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe shesheve dhe krijimi i hapësirave për parkim publik;
- Të prioritetizohet trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e mjedisit;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.

9.28. Rahovec

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën jug – perëndimore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 278 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 36 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, pemtarisë dhe blegtorisë. Është kultivuese e rrushit dhe e ka të zhvilluar industrinë e prodhimit të verës.

9.28.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Rahovec	278	56208	1180	47.63	53.47

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Rahovecit ka arritur performancë të shkallës së mesme (53.47%), 5.21% më e ulët se mesatarja e vendit.



9.28.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron lartë me performancë në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (92.86%), në furnizimin me ujë të pijshëm (83.79%), në menaxhimin e mbeturinave (83.13%) dhe në kulturë, rini dhe sport (70.24%). Shih graf. 51. Arritjet e larta janë shënuar vetëm në 4 fusha, që shtrihen pak më lartë se mesatarja e vendit. Arritja më të lartë është ajo në menaxhimin e fatkeqësive, e furnizimit me ujë të pijshëm, trehimin e familjeve në nevojë dhe e menaxhimit të mbeturinave. Siç shihet në grafikun 51, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të parregullt ndërmjet fushave, me një tendencë të shtrirjes së grafikut në qendër dhe duke e mbështjellur lakoren e mesatares së vendit, lartë dhe posht saj.

9.28.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve jo të mëdha, komuna ka shënuar performancë të ulët në 4 fusha: në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (35.98%), në planifikimin hapësinor (30.17%), në infrastrukturën rrugore (30.87%) dhe në parkingjet publike (4.17%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (5.74%), rregullimi i teritorit me plane rregulluese (7.04%), rregullimin e trotuareve (9.83%), ndriçimin publik (14.91%), shenjzimin e rrugëve

lokale (7.12%), hapësirat për parkim publik (2.50%) dhe zbatimin e planit për veprim në mjedis (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.28 m²/kokë banori, ndërkaj komuna ka deponuar 193.98 kg./kokë banori mbeturina.

9.28.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 70.31%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është i pamjaftueshëm dhe si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është jo e madhe. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi. Megjithatë gjatë mbledhjes dhe raportimit të të dhënave janë hasë disa pasaktësi të të dhënave për 14 tregues. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm, por MAPL iu ka ofruar udhëzimet e nevojshme në vendin e punës.

9.28.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 28 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (36), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 11 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioriteteve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.28.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Podujevës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- Të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe shesheve;
- Të rregulloj trotualet, ndriçimin publik, shenjëzimin e rrugëve, mirëmbajtjen e rrugëve, krijimin e hapësirave për parkim publik dhe zbatimin e planit lokal për veprim në mjedis;
- Të zbatohen kriteret rekomanduese për emërimin e zyrtarëve komunal të performancës;
- Të gjithë zyrtarët komunal të caktuar për zbatimin e SMPK në komunë duhet t'i konsultojnë mjaftueshëm dokumentet përkatëse për zbatimin e SMPK sipas standardeve të përcaktuara;
- Dokumentimi i të dhënave duhet të jetë i plotë dhe të bëhet verifikimi rigoroz i tyre;
- Edhe pse miratimi në formë është bërë mirë, megjithatë duhet të bëhet verifikimi i plotë i të dhënave para se të miratohen ato nga kryetari i komunës.


9.29. Ranillug

Komuna e Ranillugut shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Kosovës. Madhësia gjeografike e territorit të komunës është 69 km², me 1 zonë administrative urbane dhe 16 vendbanime rurale. Hyn në grupin e komunave me kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

9.29.1. Informatat e përgjithshme për komunën

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Numri i zyrtarëve	Nr. i qytetarëve për 1 zyrtar	Performanca %
Ranillug	69	3866	253	15.28	62.04

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se komuna e Ranillugut ka arritur performancë të shkallës së mesme (62.04%), 3.36% më e lartët se mesatarja e vendit.



9.29.2. Arritjet më të larta

Komuna qëndron shumë lartë me performancë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (212.73%), për shkak të përqindjes së lartë të pjesëmarrjes së qytetarëve në këto veprimtari. Në bazë të kësaj kuptojmë se një qytetarë ka marrë pjesë disa herë në një veprimtari kulturore, rinore dhe sportive. Performancë e lartë është shënuar edhe në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (100%), planifikimin hapësinor (95.56%) dhe në menaxhimin e mbeturinave (86.39%). Shih graf. 52. Arritjet janë të shkallës së performancës së vendit, me një arritje ekstreme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, pastaj në ofrimin e shërbimeve administrative dhe në planifikimin hapësinor. Siç shihet në grafikun 52, performanca e komunës karakterizohet me arritje relativisht të balancuar ndërmjet fushave, që lakorja e performancës herë e mbikalon e herë e nënkalon lakorën e mesatares së vendit, me një zgjatim ekstrem në fushën e katërt.

9.29.3. Arritjet më të ulta

Përpos arritjeve, komuna ka shënuar performancë të ulët në 6 fusha: në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare (26.46%), në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (0.0%), në transportin publik (11.11%), në parkingjet publike (9.83%), në kanalizim (27.33%), mbrojtja e mjedisit (25.00%). Prej arritjeve të dobëta veçohet shakalla e ulët e përfitimit nga skema sociale (4.99%), ndriçimi publik (0.0%), transporti publik (0.0), e hapësirave për parkim (0.92%), e

pagesave të ujit të faturuar (0.0%), trajtimi i ujërave të zeza (0.0%) dhe mbrojtja e mjedisit (0.0%). Hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 0.34 m²/kokë banori, ndërkohë komuna ka deponuar 303.53 kg./kokë banori mbeturina.

9.29.4. Përparësitë dhe dobësitë

Në përgjithësi zyrtarët e komunës kanë qenë shumë bashkëpunues për zbatimin e sistemit të ri të rishikuar. Koordinatori në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka organizuar mirë procesin e mbledhjes së të dhënave për performancën e komunës. Gjithashtu bashkëpunimi me MAPL për zbatimin e SMPK dhe të udhëzimeve profesionale ka qenë shumë i mirë. Koordinatori dhe hallkat tjera përgjegjëse e kanë bërë verifikimin e dokumentimit të të dhënave në shkallën 82.81%, që tregon se dokumentimi i të dhënave është relativisht i mirë dhe si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është e madhe. Procesi i administrimit të SMPK nuk është përcjellë me ndonjë vështirësi. Megjithatë gjatë mbledhjes dhe raportimit të të dhënave janë hasë disa pasaktësi të të dhënave për 2 tregues. Problemi i përgjithshëm është se zyrtarët nuk i kanë konsultuar mjaftueshëm udhëzimet e punës dhe dokumentet përkatëse profesionale. Trajnimi i zyrtarëve nuk ka qenë i mjaftueshëm.

9.29.5. Përfundim

Komuna hyn në grupin e madh të 27 komunave me arritje të mesme të performancës. Ka treguar rezultate të theksuara, mbi mesataren e vendit, në 26 tregues prej gjithsej 64 treguesve. Në numrin më të madh prej tyre (38), ka treguar arritje më të ulët se mesatarja e vendit. Prej tyre 13 tregues janë me arritje shumë të ulët. Numri i treguesve nën mesataren e vendit dhe ata me arritje të ulët, tregon për hartën e prioritetëve për përmirësimin e performancës së komunës. Komuna ka treguar vullnet dhe përkushtim në zbatimin e udhëzimeve dhe metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunës. Miratimi i të dhënave është bërë sipas procedurave standarde. Megjithatë procesi kërkon angazhim të burimeve njerëzore më profesionale, konsultim më të madh të dokumentacionit profesional dhe administrativ, si dhe dokumentim të plotë të të dhënave.

9.29.6. Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike dhe gjetjeve nga ky hulumtim, komuna e Podujevës duhet të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Shërbimet përkatëse të komunës duhet të punojnë shumë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht në ofrimin e ndihmës sociale;
- T'i jepet prioritet më shumë menaxhimit të fatkeqësive;
